

STATISTIKAT E KRIMEVE
DHE DREJTËSISË PENALE
2018

DREJTOR BOTIMI :

Phd Delina Brahimaj

PUNOI :

Albana Berbiu

Rudin Hoxha

Isida Gorçe

Blerina Subashi

© Copyright INSTAT 2018

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

PËRPUNIMI NË KOMPJUTER :

Kube Studios

Ky botim është mbështetur financiarisht dhe teknikisht nga Statistikat Suedeze në bashkëpunim me INSTAT.

Instituti i Statistikave - Tiranë
Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
Email: info@instat.gov.al
Telefon+{355} 42222411

PËRMBAJTJA

- 6 Hyrja
- 7 Legjislacioni
- 8 Konceptet kryesore
- 9 Faktorët që duhet të mbahen parasysh kur interpretohen të dhënat mbi veprat penale

10 Kapitulli I : Vepra penale, të dëmtuar (viktima) dhe persona të dyshuar

10 1.1 HYRJA

- 10 1.1.1 Veprat penale të evidentuara
- 10 1.1.2 Të dëmtuarit
- 10 1.1.3. Persona të dyshuar

10 1.2 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

- 10 1.2.1 Vepra penale të evidentuara gjithsej
- 13 1.2.2 Vepra penale të evidentuara kundër personit
- 16 1.2.3. Vepra penale të evidentuara kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 18 1.2.4. Vepra penale të evidentuara në kategorinë "vepra të tjera penale"

19 1.3 PERSONA TË DËMTUARIT TË EVIDENTUAR NGA VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

- 19 1.3.1 Persona të dëmtuar nga vepra penale kundër personit

25 1.4. PERSONA TË DYSHUAR

- 25 1.4.1 Numri gjithsej i persona të dyshuar të evidentuar në kryerjen e një vepre penale
- 29 1.4.2 Persona të dyshuar për vepra penale kundër personit
- 35 1.4.3 Persona të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 41 1.4.4 Persona të dyshuar në kategorinë "vepra të tjera penale"
- 43 1.4.5 Të miturit
- 45 1.4.5.1 Të mitur të dyshuar për vepra penale kundër personit
- 46 1.4.5.2 Të mitur të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 48 1.4.5.4 Të mitur të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale

50 Kapitulli II: Statistika mbi procedime penale dhe persona të pandehur

50 2.1. HYRJA

- 50 2.1.1 Procedime të veprave penale
- 50 2.1.2 Procedime penale për gjykim
- 50 2.1.3 Të pandehurit

51 2.2 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA

- 51 2.2.1 Procedime penale gjithsej
- 53 2.2.2 Procedime penale për veprat penale kundër personit
- 55 2.2.3 Procedime penale për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 58 2.2.4 Procedimet penale për kategorinë "vepra të tjera penale"

59 2.3 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM

- 59 2.3.1 Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim
- 61 2.3.2 Procedime penale për gjykim për veprat penale kundër personit
- 63 2.3.3 Procedime penale për gjykim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 65 2.3.4 Procedime penale për gjykim për kategorinë "Vepra të tjera penale"

66 2.4 TË PANDEHURIT E VEPRAVE PENALE

- 66 2.4.1 Numri gjithsej i të pandehurve të veprave penale
- 69 2.4.2 Të pandehur për vepra penale kundër personit
- 73 2.4.3 Të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- 78 2.4.4 Të pandehur për kategorinë "vepra të tjera penale"
- 80 2.4.5 Të miturit
- 81 2.4.4.1 Të pandehur të mitur për vepra penale kundër personit

- 82 2.4.4.2 Të pandehur të rritur dhe të mitur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
84 2.4.4.3 Të pandehur të rritur dhe të mitur për kategorinë vepra të tjera penale

86 Kapitulli III: Persona të dënuar sipas vepra penale

86 3.1 HYRJA

86 3.2 TË DËNUAR

- 86 3.2.1 Numri gjithsej i personave të dënuar për vepra penale
89 3.2.1.1 Masat e dënimit për personat e dënuar
90 3.2.2 Personat e dënuar për vepra penale kundër personit
94 3.2.2.1 Masat e dënimit për personat e dënuar për vepra penale kundër personit
95 3.2.3 Persona të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
99 3.2.3.1 Masat e dënimit të personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
100 3.2.4. Personat e dënuar për kategorinë vepra të tjera penale
101 3.2.4.1 Masat e dënimit e personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale
102 3.2.5 Të miturit e dënuar
104 3.2.5.1. Të dënuar të mitur për vepra penale kundër personit
105 3.2.5.2. Të dënuar të mitur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
107 3.2.5.3. Të dënuarit e mitur për kategorinë vepra të tjera penale

109 Kapitulli IV: Persona të burgosur

109 4.1 HYRJE

- 109 4.1.1. Të burgosur
109 4.1.2. Të dënuar me burg
109 4.1.3. Personat e paraburgosur

109 4.2 TË BURGOSUR GJITHSEJ

- 110 4.2.1 Të burgosurit sipas veprave penale
111 4.2.2 Shpërndarja gjinore e personave të burgosur
112 4.2.3 Struktura moshore e personave të burgosur
114 4.2.4 Niveli arsimor i të burgosurve
114 4.2.5 Recidivizmi

115 4.3 TË DËNUAR ME BURG

- 115 4.3.1 Të dënuar me burg sipas veprës penale
116 4.3.2. Struktura moshore e personave të dënuar me burg

117 4.4 TË PARABURGOSURIT

- 118 4.4.1. Të paraburgosur sipas veprës penale
118 4.4.2. Struktura moshore e të paraburgosurve

120 4.5 TË MITURIT

123 METODOLOGJIA

- 123 1. Burimi i të dhënave
123 2. Mbledhja e të dhënave
123 2.1 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
124 2.2 Prokuroria e Përgjithshme
126 3. Klasifikimi i veprave penale
129 4. Përkufizime

131 Shtojcë - Kapitulli I (Vepra penale, të dëmtuar dhe persona të dyshuar)
137 Shtojcë - Kapitulli II (Procedime penale dhe të pandehur)
141 Shtojcë- Kapitulli III (Të dënuar sipas veprave penale)
145 Shtojcë- Kapitulli IV (Persona të burgosur)

HYRJE

Ky publikim paraqet raportin e parë të INSTAT mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, duke u përqëndruar në sistemin e drejtësisë penale, Polici, Prokurori, Gjykatë dhe Burgje. Metoda të ndryshme mund të përdoren për të matur statistikat e krimit; të dhënat administrative janë qasja e përdorur në këtë publikim pasi INSTAT nuk ka kryer ende një studim mbi këto statistika. Raporti përfshin të dhëna për tre vitet e fundit 2015, 2016 dhe 2017.

Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqes një pasqyrë të hollësishme të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë në të njëjtin publikim statistika për katër fazat, polici, prokurori, gjykatë dhe burgje. Publikimi është përqëndruar jo vetëm te statistikat por edhe te grumbullimi i të dhënave, mënyra se si mbledhen dhe analizohen të dhënat¹. Është e rëndësishme të theksohet se të dhënat e paraqitura në këtë publikim janë përpiluar nga burime të ndryshme të të dhënave.

Publikimi është konceptuar në kapituj të veçantë sipas katër fazave të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale. Struktura themelore e kapitujve përbëhet nga veprat penale dhe personat e dyshuar; procedimet penale dhe të pandehur; persona të dënuar dhe së fundmi të burgosurit për një sërë veprash penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe vepra të tjera penale.

Për veprat penale kundër personit, janë paraqitur të dhëna mbi vrasjet me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krime seksuale të ndara në marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale, dhuna në familje dhe nënkategoria e fundit vepra të tjera penale kundër personit.

Për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë pasqyruar të dhëna mbi vjedhjet e pasurisë, grabitjet, mashtrimin, shkatërrimi i pronës, falsifikimi i dokumenteve dhe parave, vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës dhe vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Kategoria e tretë, vepra të tjera penale paraqet të dhëna mbi veprat penale në fushën e drogës, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave.

Kapitulli i parë paraqet të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Kapitulli është strukturuar në katër seksione; seksioni i parë paraqet statistika mbi veprat penale të evidentuara për kategoritë Vepra penale kundër personit, Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe kategoria e tretë Vepra të tjera penale. Seksioni i dytë ilustron të dhëna mbi persona të dëmtuar nga veprat penale kundër personit; seksioni i tretë paraqet persona të dyshuar për të njëjtat kategori të veprave penale. Ndërkohë seksioni i fundit pasqyron të dhëna mbi të dyshuarit e mitur në kryerjen e një vepre penale.

Kapitulli i dytë synon të paraqesë të dhëna mbi fazën e ndjekjes së veprës penale nga ana e prokurorisë. Tre seksionet e para të kapitullit paraqesin statistika mbi procedimet penale të regjistruara, procedimet penale për gjykim dhe mbi numrin e të pandehurve, për të njëjtat kategori të veprave penale siç janë paraqitur në kapitullin e parë. Seksioni i fundit ilustron të dhëna mbi të pandehur të mitur.

¹Informacion më i gjerë jepet në kapitullin mbi Metodologjinë

Kapitulli i tretë paraqet statistika për personat e dënuar të ndarë sipas gjinisë, grupmoshës dhe masave të dënimit për kategoritë e veprave penale, vepra penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe vepra të tjera penale. Burimi i të dhënave është Ministria e Drejtësisë.

Më pas, një prezantim mbi numrin e të burgosurve në burgjet e Shqipërisë mbyll analizën mbi të dhënat e drejtësisë penale. Në këtë kapitull janë paraqitur të dhëna për të burgosurit sipas llojit të veprave penale, gjinisë dhe grupmoshës (seksioni 1). Më tej, kapitulli paraqet të dhënat për të dënuarit me burg (seksioni 2) dhe të paraburgosurit (seksioni 3). Analiza mbyllet me të miturit në burgje.

Kapitulli i fundit, metodologjia përshkruan grumbullimin e të dhënave, mënyrën se si mbledhen të dhënat për secilin ofrues të të dhënave, përkufizimet dhe klasifikimet e përdorura për statistikat e krimeve. Gjithashtu, faktorët që duhen marrë parasysh kur krahasojmë këto statistika.

LEGJISLACIONI

1. Ligji “Për Statistikat Zyrtare”

Ligji Nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, përcakton se INSTAT ka të drejtë të mbledhë, përpunojë, analizojë dhe shpërndajë statistikat zyrtare.

2. Programi i Statistikave Zyrtare

Statistikat e krimeve janë planifikuar në detaje në një modul në Programin 5-vjeçar të Statistikave Zyrtare, i cili mbulon detyrimin dhe konfidencialitetin lidhur me statistikatat.

3. Kodi Statistikor Evropian i Praktikës

Gjithashtu, raporti është në përputhje me Kodin Statistikor Evropian i Praktikës. Kodi Statistikor i Praktikës përcakton 15 parime kryesore² për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare evropiane dhe mjedisin institucional sipas të cilit veprojnë autoritetet statistikore kombëtare dhe komunitare.

4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”

Klasifikimi i statistikave të veprave penale në raport bëhet sipas ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

5. Kodi i Drejtësisë Penalepër të Mitur

Ligji Nr. 37, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penalepër të Miturit”.

6. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.

² <http://ec.europa.eu/eurostat/web/products-catalogues/-/KS-02-18-142>

KONCEPTET KRYESORE

Ky seksion jep disa nga përkufizimet kryesore të përdorura në këtë raport. Përkufizime dhe tregues të tjerë paraqiten në kapitullin mbi Metodologjinë.

Vepra penale: Sjelle, veprime apo mosveprime me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundrëvajtje penale.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale. Personat nën 14 vjeç nuk janë përfshirë në statistika e paraqitura.

I dëmtuar/Viktimë: Personi të cilit çfarëdo e drejtë personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar si pasojë e një veprë penale.

I mitur: Është çdo person nën moshën 18 vjeç.

I mitur në konflikt me ligjin është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. Në vijim të botimit i mituri në konflikt me ligjin, 14-17 vjeç do cilësohet thjesht i mitur.

I rritur: Është çdo person mbi 18 vjeç.

I pandehur: Konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur.

Recidivizmi: Është akti i një personi që përsërit një sjellje të padëshiruar, pasi ka përjetuar pasojë negative të asaj sjelljeje ose është trajnuar për të ndaluar përsëritjen e asaj sjelljeje.

I dënuar: Personi i cili me veprat apo sjelljet e tij ka cënuar apo ka dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj. Ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale.

Numri i të burgosurve: Numri gjithsej i të burgosurve tregon numrin e personave të mbajtur në ambjentet e burgjeve, institucione të tjera, institucionet e burgosjes së të miturve, spitalet psikiatrike ose spitale të tjera. Përfshihen si të dënuarit me burg dhe të paraburgosurit.

I dënuar me burg: Konsiderohen personat, shtetas shqiptar, i huaj, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

I paraburgosur: Konsiderohen personat, shtetas shqiptar, i huaj ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg".

FAKTORËT QË DUHET TË MBAHEN PARASYSH KUR INTERPRETOHEN TË DHËNAT MBI VEPRAT PENALE

Numri i veprave penale dhe individëve në sistemin e drejtësisë nuk shpreh numrin e krimeve që kanë ndodhur ose numrin e personave që kryejnë krime. Ai tregon vetëm ngjarjet që janë të njohura në sistemin e drejtësisë. Më poshtë kemi paraqitur disa faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh kur interpretojmë të dhënat:

- Ndryshimet midis viteve mund të shpjegohen nga ndryshimet në hyrjet në sistemin e drejtësisë për shkak të faktorëve të jashtëm si gatishmëria e qytetarëve për të raportuar veprat penale. Kjo mund të ndryshojë dhe të ndikohet, për shembull, nga ndryshimi i tolerancës për një vepër penale specifike, përpjekjet shoqërore nga komuniteti, raportimi i medias, etj. Këta faktorë kanë një ndikim të madh në llojin e veprave penale që raportohen nga qytetarët, për shembull, vepra penale kundër personit ose vjedhja, etj.

- Ndryshimet midis viteve mund të shpjegohen me ndryshimin e përpjekjeve dhe burimeve të sistemit të drejtësisë. Këta faktorë kanë një ndikim të madh në llojet e veprave penale që zbulohen nga policia ose nga autoritete të tjera, për shembull: shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor ose vepra penale në fushën e drogës, etj.

Statistikat ndryshojnë brenda të njëjtit shtet

Të dhënat mbi veprat penale dhe të drejtësisë penale ndryshojnë në të njëjtin juridiksion, nga njëra fazë në tjetrën. Statistikat e paraqitura në kapitujt e ndryshëm janë të vështira për t'u bashkëanalizuar pasi secili institucion mbledh dhe përpunon statistika në bazë të nevojave të veta, ndryshon mënyra e numërimit, si dhe të dhënat mund të kenë rrjedhur nga periudha të ndryshme kohore.

- Numri i personave të dyshuar të regjistruar gjatë një viti nuk mund të krahasohet me numrin e të pandehurve të regjistruar për të njëjtin vit pasi disa nga të pandehurit mund të jenë paraqitur si persona të dyshuar në vitin e kaluar.

- Numri i të pandehurve të regjistruar gjatë një viti nuk mund të krahasohet me numrin e personave të dënuar në të njëjtin vit pasi të dënuarit mund të kenë qenë të pandehur në një periudhë të ndryshme kohore, psh një vit më parë.

Pra, është shumë e rëndësishme që statistikat të shihen në një perspektivë më të gjerë dhe më të përgjithshme, për shembull në krahasimin e periudhave kohore, në vend që të krahasohen numrat specifik përkundrejt njëri-tjetrit.

Statistikat ndryshojnë gjerësisht mes shteteve

Krahasimi i drejtpërdrejtë i shifrave të krimeve midis vendeve mund të jetë i papërshtatshëm dhe mund të rezultojë në përfundime të gabuara. Arsyeja është se organizimi i sistemeve të drejtësisë penale, përkufizimet e veprave penale dhe mënyra se si statistikave të krimit dhe të drejtësisë penale mbledhen dhe paraqiten variojnë shumë midis vendeve.³

Ekzistenca e dy sistemeve të ndryshme ligjore, përkufizimet e ndryshme kombëtare të bazuara në Kodin Penal, mbulimi gjeografik ose periudha e referencës ndryshojnë shumë midis vendeve dhe e bëjnë të vështirë krahasimin e statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale.

Faza e mbledhjes së të dhënave nga policia ose gjykatat mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Të dhënat mund të regjistrohen në kohën kur një krim raportohet së pari, para një hetimi të plotë ose në raste të tjera pasi vepra është hetuar plotësisht. Ose në rast të statistikave gjyqësore, rastet mund të llogariten për shembull, para ose pas apelimit të çështjes. Prandaj, institucionet që regjistrojnë të dhënat në kohën kur vepra fillimisht i raportohet policisë ose në rastin e statistikave gjyqësore, para apelimit mund të tregojnë vlera më të larta.

Gjithashtu, faktorë të tjerë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh konsistojnë në rregulla dhe njësi të ndryshme të numërimit, të përdorura në sistemet e drejtësisë penale.

³ Referoju websitet të Eurostat: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/crime/comparisons>

VEPRA PENALE, TË DËMTUAR (VIKTIMA) DHE PERSONA TË DYSHUAR

1.1 HYRJA

Ky kapitull paraqet të dhëna për veprat penale të evidentuara, persona të dyshuar dhe persona të dëmtuar sipas veprave penale të kryera gjatë një viti dhe karakteristikat e tyre. Burimi i të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe paraqiten të dhëna për 3 vite, 2015-2017.

Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Ky kapitull paraqet statistika për veprat penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale në fushën e drogës, vepra penale lidhur me qarkullimin rrugor, kalim të paligjshëm të kufirit dhe pastrimi i parave. Këto kategori paraqesin veprat penale më të zakonshme të evidentuara.

1.1.1 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia. Policia regjistron të gjithë veprat penale të ndodhura gjatë një viti dhe jo vetëm veprën më të rëndë penale.

Statistikat e paraqitura bazohen në klasifikimit ligjor të veprës penale, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe përfshijnë 3 vite, 2015-2017.

1.1.2 TË DËMTUARIT

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti. Seksioni i të dëmtuarve paraqet të dhënat mbi personat e dëmtuar nga veprat penale kundër personit gjatë periudhës 2015 – 2017.

1.1.3. PERSONA TË DYSHUAR

Të dhënat për personat e dyshuar i referohen personave të dyshuar nga policia në kryerjen e një vepre penale. Policia mbledh të dhëna për të gjithë personat e dyshuar, edhe pse në sistemin e drejtësisë vetëm personat mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale.

Numri i personave të dyshuar për një vepër penale mund të jetë më i lartë krahasuar me numrin e veprave penale të evidentuara, sepse në kryerjen e një vepre penale mund të ketë më shumë se një të dyshuar.

1.2 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

Veprat penale të evidentuara paraqesin numrin e veprave që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia. Veprat penale të evidentuara për një vit i referohen të gjitha veprave të evidentuara nga policia nga 1 janari deri më 31 dhjetor.

1.2.1 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA GJITHSEJ

Në Shqipëri, në vitin 2017, policia evidentoi 34.317 vepra penale gjithsej. Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara ka rënë me 4,3 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i veprave penale të evidentuara ka rënë me 5,7 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas ka pësuar një rritje të lehtë me 1,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Veprat penale më të zakonshme të evidentuara janë vjedhjet e pasurisë, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit dhe veprat penale në fushën e drogës.

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike zënë 39,8 % të të gjitha veprave penale të evidentuara gjatë vitit 2017, ndjekur nga veprat penale kundër personit me 19,3 %, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor me 14,6 % dhe veprat penale në fushën e drogës me 6,0 %. Kategoria "Vepra të tjera penale" përfshin ato vepra penale që nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë e tjera të paraqitura. Në kapitullin e metodologjisë janë paraqitur veprat penale që janë pjesë e kategorisë Vepra të tjera penale.

TABELA 1


Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Kategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	6.943	6.634	-4,5	6.632	0,03
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	14.750	12.344	-16,3	13.658	10,6
Krime në fushën e drogës	2.321	3.249	40,0	2.071	-36,3
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	5.003	4.983	-0,4	5.002	0,4
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	385	579	50,4	643	11,1
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	341	364	6,7	377	3,6
Të tjera	6.121	5.655	-7,6	5.934	4,9
Gjithsej	35.864	33.808	-5,7	34.317	1,5

Në vitin 2017, norma e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike është 47.5 vepra penale për 10 mijë banorë. Kjo normë ka pësuar rënie, nga 51.2 vepra penale në vitin 2015 në 42.9 vepra penale në vitin 2016. Në vitin pasardhës, kjo normë shënon 47.5 vepra për 10 mijë banorë.

FIGURA 1

Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara në vlerë absolute [aksi majtë dhe kolonat] dhe në raport me popullsinë [aksi djathtë dhe vija], për periudhën 2015-2017



Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike zënë 39,8 % të të gjitha veprave penale të evidentuara gjatë vitit 2017, ndjekur nga veprat penale kundër personit me 19,3 %, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor me 14,6 % dhe veprat penale në fushën e drogës me 6,0 %. Kategoria "Vepra të tjera penale" përfshin ato vepra penale që nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë e tjera të paraqitura. Në kapitullin e metodologjisë janë paraqitur veprat penale që janë pjesë e kategorisë Vepra të tjera penale.

Figura 3 tregon ndryshimin në përqindje të veprave penale gjatë vitit 2017 dhe 2015. Ashtu si numri total i veprave penale, shumica e kategorive të veprave penale kanë pësuar rënie; vetëm kalimi paligjshëm i kufirit, pastrimi i parave kanë pësuar rritje në krahasim me vitin 2015. Këto kategori veprash penale kanë një numër të vogël veprash të evidentuara, ndaj një ndryshim i vogël në numër, vlerë absolute kur paraqitet në përqindje ka një impakt më të madh.

Veprat penale të evidentuara kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe veprat penale në fushën e drogës kanë pësuar rënie më të madhe, respektivisht me 10,8 % dhe 7,4 % krahasuar me vitin 2015.

Në vitin 2017, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor kanë mbetur konstante në krahasim me vitin 2015, 5.002 vepra penale të evidentuara në vitin 2017 dhe 5.003 vepra penale në vitin 2015.

FIGURA 2

Përqindja që zë çdo kategori e veprave penale në totalin e veprave penale të evidentuara për 2017





FIGURA 3

Ndryshimi në përqindje i veprave penale të evidentuara sipas kategorive të veprave penale midis 2015 dhe 2017



1.2.2 VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA KUNDËR PERSONIT

Në totalin e veprave penale kundër personit janë përfshirë dhjetë seksione të kapitullit 2 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për qëllime statistikore, ne do të analizojmë veprat penale kryesore, si: vrasje me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krime seksuale të ndara në marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale, si dhe dhuna në familje.

Në 2017, janë evidentuar 6.632 vepra penale kundër personit. Numri gjithsej i veprave penale kundër personit ka rënë me 4,5 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i veprave penale ka pësuar rënie me 4,5 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ka qenë përafërsisht i njëjtë, duke pësuar rënie vetëm me 2 vepra penale.

TABELA 2

Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	54	71	31,5	50	-29,6
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	2.892	2.579	-10,8	2.650	2,8
Krime seksuale	149	120	-19,5	113	-5,8
Marrëdhënie seksuale me dhunë	71	44	-38	43	-2,3
Krime të tjera seksuale	78	76	-2,6	70	-7,9
Dhuna në familje	1.300	1.488	14,5	1.412	-5,1
Vepra të tjera penale kundër personit	2.548	2.376	-6,8	2.407	1,3
Gjithsej	6.943	6.634	-4,5	6.632	0,03

Në 2017, norma e veprave penale kundër personit ishte 23,1 vepra për 10 mijë banorë. E njëjta vlerë është edhe për vitin 2016. Ndërkohë, në vitin 2015 kjo normë shënonte 24,1 vepra penale kundër personit për 10 mijë banorë.

FIGURA 4

Numri gjithsej i veprave penale kundër personit të evidentuara në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vijat), për periudhën 2015-2017





Figura 5 tregon se veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit zënë përqindjen më të lartë në totalin e veprave penale kundër personit, ndjekur nga vepra të tjera penale kundër personit dhe dhuna në familje. Ndërkohë, veprat penale të vrasjes me dashje dhe marrëdhënie seksuale me dhunë paraqesin nënkategoritë me përqindjen më të ulët në totalin e veprat penale kundër personit.

FIGURA 5

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e veprave penale kundër personit të evidentuara për 2017



- Vrasje me dashje
- Vepra penale me dashje kundër shëndetit
- Krime seksuale
- Dhuna në familje
- Vepra të tjera penale kundër personit


Vrasje me dashje

Në vitin 2017, u evidentuan 50 vrasje me dashje. Numri i veprave penale të vrasjes me dashje është rritur me 17 vepra penale nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rënie me 21 vepra penale nga 2016 në 2017.

Duke marrë parasysh të dhënat për vrasjet me dashje nga viti 2012, kjo vepër penale tregon një tendencë të theksuar dhe të vazhdueshme në rënie, siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, për normën e vrasjeve me dashje për 10,000 banorë.

FIGURA 6

Norma e vrasjeve me dashje në raport me popullsinë, për periudhën 2012-2017.



Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në vitin 2017, u evidentuan 2.650 vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Numri i këtyre veprave penale ka rënë me 8,4 % gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër ka rënë me 10,8 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka shënuar një rritje të lehtë prej 2,8 % nga 2016 në 2017.


Krime seksuale

Krimet seksuale ndahen në 2 nënkategoritë: marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale.

Në vitin 2017, u evidentuan 113 krime seksuale. Numri gjithsej i këtyre veprave penale tregon një rënie prej 24,2 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i krimeve seksuale të evidentuara ka rënë me 29 vepra penale nga viti 2015 në vitin 2016 dhe në vitin pasardhës ra me 7 vepra penale. Rënia e numrit të krimeve seksuale ka ardhur kryesisht nga rënia e numrit të marrëdhënieve seksuale me dhunë. Në 2016, numri i marrëdhënieve seksuale me dhunë ka pësuar rënie me 38,0 %, nga 71 raste në vitin 2015 në 44 raste. Në vitin 2017, numri i marrëdhënieve seksuale me dhunë ishte 43, një më pak se në vitin 2016. Në të njëjtën periudhë, numri i krimeve të tjera seksuale ka pësuar rënie, nga 78 raste në vitin 2015, në 70 raste në vitin 2017. Grafiku më poshtë tregon trendin e përgjithshëm të numrit të veprave penale për dy nënkategoritë e krimeve seksuale.

FIGURA 7

Numri i krimeve seksuale të evidentuara sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Dhuna në familje

Dhuna në familje përfshin rrahjen, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.

Dhuna në familje është vepra penale e evidentuar që tregon një trend në rritje në periudhën 2015-2017 në kategorinë vepra penale kundër personit. Duhet të mbahet parasysh se kjo veprë shpesh nuk raportohet. Kjo mund të nënkuptojë që tendenca në rritje është rezultat i shkallës më të lartë të raportimit të dhunës në familje nga të dëmtuarit dhe të afërmit e tjerë. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë se ka shumë vepra të tjera të këtij lloji që nuk raportohen. Numri i veprës penale të dhunës në familje ka pësuar rritje me 14,5 %, nga 1.300 vepra penale në vitin 2015 në 1.488 vepra penale në vitin 2016. Pastaj, nga viti 2016 në vitin 2017 ka pasur një rënie të lehtë prej 5,1 %, nga 1.488 vepra penale në 1.412.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në kategorinë vepra të tjera penale kundër personit janë përfshirë: vepra penale kundër shëndetit të shkaktuara nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale

kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në nënkategoritë e paraqitura, si vrasje në tentativë, vrasje nga pakujdesia.

Në vitin 2017, u evidentuan 2.407 vepra të tjera penale kundër personit. Numri i veprave penale të evidentuara në këtë nënkategori, nga 2015 në 2017, ka pësuar rënie me 6,1 %. Numri i veprave të tjera penale të evidentuara kundër personit ka rënë me 6,8 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe pastaj është rritur lehtë me 1,3 % në vitin 2017.

Tabela lidhur me nënkategoritë e përfshira në “vepra të tjera penale kundër personit” mund të gjendet në tabelën shtojcë 1.1.

1.2.3. VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike i referohen neneve 134-200 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Gjithsej janë 11 seksione pjesë e këtij kapitulli.

Në vitin 2017, Policia evidentoi 13.658 vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri gjithsej i veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

TABELA 3


Numri gjithsej i veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të evidentuara sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	6.787	5.336	-21,4	4.821	-9,7
Grabitje	193	130	-32,6	164	26,2
Mashtrime	803	1.031	28,4	1.127	9,3
Shkatërrimi i pasurisë	1.424	1.214	-14,7	1.498	23,4
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	128	79	-38,3	86	8,9
Falsifikimi i dokumenteve	771	946	22,7	1.093	15,5
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	2.080	1.547	-25,6	2.510	62,2
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	2.564	2.061	-19,6	2.359	14,5
Gjithsej	14.750	12.344	-16,3	13.658	10,6

Figura 9 tregon se nënkategoria vjedhja e pasurisë zë përqindjen më të madhe, ndjekur nga veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës. Ndërkohë grabitjet dhe falsifikimet e monedhës paraqiten si nënkategoritë me përqindjen më të ulët në totalin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

FIGURA 9

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të evidentuara për 2017




ka pësuar rënie me 7,4 % nga viti 2015 në 2017. Numri i veprave penale ka rënë me 16,3 % nga viti 2015 në vitin 2016. Në vitin pasardhës ka pësuar rritje me 10,6 %.

Në vitin 2017, norma e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike është 47,5 vepra penale për 10 mijë banorë. Kjo normë ka pësuar rënie, nga 51,2 vepra penale në vitin 2015 në 42,9 vepra penale në vitin 2016. Në vitin pasardhës, kjo normë shënon 47,5 vepra për 10 mijë banorë.

FIGURA 8

Numri gjithsej i veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të evidentuara në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vijat), për periudhën 2015-2017



Vjedhje të pasurisë

Në vitin 2017, u evidentuan 4.821 vepra penale të vjedhjes së pasurisë. Numri i veprave penale të vjedhjes së pasurisë ka rënë gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër ka rënë me 21,4 % nga viti 2015 në 2016 dhe 9,7 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Grabitjet

Në nënkategorinë grabitje bëjnë pjesë vjedhjet me dhunë, vjedhjet me armë dhe vjedhje me pasojë vdekje. Në 2017, u evidentuan 164 grabitje. Numri i grabitjeve të evidentuara ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër ka rënë me 32,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rritje prej 26,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Mashtime

Në vitin 2017, u evidentuan 1.127 vepra penale të mashtimit. Numri i veprave penale në nënkategoritë mashtime ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 28,4 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas me 9,3 % nga viti 2016 në vitin 2017. Nënkategoria mashtime dhe falsifikimi i dokumenteve paraqesin nënkategoritë ku numri i veprave penale është rritur për të dyja periudhat, 2015-2016 dhe 2016-2017.

Shkatërrim i pronës

Në vitin 2017, u evidentuan 1.498 vepra penale të shkatërrimit të pronës, 284 vepra më shumë krahasuar me vitin paraprak dhe 74 vepra më shumë krahasuar me vitin 2015.

Falsifikimi i monedhave

Në vitin 2017, u evidentuan 86 vepra penale të falsifikimit të monedhës. Numri i veprave penale të falsifikimit të monedhës ka rënë nga viti 2015 në 2017. Ky numër ka rënë me 38,3 % nga 2015 në 2016 dhe më pas u rrit lehtë me 8,9 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Falsifikimi i dokumenteve


Në 2017, u evidentuan 1.093 vepra penale të falsifikimit të dokumenteve. Numri i veprave penale të falsifikimit të dokumenteve ka pësuar rritje nga 2015 në 2017. Ky numër është rritur me 15,5 % vepra nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës me 22,7%.

Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës

Në vitin 2017, u evidentuan 2.510 vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës. Numri i këtyre veprave penale ka pësuar rritje nga 2015 në 2017. Ky numër fillimisht ka rënë me 25,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas është rritur me 62,2 % nga 2016 në 2017.

FIGURA 10

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e veprave penale që çenojnë regjimin juridik të tokës, për periudhën 2015-2017



Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Në këtë kategori janë përfshirë seksionet e tjera pjesë e kapitullin 3 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, si: veprat penale të kryera në shoqëri tregtare, veprat penale në fushën e doganave, veprat penale lidhur me tatimet, vepra penale në fushën e falimentimit, zhvillimit të paligjshëm të lojërave të fatit.

Në vitin 2017, u evidentuan 2.359 vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri i këtyre veprave ka pësuar rënie gjatë kësaj periudhe. Numri i veprave penale të tjera kundër pasurisë ka rënë me 19,6 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës është rritur me 14,5 %.

Tabela lidhur me veprat penale të evidentuara në nënkategorinë vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike gjatë periudhës 2015-2017 është paraqitur në tabelën 1.2 në shtojcë.

TABELA 4

Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara në kategorinë Vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	2.321	3.249	40,0	2.071	-36,3
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	5.003	4.983	-0,4	5.002	0,4
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	385	579	50,4	643	11,1
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	341	364	6,7	377	3,6
Të tjera	6.121	5.655	-7,6	5.934	4,9
Gjithsej	14.171	14.830	4,7	14.027	-5,4

Figura më poshtë tregon numrin absolut të veprave penale të evidentuara në kategorinë vepra të tjera penale dhe numrin e këtyre veprave në raport me numrin e popullsisë. Norma e kriminalitetit për këto vepra penale është afërsisht e njëjtë gjatë kësaj periudhe. Në 2017, norma e kriminalitetit është 48.8 vepra të tjera penale të evidentuara për 10 mijë banorë.


1.2.4. VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA NË KATEGORINË “VEPRA TË TJERA PENALE”

Ky seksion paraqet të dhëna për kategorinë “vepra të tjera penale”. Në këtë kategori përfshihen të gjithë veprat penale me përjashtim të veprave penale që nuk janë pjesë e kategorisë “vepra penale kundër personit” (Seksioni 1.2.2) dhe “vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” (Seksioni 1.2.3). Në këtë seksion janë analizuar veprat penale në fushën e drogës, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave.

Në vitin 2017, u evidentuan 14.027 vepra penale në kategorinë e veprave të tjera penale. Numri gjithsej i veprave penale ka pësuar një rënie të lehtë prej 1,0 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i veprave penale është rritur me 4,7 % nga viti 2015 në 2016 dhe më pas është ulur me 5,4 % nga viti 2016 deri në vitin 2017.

FIGURA 11

Numri gjithsej i veprave penale të evidentuara në kategorinë Vepra të tjera penale në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vija), për periudhën 2015-2017



Vepra penale në fushën e drogës

Në vitin 2017, u evidentuan 2.071 vepra penale në fushën e drogës. Numri i veprave penale në fushën e drogës ka pësuar rënie gjatë kësaj periudhe. Ky numër u rrit me 40,0 % nga 2015 në 2016 dhe pastaj pësoi rënie me 36,3 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor

Në 2017, u evidentuan 5.002 shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor ka mbetur përafërsisht i njëjtë. Nga viti 2015 në vitin 2017, numri i veprave penale të evidentuara u ul me një vepër penale, nga 5.003 në vitin 2015 në 5.002 në vitin 2017.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Në vitin 2017, u evidentuan 643 vepra penale lidhur me kalimin e paligjshëm të kufijve shtetërorë. Numri i këtyre veprave penale është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 50,4 % nga 2015 në 2016 dhe ka pësuar përsëri rritje me 11,0 % nga viti 2016 në vitin 2017. Përqindja që veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit zënë në kategorinë e veprave të tjera penale është rritur gjatë kësaj periudhe. Kjo përqindje u rrit me 2,7 % në 2016 dhe në vitin 2017 u rrit me 4,6 %.

Pastrimi i parave

Numri i veprave penale të pastrimit të parave është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Në vitin 2017, u evidentuan 377 vepra penale të pastrimit të parave, 13 vepra më shumë krahasuar me vitin paraprak dhe 36 vepra më shumë krahasuar me vitin 2015.

TABELA 5

Numri gjithsej i personave të dëmtuar të evidentuar nga vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	82	99	20,7	68	-31,3
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	3.334	2.990	-10,3	3.220	7,7
Krime seksuale	146	121	-17,1	114	-5,8
Marrëdhënie seksuale me dhunë	70	46	-34,3	44	-4,3
Krime të tjera seksuale	76	75	-1,3	70	-6,7
Dhuna në familje	1.376	1.616	17,4	1.549	-4,1
Vepra të tjera penale kundër personit	2.504	2.370	-5,4	2.306	-2,7
Gjithsej	7.442	7.196	-3,3	7.257	0,8

1.3 PERSONA TË DËMTUARIT TË EVIDENTUAR NGA VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Personat e dëmtuar nga veprat penale u referohen personave që janë dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti. Ky seksion paraqet të dhëna mbi të dëmtuarit sipas gjinisë, grupmoshës dhe nënkategorive të veprave penale kundër personit.

1.3.1 PERSONA TË DËMTUAR NGA VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT


Viktimat/të dëmtuarit e evidentuar nga veprat penale kundër personit i referohen të gjithë personave të dëmtuar nga çdo lloj vepre penale e evidentuar në kategorinë e veprave penale kundër personit. Në këtë seksion, ne do të paraqesim të dhëna për personat e dëmtuar të evidentuar sipas llojit të veprës, gjinisë, lidhjes mes viktimës dhe të dyshuarve për veprën penale të dhunës në familje.

Në 2017, numri gjithsej i personave të dëmtuar të evidentuar ishte 7.257. Numri gjithsej i të dëmtuarve të evidentuar ka pësuar rënie me 2,5 % nga 2015 në 2017. Numri i të dëmtuarve ra me 3,3 % nga 2015 në 2016 dhe me 0,8 % nga 2016 në 2017.

Nënkategoria vepra penale me dashje kundër shëndetit zë përqindjen më të madhe të të dëmtuarve në kategorinë vepra penale kundër personit, ndëkur nga vepra penale dhunë në familje. Gjatë periudhës 2015-2017, përqindja e personave të dëmtuar nga krime kundër shëndetit varion nga 41,6 % në 44,8 %.

FIGURA 12

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në numrin e personave të dëmtuar të evidentuar për vepra penale kundër personit, për periudhën 2015-2017



Vrasje me dashje

Nga viti 2015 në vitin 2016, numri i viktimave të evidentuara për vrasje me dashje u rrit me 17 viktima, në total 99 viktima. Në vitin vijues numri i viktimave të vrasjeve me dashje pësoi rënie me 31 viktima, në total 68 viktima.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në vitin 2017, u evidentuan 3.220 të dëmtuar të veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Numri më i madh i të dëmtuarve të veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit u regjistrua në vitin 2015, me 3.334 të dëmtuar. Ndërsa, numri më i vogël i të dëmtuarve për këtë nënkategori u regjistrua në 2016, me 2.990 të dëmtuar. Numri i të dëmtuarve u ul me 10,3 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës pësoi rritje me 7,7 %.


Krime seksuale

Numri i të dëmtuarve nga krimet seksuale ka rënë nga 146 në 114 të dëmtuar në periudhën 2015- 2017. Kjo rënie

ka ardhur kryesisht nga rënia e numrit të të dëmtuarve nga vepra penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë nga viti 2015 në vitin 2016. Numri i personave të dëmtuar të marrëdhënieve seksuale me dhunë ka rënë nga 70 të dëmtuar në 2015 në 46 të dëmtuar në vitin 2016. Në 2017, ky numër pësoi përsëri rënie, 44 të dëmtuar. Numri i të dëmtuarve nga krime të tjera seksuale në 2017 ishte 70, përkatësisht 5 dhe 6 më pak se në 2016 dhe 2015.

FIGURA 13

Numri i personave të dëmtuar të evidentuar për krimet seksuale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Dhuna në familje

Numri i të dëmtuarve nga dhuna në familje është rritur nga 1.376 të dëmtuar në vitin 2015 në 1.616 të dëmtuar në vitin 2016. Në vitin pasues, numri i të dëmtuarve të dhunës në familje ka rënë në 1.549 të dëmtuar. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i të dhunuarve sipas viteve dhe lidhja mes të dëmtuarve dhe personave të dyshuar. Marrëdhënia mes të dëmtuarit dhe të dyshuarit nënkupton që i dëmtuari nga dhuna në familje ka marrëdhënie siç përshkruhet në tabelë. Të dhënat mbi bashkëshorten nënkuptojnë se bashkëshortja është e dëmtuar nga ushtrimi i dhunës në familje nga bashkëshorti i saj, bashkëshorti është i dëmtuar nga dhuna në familje e ushtruar nga bashkëshortja, prindërit janë të dhunuar nga fëmijët dhe kështu me radhë.

TABELA 6


Marrëdhënia i dëmtuar-autorë nga dhuna në familje, për periudhën 2015-2017

	Gruaja	Burri	Prindërit	Fëmija	Familjarë të tjerë	Numri gjithsej i të dëmtuarve
2015	466	79	203	97	531	1.376
2016	591	22	280	115	608	1.616
2017	549	39	269	120	572	1.549

Numri i të dëmtuarve gjatë kësaj periudhe ka ardhur në rritje, si nga 2015-2016 dhe nga 2016-2017. Në të dyja rastet pothuajse 50 % e rritjes mund t'i atribuohet rritjes së dhunës në familje, ku e dëmtuara është bashkëshortja e dhunuesit. Në grafikun e mëposhtëm vihet re se në vitin 2017, dy të tretat e të dëmtuarve janë ose bashkëshortja e autorit ose ndonjë i afërm tjetër.

FIGURA 14

Përqindja sipas marrëdhënies i dëmtuar-autorë nga dhuna në familje në 2017



Vepra të tjera penale kundër personit

Në këtë kategori janë përfshirë të dëmtuar nga: vepra penale të kryer kundër shëndetit nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në nënkategoritë e paraqitura, si vrasjet në tentativë dhe vrasje nga pakujdesia.


Në vitin 2017, u evidentuan 2.306 të dëmtuar nga veprat të tjera penale kundër personit. Numri i personave të dëmtuar ka rënë gjatë periudhës 2015 - 2017. Numri i të dëmtuarve ka rënë me 5,4 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe në vitin pasardhës është ulur me 2,7 %.

Shpërndarja gjinore e personave të dëmtuar nga veprat penale kundër personit

Gjatë kësaj periudhe, meshkujt janë më shumë të dëmtuar nga veprat penale kundër personit. Në 2017, meshkujt janë të dëmtuar në 66,4 % të rasteve dhe femrat në 33,6 % të rasteve. Shpërndarja gjinore e personave të dëmtuar është afërsisht e njëjtë gjatë këtyre viteve. Përqindja e femrave, të dëmtuara nga vepra penale kundër personit, varion nga 33,5 % te 35,9 %. Përqindja e meshkujve varion nga 64,1 % në 66,5 %.

FIGURA 15

Përqindja e personave të dëmtuar nga vepra penale kundër personit sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017



Nënkategoritë vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit dhe vepra të tjera penale kundër personit kanë numrin më të madh të meshkujve të dëmtuar, ndërsa femrat janë më të shumta në numër si të dëmtuara nga

vepra penale e dhunës në familje dhe krime seksuale.


Përqindja e meshkujve të dëmtuar nga vepra penale me dashje kundër shëndetit varion nga 84,6 % në 86,6 %. Përqindja e femrave të dëmtuara nga vepra penale kundër shëndetit varion nga 13,4 % në 15,4 %.

Ndryshe nga nënkategoritë e tjera të veprave penale kundër personit, shumica e personave të dëmtuar nga krimet seksuale janë femra. Përqindja e femrave të dëmtuara është rritur nga 81,5 % në vitin 2015 në 89,5 % në vitin 2017. Në vitin 2015, 82,9 % e personave të dëmtuar nga krimet seksuale ishin femra. Kjo përqindje u rrit në 93,5 % në vitin 2016 dhe pastaj u zvogëlua në 90,9 % në vitin 2017. Përqindja e meshkujve të dëmtuar varion nga 10,5 % në 18,5 %.

Tabela 1.3 në shtojcë paraqet numrin e personave të dëmtuar sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit dhe gjinisë për periudhën 2015-2017.

FIGURA 16

Përqindja e personave të dëmtuar nga vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë në 2017



Struktura moshore e personave të dëmtuar

Gjatë vitit 2017, numri total i personave të dëmtuar nga veprat penale kundër personit ishte 7.257, 703 prej tyre ishin të mitur, nën moshën 18 vjeç. Numri i të miturve të dëmtuar tregon një rritje prej 12,8 % gjatë periudhës 2015-2017, ndërkohë që numri i të rriturve ka pësuar rënie me 3,9 % nga 2015 në 2017.

Nga totali i personave të dëmtuar në vitin 2017, 9,7 % e tyre ishin të mitur. Përqindja e të miturve të dëmtuar ka rënë gjatë kësaj periudhe; kjo përqindje varion nga 8,4 % në 10,0 %.

Për shumicën e nënkategorive të veprave penale kundër personit, shumica e personave të dëmtuar janë të rritur (të moshës 18 vjeç e lart). Nënkatëgoria e vetme, krime seksuale ka shumicën e të dëmtuarve të mitur (nën 18 vjeç). Në vitin 2015, 59,6 % e të dëmtuarve nga krimet seksuale ishin të mitur. Kjo përqindje pësoi rënie në vitin 2016, 56,2 % dhe në vitin 2017 u rrit në 61,4 % të mitur të dëmtuar. Përqindja e të miturve, të dëmtuar nga nënkategoria marrëdhënie seksuale me dhunë, ishte 65,7 % në 2015. Ky numër pësoi rënie në 2016, me 56,5 % të mitur dhe në 2017 me 59,1 % të mitur. Përqindja e të miturve, të dëmtuar nga krime të tjera seksuale, është rritur nga 53,9 % në 62,9 % gjatë periudhës 2015 - 2017.

Tabela 1.4 në shtojcë paraqet numrin e personave të dëmtuar të rritur dhe mitur sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit.

Nënkatëgoria vepra penale kundër shëndetit ka përqindjen më të madhe të miturve të dëmtuar (40,0 %), ndjekur nga vepra të tjera penale kundër personit (36,6 %) dhe dhuna në familje (13,4 %). Përqindja e të miturve të dëmtuar nga krimet seksuale është 10,0 %.

FIGURA 17

Përqindja e personave të dëmtuar nga veprat penale kundër personit sipas 2 ndarjeve të mëdha moshore, për periudhën 2015-2017




FIGURA 18

Përqindja që zënë të miturit dhe të rriturit në numrin e personave të dëmtuar sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit në 2017





FIGURA 19

Përqindja që zë çdo nënkategori në numrin e personave të dëmtuar të mitur për vepra penale kundër personit në 2017



1.4. PERSONA TË DYSHUAR

Ky seksion i referohet personave të dyshuar nga policia për kryerjen e një veprë penale. Policia mbledh të dhëna për të gjithë personat e dyshuar, edhe pse në sistemin e drejtësisë vetëm personat mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale.

Të dhënat mbi të dyshuarit janë të disagreguara sipas kategorive të veprave penale, gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor.

1.4.1 NUMRI GJITHSEJ I PERSONA TË DYSHUAR TË EVIDENTUAR NË KRYERJEN E NJË VEPRE PENALE

Në vitin 2017, numri gjithsej i personave të dyshuar të evidentuar nga policia ishte 36.051, 2,9 % më pak krahasuar me vitin 2015. Numri i personave të dyshuar të evidentuar ka rënë me 6,6 % nga 2015 në 2016 dhe ka pësuar rritje të lehtë me 4,0 % nga viti 2016 në vitin 2017.

TABELA 7


Numri gjithsej i personave të dyshuar sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Kategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	8.114	7.738	-4,6	7.914	2,3
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	13.479	11.457	-15,0	12.401	8,2
Krime në fushën e drogës	2.189	2.496	14,0	2.485	-0,4
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	5.067	4.958	-2,2	5.047	1,8
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	430	641	49,1	7.07	10,3
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	463	452	-2,4	466	3,1
Të tjera	7.370	6.932	-5,9	7.031	1,4
Gjithsej	37.112	34.674	-6,6	36.051	4,0

Figura 20 tregon numrin gjithsej të personave të dyshuar të evidentuar gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e të dyshuarve në raport me popullsinë. Në vitin 2017, ishin 125,5 persona të dyshuar për 10 mijë banorë. Ashtu si numri absolut i personave të dyshuar, edhe norma e të dyshuarve në raport me popullsinë ka rënë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 20

Numri gjithsej i personave të dyshuar në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vija), për periudhën 2015-2017



Nga totali i personave të dyshuar për vepra penale gjatë periudhës 2015-2017, shpërndarja e femrave varionte ndërmjet 7,2 % dhe 7,7 % dhe e meshkujve ndërmjet 92,3 % dhe 92,8 %. Shpërndarja gjinore e personave të dyshuar ishte përafërsisht e njëjtë gjatë kësaj periudhe. Viti 2016 kishte përqindjen më të lartë të femrave të dyshuara në totalin e personave të dyshuar.

Tabela 8 tregon numrin e personave të dyshuar gjithsej të veprave penale në raport me popullsinë sipas gjinisë. Në vitin 2017, numri i të dyshuarve për 10,000 banorë ishte 125,5. Kjo normë është më e lartë për meshkujt në krahasim me femrat dhe shënon 231,1 meshkuj të dyshuar për 10 000 meshkuj. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i meshkujve të dyshuar në raport me popullsinë varionte nga 219,7 në 235,9 të dyshuar; numri i femrave të dyshuara varionte nga 18,5 të dyshuar në 18,9 të dyshuar.

FIGURA 21

Përqindja e personave të dyshuar të veprave penale sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




TABELA 8

Numri gjithsej i personave të dyshuar në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas gjinisë për periudhën 2015-2017


Viti	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	37.112	128,8	2.669	18,8	34.443	235,9
2016	34.674	120,6	2.687	18,9	31.987	219,7
2017	36.051	125,5	2.637	18,5	33.414	231,1

Tabela 1.5 në shtojcë tregon numrin e personave të dyshuar sipas kategorive të veprave penale për periudhën 2015-2017.

Pjesa më e madhe e të dyshuarve i përket veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, ndjekur nga vepra penale kundër personit dhe shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor.

FIGURA 22


Përqindja e personave të dyshuar sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Veprat penale kundër personit dhe veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kanë numrin më të lartë të femrave të dyshuara për vitin 2017, sic vihet re edhe në figurën e mëposhtme.

FIGURA 23

Përqindja e personave të dyshuar sipas gjinisë dhe kategorive të veprave penale për 2017



Struktura moshore e personave të dyshuar

Numri më i madh i personave të dyshuar janë mbi moshën 45 vjeç, ndjekur nga grupmosha 25-34 vjeç.

Në vitin 2017, 32,0 % e personave të dyshuar ishin mbi 45 vjeç. Grupmosha e dytë me numrin më të madh të të dyshuarve ishte 25-34 vjeç, 26,2 % në totalin e të dyshuarve. Të dyshuarit e moshës 18-24 vjeç përbëjnë 17,6 %, ndërsa të dyshuarit 35-44 vjeç zënë 18,6 % në totalin e të dyshuarve. Personat e dyshuar të moshës nën 18 vjeç përbëjnë 5,7 % të totalit. Gjatë periudhës 2015-2017, përqindja e personave të dyshuar sipas grupmoshave është e ngjashme.

FIGURA 24

Përqindja e personave të dyshuar sipas grupmoshës, për periudhën 2015-2017




Tabela 9 paraqet numrin e personave të dyshuar sipas grupmoshave në raport me popullsinë banuese të grupmoshave të paraqitura. Renditja e grupmoshave është disi e ndryshme nga çfarë numri absolut i personave të dyshuar tregon. Në raport me popullsinë, është grupmosha 25-34 vjeç me normën më të lartë të të dyshuarve për 10.000 banorë gjatë kësaj periudhe, ndjekur nga grupmosha 35-44 vjeç dhe më pas nga grupmosha 18-24 vjeç.

Të dyshuarit të mitur paraqesin grupmoshën me normën më të ulët gjatë 2015 - 2017; kjo normë varion nga 30 në 33,6 të mitur të dyshuar për 10 mijë banorë.

TABELA 9

Numri gjithsej i personave të dyshuar në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas grupmoshës për periudhën 2015-2017

Moshë	2015		2016		2017	
	Nr.	Tregues	Nr.	Tregues	Nr.	Tregues
Nën 18 vjeç	2.283	33,6	1.982	30,0	2.053	32,0
18-24	7.101	197,5	6.346	181,4	6.329	185,4
25-34	8.809	217,9	8.909	214,8	9.435	222,4
35-44	7.232	216,9	6.260	189,2	6.706	203,2
45+	11.687	105,8	11.177	99,8	11.528	101,5
Gjithsej	37.112	128,8	34.674	120,6	36.051	125,5

Persona të dyshuar sipas nivelit arsimor

Gjatë periudhës 2015-2017, personat e dyshuar me arsim 9 vjeçar përbëjnë numrin më të madh të personave të dyshuar, ndjekur nga personat e dyshuar me arsim të mesëm.

Përqindja e personave të dyshuar me arsim 9 vjeçar është rritur gjatë kësaj periudhës; në 2015 kjo përqindje ishte 48,9 % në totalin e personave të dyshuar, në 2016 50,7 % dhe në vitin pasues ka rënë në 49,1 % në totalin e personave të dyshuar.

Personat e dyshuar me arsim të mesëm përbëjnë grupin e dytë më të madh të personave të dyshuar. Gjatë kësaj periudhe, personat e dyshuar me arsim të mesëm përbëjnë 32,0 % të totalit të personave të dyshuar.

Përqindja e personave të dyshuar me diplomë universitare ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Në vitin 2015 kjo përqindje ishte 12,5 %, në 2016 përqindja u rrit në 13,2 % dhe vitin pasardhës pati një rritje të lehtë në 13,4 % në totalin e personave të dyshuar.

TABELA 10

Numri dhe përqindja e personave të dyshuar sipas nivelit arsimor për periudhën 2015-2017

	2015		2016		2017	
Niveli arsimor	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Pa arsim	267	0,7	283	0,8	314	0,9
Fillor	1.548	4,2	1.237	3,6	1.122	3,1
9 vjeçar	18.144	48,9	17.582	50,7	17.686	49,1
I mesëm	11.985	32,3	10.944	31,6	12.112	33,6
I lartë	4.651	12,5	4.594	13,2	4.817	13,4
Panjohur	517	1,4	34	0,1	0	0
Gjithsej	37.112	100	34.674	100	36.051	100

1.4.2 PERSONA TË DYSHUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në 2017, u evidentuan 7.914 persona të dyshuar për vepra penale kundër personit, 2,5 % më pak krahasuar me vitin 2015. Numri i të dyshuarve ka pësuar rënie me 4,6 % nga 2015 në 2016 dhe ka pësuar rritje nga 2016 në 2017 me 2,3 %.

Në vitin 2017, janë evidentuar 27,5 persona të dyshuar për vepra penale kundër personit për 10 mijë banorë. Viti 2015 shënon numrin absolut dhe normën më të lartë të të dyshuarve.


TABELA 11

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	81	80	-1,2	48	-40,0
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	3.665	3.289	-10,3	3.488	6,1
Krime seksuale	163	127	-22,1	111	-12,6
Marrëdhënie seksuale me dhunë	81	47	-42,0	41	-12,8
Krime të tjera seksuale	82	80	-2,4	70	-12,5
Dhuna në familje	1.359	1.586	16,7	1.507	-5,0
Vepra të tjera penale kundër personit	2.846	2.656	-6,7	2.760	3,9
Gjithsej	8.114	7.738	-4,6	7.914	2,3

FIGURA 25

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vija), për periudhën 2015-2017



Shpërndarja gjinore e personave të dyshuar është e dominuar nga meshkujt, siç shihet edhe nga figura 26. Në 2017, 90,5 % e të dyshuarve të veprave penale kundër personit janë meshkuj dhe 9,5 % janë femra. Kjo shpërndarja gjinore e të dyshuarve është e ngjashme përgjatë kësaj periudhe. Gjatë periudhës 2015-2107, përqindja e femrave të dyshuara për vepra penale kundër personit, varion nga 8,3 % në 9,9 %.

FIGURA 26

Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017




Tabela 12 paraqet numrin e të dyshuarve për veprat penale kundër personit në raport me numrin e popullsisë. Gjatë periudhës 2015- 2107, numri i meshkujve të dyshuar në raport me popullsinë meshkuj varionte nga 47,9 në 51,0 të dyshuar për 10 mijë banorë. Numri i femrave të dyshuara varionte nga 26,9 në 28,2 të dyshuara për 10 mijë femra.

TABELA 12

Numri gjithsej i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas gjinisë për periudhën 2015-2017


Viti	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	8.114	28,2	675	4,8	7.439	51,0
2016	7.738	26,9	767	5,4	6.971	47,9
2017	7.914	27,5	753	5,3	7.161	49,5

Tabela 1.6 në shtojcë paraqet të dhëna për numrin e të dyshuarve sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit sipas gjinisë për periudhën 2015 – 2017.

Nënkategoria vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit ka numrin më të madh të personave të dyshuar, ndjekur nga vepra penale kundër personit dhe dhunë në familje.

FIGURA 27


Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Nga personat e dyshuar, pjesa më e madhe e tyre për të gjitha nënkategoritë e veprave penale ishin meshkuj.

FIGURA 28

Përqindja e personave të dyshuar sipas gjinisë dhe nënkategorive për vepra penale kundër personit, për 2017



Vrasje me dashje

Numri i të dyshuarve për vrasje me dashje ka rënë nga 81 në 2015 në 80 të dyshuar në 2016. Në vitin pasardhës numri i të dyshuarve për vrasje me dashje ra në 48 të dyshuar. Në 2015, 95,1 % e të dyshuarve për vrasje me dashje ishin meshkuj. Kjo përqindje ka pësuar rritje në 2016, 97,5 % dhe është rritur lehtë në 97,9 % në 2017.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit


Në 2017, u evidentuan 3.448 persona të dyshuar për vepra penale kryer me dashje kundër shëndetit. Numri më i madh i të dyshuarve u regjistrua në vitin 2015, me 3.665 të dyshuar. Ndërsa numri më i vogël i të dyshuarve për vepra penale kundër shëndetit është evidentuar në vitin 2016, me 3.289 të dyshuar. Përqindja e femrave të dyshuara për vepra penale kundër shëndetit varion nga 5,4 % në 6,7 % gjatë kësaj periudhe.

Krime seksuale

Numri i të dyshuarve për krime seksuale ka rënë nga 163 në 111 gjatë periudhës 2015 - 2017. Rënia është ndikuar kryesisht nga rënia e numrit të të dyshuarve për marrëdhënie seksuale me dhunë nga viti 2015 në 2017. Numri i të dyshuarve në këtë nënkategori është ulur nga 81 në 2015 në 47 të dyshuar në vitin 2016. Në vitin pasardhës është ulur përsëri në 41. Numri i të dyshuarve për krime të tjera seksuale në 2017 ishte 70, respektivisht 10 dhe 12 më pak se në 2016 dhe 2015.

FIGURA 29

Numri i personave të dyshuar për krime seksuale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Dhuna në familje

Numri i të dyshuarve për dhunë në familje u rrit nga 1.359 në vitin 2015 në 1.586 në vitin 2016. Në vitin pasues numri i të dyshuarve për dhunë në familje ra në 1.507 të dyshuar. Ashtu si në vepra të tjera penale kundër personit, shumica e personave të dyshuar për dhunë në familje ishin meshkuj gjatë periudhës trevjeçare.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në vitin 2017, u evidentuan 2.760 të dyshuar për vepra të tjera penale kundër personit. Numri i personave të dyshuar ra gjatë periudhës 2015- 2017. Numri i të dyshuarve pësoi rënie me 6,7 % nga viti 2015 në 2016 dhe në vitin pasues u rrit me 3,9 %.

Shpërndarja moshore e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit

Nga totali i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit në vitin 2017, 28,5 % e tyre ishin mbi 45 vjeç, 27,1 % i përkasin grupmoshës 25-34 vjeç, ndjekur nga grupmosha 35-44 (21,6 %). Të miturit e dyshuar përbëjnë 5,6 % të të dyshuarve për vepra penale kundër personit. Të rinjtë 18-24 vjeç përbëjnë 17,3 % në totalin të dyshuarve. Gjatë 2015-2017, përafërsisht e njëjta përqindje luhatet për grupmoshat e paraqitura (fig 30).

FIGURA 30

Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas grupmoshës, për periudhën 2015-2017




Tabela 13 tregon numrin e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas grupmoshave në raport me numrin e popullsisë.

Personat e dyshur mbi 45 vjeç përbëjnë grupin me numrin absolut më të madh të të dyshuarve. Por në raport me popullsinë, grupmosha 25-34 vjeç ka normën më të lartë gjatë kësaj periudhe, e ndjekur nga grupmosha 35-44 vjeç dhe më pas grupmosha 18-24 vjeç.

Të dyshuarit të mitur kanë normën më të ulët gjatë kësaj periudhe; kjo normë varion nga 6,3 në 6,9 të dyshuar të mitur për 10 mijë banorë.

TABELA 13

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas grupmoshës për periudhën 2015-2017

Moshë	2015		2016		2017	
	Nr	Tregues	Nr	Tregues	Nr	Tregues
Nën 18 vjeç	435	6,4	418	6,3	444	6,9
18-24	1.613	44,9	1.424	40,7	1.369	40,1
25-34	2.095	51,8	1.993	48,0	2.141	50,5
35-44	1.664	49,9	1.594	48,2	1.707	51,7
45+	2.307	20,9	2.309	20,6	2.253	19,8
Gjithsej	8.114	28,2	7.738	26,9	7.914	27,5

Persona të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nivelit arsimor

Tabela 14 paraqet numrin e të dyshuarve sipas nivelit arsimor. Gjatë periudhës 2015-2017, personat e dyshuar me arsim 9 vjeçar përbëjnë numrin më të madh të personave të dyshuar, ndjekur nga personat e dyshuar me arsim të mesëm. Personat e dyshuar pa arsim përbëjnë përqindjen më të ulët në totalin e të dyshuarve për vepra penale kundër personit.

Përqindja e personave të dyshuar me nivel të ulët arsimor ka pësuar rënie, nga 4,4 % në vitin 2015 në 3,4 % në 2017. Gjatë kësaj periudhe, përqindja e të dyshuarve me arsim 9 vjeçar ka pësuar rënie nga 2015-2017, në vitin 2015 kjo përqindje ishte 54,0 % e totalit të personave të dyshuar, në 2016, 56,3 % dhe në vitin pasardhës pësoi rënie me 54,4 % në totalin e personave të dyshuar.

Përsa u përket personave të dyshuar me arsim të mesëm, ky grup paraqet grupin e dytë më të madh të të dyshuarve. Përqindja e personave të dyshuar për këtë grup është rritur gjatë kësaj periudhe nga 30,6 % në 31,9 %.

Përqindja e personave të dyshuar me diplomë universitare është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Në vitin 2015 kjo përqindje ishte 8,0 % dhe më pas pësoi rënie në 7,9 % të të dyshuarve gjithsej në 2016 dhe në vitin pasardhës pësoi rritje të lehtë në 9,0 %.

TABELA 14

Numri dhe përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nivelit arsimor për periudhën 2015-2017

	2015		2016		2017	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Pa arsim	69	0,9	103	1,3	102	1,3
Fillor	356	4,4	289	3,7	271	3,4
9 vjeçar	4.381	54	4.356	56,3	4.303	54,4
I mesëm	2.562	31,6	2.371	30,6	2.523	31,9
I lartë	653	8	610	7,9	715	9
Panjohur	93	1,1	9	0,1	0	0
Gjithsej	8.114	100	7.738	100	7.914	100

1.4.3 PERSONA TË DYSHUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Ky seksion i referohet personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të paraqitura sipas nënkategorive të veprave penale, gjinisë, grupmohës dhe nivelit arsimor.

Në vitin 2017, numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ishte 12.401 të dyshuar, 8,0 % më pak krahasuar me vitin 2015. Numri i personave të dyshuar ka rënë me 15,0 % nga viti 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës është rritur me 8,2 %.

TABELA 15

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %


Nënkategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	5.196	4.182	-19,5	3.506	-16,2
Grabitje	203	155	-23,6	192	23,9
Mashtrime	855	1.086	27,0	1.141	5,1
Shkatërrimi i pasurisë	1.202	1.073	-10,7	1.187	10,6
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	104	75	-27,9	82	9,3
Falsifikimi i dokumenteve	905	1.079	19,2	1.142	5,8
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	2.313	1.725	-25,4	2.716	57,4
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	2.701	2.082	-22,9	2.435	17,0
Gjithsej	13.479	11.457	-15,0	12.401	8,2

Figura 31 shpreh numrin e të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e të dyshuarve në raport me popullsinë shprehur për 10 mijë banorë.

Në vitin 2017, u evidentuan 43,2 persona të dyshuar për 10 mijë banorë. Viti 2015, ka numrin absolut dhe normën më të lartë të të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

FIGURA 31

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vija), për periudhën 2015-2017



Shpërndarja gjinore e të dyshuarve dominohet nga meshkujt, siç shihet nga figura 32. Në vitin 2017, 91,5 % e të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë meshkuj dhe 8,5 % janë femra.

Shpërndarja gjinore është e ngjashme përgjatë kësaj periudhe. Gjatë periudhës 2015-2017, përqindja e femrave të dyshuara për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, varion nga 8,3 % në 9,3 %; ndërkohë përqindja e meshkujve varion nga 90,7 % te 91,7 %.

TABELA 16

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas gjinisë për periudhën 2015-2017

Viti	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	13.479	46,8	1.122	7,9	12.357	84,6
2016	11.457	39,8	1.063	7,5	10.394	71,4
2017	12.401	43,2	1.060	7,4	11.341	78,4

FIGURA 32

Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017





Tabela 16 tregon numrin e të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në raport me numrin e popullsisë sipas gjinisë. Në vitin 2017, numri i të dyshuarve për 10,000 banorë ishte 43,2. Kjo normë është më e lartë për meshkujt krahasuar me femrat dhe numëron 78,4 meshkuj të dyshuar për 10.000 meshkuj gjithsej. Gjatë periudhës 2015-2017, norma e të dyshuarve meshkuj varionte nga 71,4 në 84,6 persona të dyshuar. Ndërkohë norma e femrave varion nga 7,4 te 7,9 femra të dyshuara për 10 mijë banorë.

Tabela 1.7 në shtojcë paraqet numrin e të dyshuarve sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë gjatë periudhës 2015-2017.

Në kategorinë e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, personat e dyshuar për vjedhje të pasurisë zënë përqindjen më të madhe. Gjatë periudhës 2015-2017, kjo përqindje për vjedhjen e pasurisë ka rënë nga 38,5 % në 28,3 %.

FIGURA 33


Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Në të gjitha nënkategoritë brenda veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike meshkujt zënë përqindjen më të madhe në totalin e personave të dyshuar. Përqindja e femrave të dyshuara varion nga 2,1 % te 16,7 % për të gjitha nënkategoritë, me përjashtim të falsifikimit të dokumenteve, ku përqindja e femrave është 21,0 %.

FIGURA 34

Përqindja e personave të dyshuar sipas gjinisë dhe nënkategorive për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për 2017



Vjedhje e pasurisë

Në 2017, u evidentuan 3.506 persona të dyshuar për vjedhje të pasurisë. Numri i të dyshuarve për vjedhje të pasurisë ra gjatë periudhës 2015 - 2017. Kjo përqindje pësoi rënie me 19,5 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul sërish me 16,2 %.

Grabitja

Gjatë kësaj periudhe, numri i të dyshuarve për grabitje ka rënë nga 203 në vitin 2015 në 155 në 2016. Në vitin pasues numri i të dyshuarve për grabitje u rrit në 192 të dyshuar. Numri i të dyshuarve për grabitje është ulur me 23,6 % nga 2015 në 2016. Në vitin pasardhës, numri i grabitjeve u rrit me 23,9 %.

Mashtrime

Numri i të dyshuarve për nënkategorinë mashtrime është rritur gjatë periudhës 2015-2017, nga 855 të dyshuar në vitin 2015 në 1.141 të dyshuar në vitin 2017. Numri i të dyshuarve për mashtrime u rrit me 27,0 % nga 2015 në 2016 dhe u rrit përsëri me 5,1 % nga 2016 në 2017.

Shkatërrimi i pasurisë

Gjatë kësaj periudhe, numri i të dyshuarve për shkatërrimin e pasurisë ka rënë nga 1.202 në vitin 2015 në 1.073 në vitin 2016. Në vitin pasardhës, numri i të dyshuarve për shkatërrimin e pasurisë u rrit në 1.187 të dyshuar. Numri i të dyshuarve pësoi rënie me 10,7 % nga viti 2015 në vitin 2016. Në vitin pasues u rrit me 10,6 %.

Falsifikim i monedhës

Numri i të dyshuarve për falsifikim të monedhës ka rënë gjatë periudhës 2015-2017, nga 104 të dyshuarit në vitin 2015 në 82 të dyshuar në vitin 2017. Numri i të dyshuarve pësoi rënie me 27,9 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasues u rrit me 9,3 %.

Falsifikimi i dokumenteve


Numri i të dyshuarve për falsifikim të dokumenteve ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017, nga 905 të dyshuar në vitin 2015 në 1.142 të dyshuar në vitin 2017. Ky numër është rritur me 19,2 % nga 2015 në 2016 dhe është rritur përsëri me 5,8 % nga 2016 deri në 2017.

Veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës

Gjatë kësaj periudhe, numri i të dyshuarve për veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës ka rënë nga 2.313 në vitin 2015 në 1.725 në vitin 2016. Në vitin vijues numri i të dyshuarve u rrit në 2.716 të dyshuar. Numri i të dyshuarve pësoi rënie me 25,4 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasues u rrit 57,4 %.

FIGURA 35

Përqindja e personave të dyshuar për veprat që çënojnë regjimin juridik të tokës sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Nënkategoria e personave të dyshuar për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përfshin ata persona të dyshuar që nuk janë përfshirë në nënkategoritë e përmendura më lart. Në kapitullin e metodologjisë janë listuar seksionet e kodit penal pjesë e veprave të tjera kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Në 2017, 2.435 të dyshuar u evidentuan për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri i të dyshuarve është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër fillimisht pësoi rënie me 22,9 % nga 2015 në 2016 dhe pastaj u rrit me 17,0 % nga viti 2016 në 2017.

Në vitin 2015, personat e dyshuar për vepra të tjera penale përbëjnë 17,4 % të totalit të personave të dyshuar; në 2016

kjo përqindje ishte 16,7 % dhe në vitin pasardhës ishte 17,3 %.

Tabela 1.8 në shtojcë paraqet numrin e personave të dyshuar për këtë nënkategori sipas veprave penale dhe gjinisë.

Shpërndarja moshore e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Nga numri gjithsej i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në 2017, 39,7 % e të dyshuarve ishin mbi moshën 45 vjeç, 22,6 % ishin 25-34 vjeç, pasuar nga grupmosha 35-44 (18,0 %). Të miturit e dyshuar përbëjnë 6,6 % të të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Të rinjtë e moshave 18-24 vjeç përbënin 13,0 % të personave të dyshuar. Shpërndarja moshore nuk ka ndryshuar shumë gjatë periudhës 2015 - 2017.

FIGURA 36

Përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas grupmoshës për periudhën 2015-2017




Tabela 17 tregon numrin e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas grupmoshave në raport me numrin e popullsisë. Numri i të dyshuarve mbi 45 vjeç është grupi më i madh i të dyshuarve. Por në raport me popullsinë, grupmosha

35-44 vjeç ka normën më të lartë gjatë kësaj periudhe, ndjekur nga grupmosha 25-34 vjeç. Të miturit e dyshuar përbëjnë grupin me normën më të ulët gjatë kësaj periudhe.

TABELA 17

Numri i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, sipas grupmoshës për periudhën 2015-2017.

Moshë	2015		2016		2017	
	Nr	Tregues	Nr	Tregues	Nr	Tregues
Nën 18 vjeç	1.005	14,8	850	12,9	822	12,8
18-24	1.974	54,9	1.564	44,7	1.613	47,2
25-34	2.709	67	2.534	61,1	2.806	66,1
35-44	2.678	80,3	1.955	59,1	2.232	67,6
45+	5.113	46,3	4.554	40,7	4.928	43,4
Gjithsej	13.479	46,8	11.457	39,8	12.401	43,2

Personat e dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nivelit arsimor

Tabela 18 paraqet numrin e personave të dyshuar sipas nivelit arsimor. Gjatë periudhës 2015-2017, personat e dyshuar me arsim 9 vjeçar përbëjnë numrin më të madh të personave të dyshuar, ndjekur nga personat e dyshuar me arsim të mesëm. Personat e dyshuar pa arsim përbëjnë përqindjen më të ulët në totalin e të dyshuarve dhe kjo përqindje ka qëndruar e njëjtë gjatë kësaj periudhe.

Përqindja e personave të dyshuar me nivel të ulët arsimor ka pësuar rënie, nga 5,1 % në 2015 në 4,2 % në 2017.

Gjatë kësaj periudhe, përqindja e personave të dyshuar me arsim 9 vjeçar ka pësuar rënie; në vitin 2015 kjo përqindje ishte 50,2 % e totalit të personave të dyshuar, në 2016 ishte 50,5 % në vitin 2016 dhe më pas pësoi rënie në 49,2 % në 2017.

Përsa u përket personave të dyshuar me arsim të mesëm, ky grup paraqet grupin e dytë më të madh të të dyshuarve. Përqindja e personave të dyshuar për këtë grup është rritur gjatë kësaj periudhe nga 31,0 % në 32,6 %.

Përqindja e personave të dyshuar me diplomë universitare është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Kjo përqindje varionte nga 11,1 % në 13,0 në totalin e personave të dyshuar.

TABELA 18

Numri dhe përqindja e personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nivelit arsimor për periudhën 2015-2017

Niveli arsimor	2015		2016		2017	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Pa arsim	135	1,0	109	1,0	125	1,0
Fillor	687	5,1	558	4,9	524	4,2
9 vjeçar	6.764	50,2	5.788	50,5	6.098	49,2
I mesëm	4.179	31	3.572	31,2	4.037	32,6
I lartë	1.499	11,1	1.424	12,4	1.617	13
Panjohur	215	1,6	6	0,1	0	0
Gjithsej	13.479	100	11.457	100	12.401	100

1.4.4 PERSONA TË DYSHUAR NË KATEGORINË “VEPRA TË TJERA PENALE”

Personat e dyshuar të kategorisë së veprave të tjera penale i referohen personave të dyshuar që nuk përfshihen në seksionin e veprave penale kundër personit (1.4.2) dhe vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (1.4.3). Në kapitullin e metodologjisë janë listuar të gjithë kapitujt e tjerë të kodit penal, duke përjashtuar kapitullin 2 dhe 3. Të dhënat paraqiten sipas nënkategorive të veprave penale të përzgjedhura për tu analizuar, gjinisë dhe grupmoshës.

Në 2017, u evidentuan 15.736 persona të dyshuar të kategorisë së veprave të tjera penale. Numri gjithsej i të dyshuarve tregon një rritje prej 1,4 % nga 2015 në 2017. Numri i të dyshuarve ka pësuar rënie me 0,3 % nga viti 2015 në 2016 dhe ka pësuar rritje me 1,7 % nga 2016 deri në 2017.

TABELA 19


Numri i personave të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	2.189	2.496	14,0	2.485	-0,4
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	5.067	4.958	-2,2	5.047	1,8
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	430	641	49,1	707	10,3
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	463	452	-2,4	466	3,1
Të tjera	7.370	6.932	-5,9	7.031	1,4
Gjithsej	15.519	15.479	-0,3	15.736	1,7

Nëse do ta shprehnim numrin e të dyshuarve në raport me popullsinë, në 2017 numëroheshin 54,8 të dyshuar për 10 mijë banorë. Ky vit ka numrin absolut dhe normën më të lartë të të dyshuarve.

FIGURA 37


Numri i personave të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vija), për periudhën 2015-2017



Në 2017, 94,8 % të të dyshuarve në kategorinë vepra të tjera penale janë mesdhkuj dhe 5,2 % janë femra. Shpërndarja gjinore nuk ka ndryshuar shumë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 38

Përqindja e personave të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017



Veprat penale në fushën e drogës

Në 2017, u evidentuan 2.485 të dyshuar për vepra penale në fushën e drogës. Numri i personave të dyshuar për vepra penale në fushën e drogës ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u rrit me 14,0 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 0,4 %. Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike është vepra me numrin më të madh të të dyshuarve gjatë viteve 2015-2017. Nga numri total i personave të dyshuar për vepra penale të tjera, personat e dyshuar për vepra penale në fushën e drogës përbënin 14,1 % në vitin 2015, në vitin 2016 kjo përqindje u rrit në 16,1 % dhe pastaj pësua rënie të lehtë në 15,8 % të totalit të të dyshuarve të kësaj kategorie.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor

Gjatë kësaj periudhe, numri i personave të dyshuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor ka pësuar rënie, nga 5.067 të dyshuar në vitin 2015 në 4.958 të dyshuar në vitin 2016. Në vitin pasues, numri i personave të dyshuar pësoi rritje në 5.047 të dyshuar. Personat e dyshuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor zënë përqindjen më të lartë nga numri total i të dyshuarve për kategorinë vepra të tjera penale; kjo përqindje varion nga 32,0 % në 32,7 %.

Drejtimi i automjetit në mënyrë të papërshtatshme dhe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor janë veprat me numrin më të madh të të dyshuarve në nënkategorinë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Numri i personave të dyshuar për veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit është rritur gjatë periudhës 2015-2017, nga 430 të dyshuar në vitin 2015 në 707 të dyshuar në vitin 2017.

Vepra penale me numrin më të madh të të dyshuarve në këtë nënkategori është kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë.

Pastrim i parave

Nënkategoria e veprës penale të pastrimit të parave përbën nënkategorinë e dytë me përqindjen më të ulët të të dyshuarve në kategorinë e veprave të tjera penale gjatë kësaj periudhe, përafërsisht 3,0 % e totalit. Numri i të dyshuarve të veprave penale të pastrimit të parave është rritur gjatë periudhës 2015-2017, nga 463 të dyshuar në 2015 në 466 të dyshuar në vitin 2017.

Shpërndarja moshore e të dyshuarve për kategorinë “vepra të tjera penale

Nga të dyshuarit për vepra penale në kategorinë e veprave të tjera penale në vitin 2017, 28,5 % e tyre ishin 25-34 vjeç, 27,6 % ishin 45+, 21,3 % ishin 18-24 vjeç, ndjekur nga grupmosha 35-44 (17,6 %) . Të miturit e dyshuar përbënin 5,0 % të të dyshuarve për vepra penale në kategorinë e veprave të tjera penale. Shpërndarja moshore e të dyshuarve nuk ka ndryshuar shumë gjatë periudhës 2015 - 2017.

FIGURA 39

Përqindja e personave të dyshuar në kategorinë vepra të tjera penale sipas grupmoshës, për periudhën 2015-2017




Tabela 20 tregon numrin e personave të dyshuar për vepra penale në kategorinë vepra të tjera penale në raport me numrin e popullsisë sipas grupmoshave të paraqitura. Grupmosha 25-34 vjeç ka normën më të lartë të të dyshuarve në raport me popullsinë gjatë kësaj periudhe, ndjekur nga grupmosha 18-24 vjeç.

TABELA 20

Numri dhe përqindja e personave të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas nivelit arsimor për periudhën 2015-2017

Moshë	2015		2016		2017	
	Nr	Tregues	Nr	Tregues	Nr	Tregues
Nën 18 vite	843	12,4	714	10,8	787	12,3
18-24	3.514	97,8	3.358	96,0	3.347	98,0
25-34	4.005	99,1	4.382	105,6	4.488	105,8
35-44	2.890	86,7	2.711	81,9	2.767	83,8
45+	4.267	38,6	4.314	38,5	4.347	38,3
Gjithsej	15.519	53,9	15.479	53,8	15.736	54,8

Të miturit e dyshuar kanë normën më të ulët gjatë kësaj periudhe; kjo normë varion nga 10,8 në 12,4 të dyshuar të mitur për 10 mijë banorë.

1.4.5 TË MITURIT

Seksioni i fundit i kapitullit të parë paraqet rezultatet për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët janë persona të dyshuar ndërmjet moshës 14 dhe 17 vjeç. Në këtë seksion numri i të rriturve të dyshuar do të prezantohet si një grup krahasimi. Numri i të miturve dhe i të rriturve të dyshuar nuk përbën numrin total të personave të dyshuar, sepse në totalin e të dyshuarve përfshihet edhe grupmosha (nën 14 vjeç), por ky grup është i përjashtuar në këtë seksion. Duke patur parasysh faktin që vetëm personat mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale, është përjashtuar grupmosha nën 14 vjeç. Numri gjithsej i të dyshuarve është i barabartë me shumën e të miturve (14-17 vjeç) dhe të rriturve të dyshuar (mbi 18 vjeç).

Në vitin 2017, numri i të miturve të dyshuar ishte 1.740. Numri i të miturve tregon një rënie prej 11,4 % gjatë periudhës 2015-2017, ndërkohë që numri i personave të rritur të dyshuar ka pësuar rënie me 2,4 % nga 2015 në 2017.

Nga numri total i personave të dyshuar në vitin 2017, 4,9 % ishin të mitur. Përqindja e të miturve të dyshuar ka rënë gjatë kësaj periudhe; kjo përqindje varion ndërmjet 5,3 % dhe 4,9 %.

FIGURA 40

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar për vepra penale, për periudhën 2015-2017





Figura më poshtë paraqet përqindjen e të miturve dhe të rriturve të dyshuar sipas kategorive të veprës penale. Siç vihet re nga figura, përqindja që të miturit zënë në të gjitha kategoritë e paraqitura është më e vogël se 8,0 %.

Përqindja e të miturve të dyshuar është pak më e lartë në kategoritë e krimeve të drogës dhe në veprat penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor krahasuar me kategoritë e tjera të veprave penale.

FIGURA 41


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar sipas kategorive të vepra penale, për 2017



Në figurën më poshtë tregohet se në 2017, nga 1.740 të dyshuar të mitur gjithsej, veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (33,9 %) dhe veprat penale kundër personit (23,2 %) janë dy kategoritë me numrin më të madh të të dyshuarve të mitur.

FIGURA 42

Përqindja e personave të mitur të dyshuar sipas kategorive të veprave penale, për 2017



Në tabelën shtojcë 1.9 paraqitet numri i të dyshuarve të mitur dhe të rritur sipas kategorive të veprave penale.

1.4.5.1 TË MITUR TË DYSHUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në vitin 2017, numri i të dyshuarve të mitur për vepra penale kundër personit ishte 403. Numri i të dyshuarve për vepra penale kundër personit është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të miturve të dyshuar ka rënë me 4,3 % nga 2015 në 2016, dhe pastaj është rritur me 7,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Nga totali i personave të dyshuar për vepra penale kundër personit në vitin 2017, 5,1 % ishin të mitur. Përqindja e të miturve të dyshuar varion nga 4,9 % në 5,1 % gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 43

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar për vepra penale kundër personit, për periudhën 2015-2017





Figura më poshtë paraqet përqindjen e të miturve të dyshuar sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit. Siç shihet nga figura, për vepra penale kundër personit, të dyshuarit e mitur zënë një përqindje shumë herë më të vogël se të rriturit, më pak se 11,0 % në të gjitha nënkategoritë e veprave penale kundër personit.

Përqindja e të miturve të dyshuar është pak më e lartë në nënkategoritë e krimeve seksuale krahasuar me nënkategoritë e tjera.

FIGURA 44


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Në figurën më poshtë tregohet se në 2017, nga 403 të dyshuar të mitur gjithsej për vepra penale kundër personit, veprat penale kundër shëndetit (66,7 %) dhe vepra të tjera penale kundër personit (23,6 %) ishin dy nënkategoritë më të mëdha.

FIGURA 45

Përqindja e personave të mitur të dyshuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



Në shtojcë, tabela 1.10 paraqet numrin e të dyshuarve të mitur dhe të rritur për vepra penale kundër personit për nënkategoritë e paraqitura më lart.

1.4.5.2 TË MITUR TË DYSHUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Në 2017, numri i të dyshuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ishte 509. Numri i të miturve të dyshuar për veprën penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të miturve të dyshuar ra me 15,8 % nga 2015 në 2016, dhe në vitin pasardhës ra përsëri me 10,6 %.

Nga totali i personave të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike 2017, 4,8 % ishin të mitur. Përqindja e të miturve të dyshuar varion nga 4,8 % në 5,9 %.

FIGURA 46

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, për periudhën 2015-2017





Figura më poshtë paraqet përqindjen e të miturve të dyshuar sipas nënkategorive të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Siç shihet nga figura, për vepra penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike, të dyshuarit e miturit zënë një pjesë shumë më të vogël krahasuar me të rriturit, më pak se 25,0 % në të gjitha nënkategoritë në veprat penale kundër pasurisë dhe sferën ekonomike.

Përqindja e të miturve të dyshuar është më e lartë në nënkategorinë grabitje dhe vjedhje e pasurisë krahasuar me nënkategoritë e tjera.

FIGURA 47


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Në figurën 48 paraqitet përqindja e të miturve sipas nënkategorive të veprave penale. Në 2017, nga 509 të dyshuar të mitur gjithsej për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, vjedhja e pasurisë (68,6 %) përbën nënkategorinë me numrin më të madh të të dyshuarve. Përqindja e të miturve në nënkategoritë e tjera të veprave penale është më e ulët se 10 %.

FIGURA 48

Përqindja e personave të mitur të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Në Shtojcë, tabela 1.11 paraqet numrin e të dyshuarve të mitur dhe të rritur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për nënkategoritë e paraqitura më lart.

1.4.5.4 TË MITUR TË DYSHUAR PËR KATEGORINË VEPRAT TË TJERA PENALE

Në vitin 2017, numri i të miturve të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale ishte 747. Numri i të miturve të dyshuar për kategorinë vepra penale të tjera ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të miturve të dyshuar ra me 13,1 % nga 2015 në 2016, dhe më pas u rrit me 9,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Figura më poshtë paraqet përqindjen e të miturve të dyshuar sipas nënkategorive të veprave penale në kategorinë e veprave të tjera penale. Përqindja e të miturve të dyshuar për krime në fushën e drogës është me lartë krahasuar me nënkategoritë e tjera të veprave penale. Në kapitullin e metodologjisë janë listuar kapitujt e kodit penal pjesë e kësaj kategorie. Pra në kategorinë vepra të tjera penale janë përfshirë të gjitha veprat penale të kodit penal me përjashtim të veprave penale të kapitullit 2 dhe 3 të kodit penal, vepra penale kundër personit dhe vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

FIGURA 49.

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar në kategorinë vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017





FIGURA 50.


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dyshuar në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Në figurën 51 paraqitet përqindja e të miturve sipas nënkategorive të veprave penale, për vitin 2017. Nga figura 51 vihet re se në vitin 2017, nga 747 të dyshuar të mitur në kategorinë vepra të tjera penale, nënkategoria shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (44,4 %) zë përqindjen më të madhe të të miturve të dyshuar, ndjekur nga krimet në fushën e drogës (24,8 %).

FIGURA 51

Përqindja e personave të mitur të dyshuar në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



Në Shtojcë, tabela 1.12 paraqet numrin e të miturve dhe të rriturve të dyshuar për kategorinë vepra të tjera penale. Në kapitullin e metodologjisë janë shënuar kapitujt kryesor të kodit penal që përfshihen në kategorinë vepra të tjera penale.

STATISTIKA MBI PROCEDIME PENALE DHE PERSONA TË PANDEHUR

2.1 HYRJA

Ky kapitull paraqet të dhëna për numrin e procedimeve penale të regjistruara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim, të dhënat për të pandehurit sipas llojit të veprave penale dhe karakteristikat e tyre. Burimi i të dhënave është Prokuroria e Përgjithshme dhe pasqyron të dhëna për 3 vjet, 2015-2017.

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm udhëheq hetimin penal, kryen ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjykatë në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Fokusi në procedimet penale do të jetë kryesisht në procedime për vepra penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, vepra penale në fushën e drogës, shkeljet lidhur me rregullat e qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave. Këto kategori paraqesin procedimet penale më të zakonshme të regjistruara.

2.1.1 PROCEDIME TË VEPRAVE PENALE

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim. Statistikat mbi procedimet e regjistruara penale japin një pamje të rasteve të regjistruara në Prokurori. Në shumicën e rasteve, veprat penale janë ato të regjistruara nga policia dhe për të cilat ka filluar hetimi penal nga prokuroria. Por në vëmendjen e prokurorisë janë edhe referime të tjera, jo vetëm referime nga policia.

Në një procedim penal regjistrohen të gjitha veprat penale të një rasti, por për qëllime statistikore regjistrohet vetëm vepra kryesore. Kështu, në statistikat e prokurorisë zbatohet rregulli i veprës penale kryesore, ndërsa veprat penale të shumfishta dhe ato me dënime më të vogla nuk do të merren parasysh në të gjitha rastet.

2.1.2 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM

Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një veprë penale.

Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim është më i ulët krahasuar me procedimet e regjistruara për të njëjtën vepër penale, sepse në disa raste procedimi penal mund të përfundojë, disa prej tyre mund të pezullohen ose të pushohen, ose dy çështje mund të bashkohen në një.

Për disa vepra penale, numri i procedimeve penale mund të jetë më i lartë se numri i veprave penale të regjistruara nga policia, kjo ndodh ndër të tjera edhe sepse midis dy institucioneve ndryshon mënyra se si mblidhen të dhënat. Faza e mbledhjes së të dhënave, rregullat e numërimit dhe njësia e numërimit janë të ndryshme nga policia në prokurori.

Statistikat bazohen në klasifikimin ligjor të veprës penale, Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

2.1.3 TË PANDEHURIT

Ky kapitull paraqet të dhëna për numrin e të pandehurve sipas gjinisë, sipas kategorive të veprave penale dhe dy ndarjeve kryesore moshore.

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Numri i të pandehurve për një vepër penale mund të jetë më i lartë krahasuar me numrin e procedimeve penale, sepse një procedim mund të ketë më shumë se një të pandehur.

I pandehuri konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar.

2.2. PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA

Procedimi penal i referohet një hetimi penal të filluar nga prokuroria. Procedimi penal i regjistruar për një vit u referohet procedimeve të reja penale të regjistruara për atë vit, jo rastet nga viti i kaluar, ose procedimet që janë rifilluar.

2.2.1 PROCEDIME PENALE GJITHSEJ

Në vitin 2017, prokuroria regjistroi gjithsej 31.462 procedime penale. Numri gjithsej i procedimeve të regjistruara tregon një rënie prej 3,1 % nga 2015 në 2017. Numri i procedimeve penale të regjistruara ra me 3,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas pësoi një rritje të lehtë me 0,6 % nga 2016 deri në 2017.

Procedimet më të zakonshme penale të regjistruara gjatë periudhës 2015-2017 konsistojnë në vjedhjet e pasurisë në kategorinë e procedimeve penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, dhuna në familje në kategorinë e procedimeve penale kundër personit, veprat penale në lidhje me rregullat e qarkullimit rrugor dhe veprat penale në fushën e drogës në kategorinë e procedimeve të tjera penale të regjistruara.

Procedimet penale për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përbëjnë 55,8 % të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2017, ndjekur nga procedimet penale për vepra penale kundër personit me 11,2 %, procedime penale për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor 10,9 % dhe procedime penale për vepra penale në fushën e drogës 5,6 %. Kategoria vepra të tjera penale përfshin ato vepra penale që nuk janë përfshirë në asnjë nga kategoritë e tjera.

TABELA 1

Numri gjithsej i procedimeve penale të regjistruara sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Kategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	3.340	3.341	0,0	3.512	5,1
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	18.460	16.603	-10,1	17.568	5,8
Krime në fushën e drogës	2.033	2.795	37,5	1.767	-36,8
Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor	3.491	3.415	-2,2	3.419	0,1
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	426	642	50,7	607	-5,5
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	243	248	2,1	319	28,6
Të tjera	4.459	4.239	-4,9	4.270	0,7
Gjithsej	32.452	31.283	-3,6	31.462	0,6

FIGURA 1

Përqindja që zë çdo kategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale të regjistruara për 2017





Figura 2 paraqet ndryshimin në përqindje të procedimeve penale gjatë viteve 2017 dhe 2015. Veprat penale në fushën e drogës, veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor dhe vepra të tjera penale paraqesin kategoritë ku numri i procedimeve penale ka pësuar rënie. Procedimet e regjistruara penale për veprat penale në fushën e drogës dhe për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kanë pësuar rënie më së shumti, respektivisht me 13,1% dhe 4,8 % krahasuar me vitin 2015.

Pastrimi i parave, kalim i paligjshëm i kufirit dhe veprat penale kundër personit janë kategoritë ku numri i procedimeve penale të regjistruara ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2015. Procedimet penale të regjistruara për pastrimin e parave dhe kalim i paligjshëm i kufirit kanë pësuar rritje më së shumti, 31,3 % dhe 42,5 % krahasuar me 2015.

FIGURA 2

Ndryshimi në përqindje i procedimeve penale të regjistruara sipas kategorive të veprave penale midis 2015 dhe 2017



2.2.2 PROCEDIME PENALE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Në veprat penale kundër personit janë përfshirë të dhjetë seksionet e kapitullit 2 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për qëllime statistikore do të analizojmë veprat kryesore si vrasjet me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krimet seksuale të ndara në marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale dhe dhuna në familje.

Në vitin 2017, u regjistruan 3.512 procedime për vepra penale kundër personit.

TABELA 2


Numri gjithsej i procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	141	167	18,4	120	-28,1
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	822	738	-10,2	862	16,8
Krime seksuale	130	109	-16,2	102	-6,4
Marrëdhënie seksuale me dhunë	71	41	-42,3	45	9,8
Krime të tjera seksuale	59	68	15,3	57	-16,2
Dhuna në familje	1.206	1.355	12,4	1.310	-3,3
Vepra të tjera penale kundër personit	1.041	972	-6,6	1.118	15,0
Gjithsej	3.340	3.341	0,0	3.512	5,1

Dhuna në familje paraqet veprën penale me numrin më të madh të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2017 kjo vepër përbën 37,3 % të totalit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër personit.

FIGURA 3

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër personit për 2017



Vrasje me dashje

Në vitin 2017, 120 procedime penale janë regjistruar për vrasje me dashje. Numri i procedimeve për vrasje me dashje ka rënë me 14,8 % nga viti 2015 në 2017. Numri i procedimeve për vrasjet me dashje është rritur me 26 vrasje nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ka rënë, me 47 raste.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në 2017, janë regjistruar 862 procedime penale për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Numri i procedimeve të regjistruara tregon një rritje prej 4,8 % gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër është ulur me 10,2 % nga 2015 në 2016 dhe më pas është rritur me 16,8 % nga 2016 deri në 2017.

Krime seksuale

Në vitin 2017, u regjistruan 102 procedime penale për krime seksuale. Numri i procedimeve penale për krimet seksuale tregon një rënie prej 21,5 % nga 2015 në 2017.


Numri i procedimeve të regjistruara për krime seksuale ka rënë me 21 raste nga 2015 në 2016 dhe pastaj është ulur, me 7 raste në vitin 2017. Këto procedime penale janë ndarë në dy nën-kategori (marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale). Rënia e numrit të procedimeve penale për krimet seksuale është nxitur kryesisht nga rënia e numrit të procedimeve lidhur me nënkategorinë marrëdhënie seksuale me dhunë.

Gjatë një viti, numri i procedimeve për marrëdhënie seksuale me dhunë u ul me 42,3 %, nga 71 në vitin 2015 në 41 në vitin 2016. Në vitin 2017, numri i procedimeve penale për marrëdhënie seksuale me dhunë ishte 45, katër raste më shumë se në vitin 2016. Në të njëjtën periudhë, numri i procedimeve penale lidhur me krimet e tjera seksuale pësoi një rritje nga 59 në vitin 2015, në 68 në 2016 dhe pastaj u ul përsëri në 57 në vitin 2017.

Figura më poshtë tregon trendin e përgjithshëm të numrit të procedimeve penale për dy nënkategoritë e krimeve seksuale.

FIGURA 4

Numri i procedimeve penale për krime seksuale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Dhuna në familje

Dhuna në familje përfshin rrahjen, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.

Numri i procedimeve të regjistruara në lidhje me dhunën në familje u rrit me 12,4 %, nga 1.206 procedime në vitin 2015, në 1.355 procedime në vitin 2016. Pastaj, nga viti 2016 në vitin 2017 pësoi një rënie të lehtë prej 3,3 %, nga 1.355 procedime penale në 1.330.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në kategorinë "vepra të tjera penale kundër personit" janë përfshirë: vepra penale kundër shëndetit të shkaktuara nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në këto kategori, si vrasje në tentativë, vrasje nga pakujdesia.

Në vitin 2017, janë regjistruar 1.118 procedime për vepra të tjera penale kundër personit. Numri i procedimeve të regjistruara në këtë kategori, nga viti 2015 në vitin 2017, është rritur me 7,4 %. Ky numër u ul me 6,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rritje me 15,0 % në 2017.

2.2.3 PROCEDIME PENALE PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike i referohen neneve 134-200 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në total janë 11 seksione që lidhen me këtë kapitull.

Në vitin 2017, Prokuroria regjistroi 17.568 procedime penale për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri gjithsej i procedimeve penale për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka rënë me 4,8 % nga viti 2015 në 2017. Numri i procedimeve penale ka rënë me 10,1% nga viti 2015 në vitin 2016. Në vitin pasues u rrit me 5,8 %.

TABELA 2


Numri gjithsej i procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	12.309	11.301	-8,2	10.452	-7,5
Grabitje	508	323	-36,4	355	9,9
Mashtrimet	1.071	1.401	30,8	1.060	-24,3
Shkatërrimi i pasurisë	963	770	-20,0	1.332	73,0
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	133	96	-27,8	81	-15,6
Falsifikimi i dokumenteve	986	968	-1,8	1.351	39,6
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	1.244	992	-20,3	2.106	112,3
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	1.246	752	-39,6	831	10,5
Gjithsej	18.460	16.603	-10,1	17.568	5,8

Figura 5 shpreh përqindjen e procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në totalin e procedurave penale të regjistruara për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për vitin 2017. Figura tregon se nënkategoria vjedhja e pasurisë zë pjesën më të madhe, e ndjekur nga veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës. Ndërkohë grabitjet dhe falsifikimet e monedhës paraqesin nënkategoritë me përqindjen më të ulët në totalin e procedimeve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

FIGURA 5

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për 2017



Vjedhje e pasurisë

Në vitin 2017, u regjistruan 10.452 procedime për vjedhje të pasurisë. Numri i procedimeve të regjistruara për vjedhje të pasurisë ka rënë gjatë periudhës 2015 - 2017.

Ky numër ka rënë me 8,2 % nga viti 2015 në 2016 dhe 7,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Grabitjet

Në vitin 2017, u regjistruan 355 procedime për grabitje. Numri i procedimeve të regjistruara për grabitje ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është ulur me 36,4 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka shfaqur një rritje prej 9,9 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Mashtime

Në 2017, u regjistruan 1.060 procedime për mashtim. Numri i procedimeve për nënkategorinë mashtime ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 30,8 % nga viti 2015 në 2016 dhe ka rënë me 24,3 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Shkatërrimi i pasurisë

Në vitin 2017, janë regjistruar 1.332 procedime penale për shkatërrimin e pasurisë. Numri i procedimeve penale për shkatërrimin e pasurisë është rritur gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër është ulur me 20,0 % nga viti 2015 në 2016 dhe pastaj është rritur me 73,0 % nga viti 2016 në 2017.

Falsifikimi i monedhave

Në vitin 2017, u regjistruan 81 procedime penale për falsifikim të monedhave. Numri i procedimeve për

falsifikim të monedhës ka rënë nga viti 2015 në 2017. Ky numër u ul me 27,8 % nga viti 2015 në 2016 dhe më pas pësoi rënie me 15,6 % nga 2016 në 2017.

Gjatë periudhës 2015-2017, procedimet penale për falsifikim të monedhës përbëjnë përqindjen më të ulët nga numri gjithsej i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Falsifikimi i dokumenteve

Në vitin 2017, janë regjistruar 1.351 procedime penale lidhur me nënkategorinë e falsifikimit të dokumenteve.

Numri i këtyre procedimeve penale ka rënë me 1,8 % nga viti 2015 në vitin 2016. Në vitin vijues numri i procedimeve të regjistruara për falsifikim të dokumenteve u rrit me 39,6 %.


Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës

Në vitin 2017, u regjistruan 2.106 procedime penale për vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës. Numri i procedimeve për veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës është rritur nga viti 2015 në 2017. Ky numër është ulur me 20,3 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas numri i procedimeve penale është rritur me shumë se dyfishi nga viti 2016 në vitin 2017.

Gjatë periudhës 2015-2017, vepra penale e ndërtimit të paligjshëm (neni 199 / a) zë pjesën më të madhe nga totali i procedimeve penale për veprat penale kundër regjimit juridik të tokës, ndjekur nga pushtimi i paligjshëm i tokës (neni 200), siç tregohet në figurën mëposhtë.

FIGURA 6

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale për veprat që çenojnë regjimin juridik të tokës, për periudhën 2015-2017



Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Në këtë kategori janë përfshirë seksionet e tjera të lidhura me kapitullin 3 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë "Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike", si veprat penale të kryera në shoqëri tregtare, veprat penale në fushën e doganave, veprat penale lidhur me tatimet, vepra penale në fushën e falimentimit, zhvillimit të paligjshëm të lojërave të fatit.

Në 2017 u regjistruan 831 procedime penale për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri i procedimeve ka rënë nga viti 2015 në 2017.

Procedimet e kategorisë së veprave të tjera penale zënë përafërsisht të njëjtën përqindje në totalin e procedimeve të regjistruara në veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, përkatësisht 6,7 % në vitin 2015, 4,5 % në vitin 2016 dhe 4,7 % në 2017.

Në këtë kategori, procedimet penale lidhur me tatimet zënë përqindjen më të lartë gjatë periudhës 2015-2017.

Tabela 2.1 në shtojcë paraqet numrin e procedimeve penale për nënkategoritë e përfshira në vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

TABELA 4

Numri gjithsej i procedimeve penale të regjistruara në kategorinë Vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	2.033	2.795	37,5	1.767	-36,8
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	3.491	3.415	-2,2	3.419	0,1
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	426	642	50,7	607	-5,5
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	243	248	2,1	319	28,6
Të tjera	4.459	4.239	-4,9	4.270	0,7
Gjithsej	10.652	11.339	6,4	10.382	-8,4

2.2.4 PROCEDIMET PENALE PËR KATEGORINË "VEPRA TË TJERA PENALE"

Procedimet penale të regjistruara për kategorinë vepra të tjera penale paraqesin të dhëna për ato procedime që nuk janë përfshirë në procedimet penale për vepra penale kundër personit (Seksioni 2.2.2) dhe procedimet penale për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (Seksioni 2.2.3). Në kategorinë e procedimeve të tjera penale janë analizuar procedimet lidhur me veprat penale në fushën e drogës, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave.

Tabela 4 tregon numrin e procedimeve penale të regjistruara në kategorinë vepra të tjera penale gjatë periudhës 2015-2017. Në vitin 2017, janë regjistruar 10.382 procedime penale në kategorinë vepra të tjera penale.

Numri gjithsej i procedimeve tregon një rënie të lehtë prej 2,5 % nga 2015 në 2017. Numri i procedimeve penale është rritur me 6,4 % nga 2015 në 2016 dhe më pas është ulur me 8,4 % nga 2016 deri në 2017.

Vepra penale në fushën e drogës

Në vitin 2017, u regjistruan 1.767 procedime lidhur me veprat penale në fushën e drogës. Numri i procedimeve të regjistruara për veprat penale në fushën e drogës ka rënë gjatë kësaj periudhe. Ky numër u rrit me 37,5 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ra me 36,8 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor

Në 2017, u regjistruan 3.419 procedime lidhur me shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i procedimeve lidhur me këtë nënkategori ka rënë. Ky numër është ulur me 2,2 % nga 2015 në 2016, dhe në vitin pasues ka mbetur përafërsisht i njëjtë. Nga viti 2016 në vitin 2017, numri i procedimeve të regjistruara u rrit me katër vepra, nga 3.415 në vitin 2016 në 3.419 në vitin 2017.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Në 2017, u regjistruan 607 procedimeve penale për kalim të paligjshëm të kufirit. Numri i procedimeve penale për kalim të paligjshëm të kufirit ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u rrit me 50,7 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 5,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Pastrimi i parave

Në vitin 2017 janë regjistruar 319 procedime për veprat penale të pastrimit të parave. Numri i procedimeve për këtë vepër është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u rrit me 2,1 % nga 2015 në 2016 dhe përsëri u rrit me 28,6 % në 2017.

2.3 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM

Procedimi penal për gjykim është procedura e dërgimit për gjykim të një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, ku parashikohet dënimi dhe ndëshkimi i personit të akuzuar.

Procedimet penale për gjykim të një viti u referohen procedimeve të dërguara për gjykim në vitin referues, në gjykimin e një vepre penale.

2.3.1 NUMRI GJITHSEJ I PROCEDIMEVE PENALE PËR GJYKIM

Në vitin 2017, 11.492 procedime penale janë dërguar për gjykim, 36,5 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara. Në vitin 2015, kjo përqindje ishte 45,1 %, në vitin e ardhshëm përqindja e procedimeve penale për gjykim u ul në 41,5 % procedime për gjykim nga totali i procedimeve të regjistruara.

Numri gjithsej i procedimeve për gjykim u ul me 21,5 % nga 2015 në 2017. Numri i procedimeve penale për gjykim ka rënë me 11,2 % nga 2015 në 2016 dhe me 11,6 % nga 2016 në 2017.

TABELA 5

Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Kategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	2.051	2.044	-0,3	1.767	-13,6
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	6.590	4.933	-25,1	4.249	-13,9
Krime në fushën e drogës	503	734	45,9	809	10,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	3.087	2.906	-5,9	2.734	-5,9
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	296	431	45,6	344	-20,2
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	17	15	-11,8	36	140,0
Të tjera	2.091	1.934	-7,5	1.553	-19,7
Gjithsej	14.635	12.997	-11,2	11.492	-11,6

Procedimet penale dërguar për gjykim për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përbëjnë 37,0 % të totalit të procedimeve penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2017, ndjekur nga procedimet për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me 23,8 %, dhe veprat penale kundër personit me 15,3 %. Kategoria “Vepra të tjera penale” përfshin të gjithë veprat penale që nuk janë pjesë në asnjë nga kategoritë e paraqitura.

Figura 8 tregon ndryshimin në përqindje të procedimeve penale për gjykim gjatë viteve 2017 dhe 2015. Pastrimi i parave, veprat penale në fushën e drogës, kalim i paligjshëm i kufirit janë kategoritë ku numri i procedimeve penale për gjykim është rritur.

Procedimet penale për gjykim për pastrim parash dhe vepra penale në fushën e drogës kanë pësuar rritje më së shumti, krahasuar me vitin 2015. Në vitin 2017, janë dërguar për gjykim 36 procedime penale për pastrim parash, 19 procedime penale më shumë krahasuar me vitin 2015. Në lidhje me procedimet e veprave penale në fushën e drogës, në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 60,8 % më shumë procedime krahasuar me vitin 2015. Procedimet penale për gjykim të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale kundër personit, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor janë kategori që kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2015.

FIGURA 7

Përqindja që zë çdo kategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale për gjykim për 2017





FIGURA 8

Ndryshimi në përqindje të procedimeve penale për gjykim sipas kategorive të veprave penale midis 2015 dhe 2017



2.3.2 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM PËR VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Në vitin 2017, u dërguan për gjykim 1.767 procedime penale për veprat penale kundër personit. Numri gjithsej i procedimeve për gjykim për veprat penale kundër personit tregon një rënie me 13,8 % nga 2015 në 2017. Numri i procedimeve për gjykim ka rënë me 7 raste nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rënie me 277 raste nga 2016 në 2017.

Gjatë kësaj periudhe, përqindja e procedimeve penale dërguar për gjykim për veprat penale kundër personit nga totali i procedimeve penale të regjistruara ka pësuar rënie. Në vitin 2017, 50,3 % e procedimeve penale të regjistruara

për veprat penale kundër personit janë dërguar për gjykim. Në vitin 2015, 61,4 % e këtyre procedimeve u dërguan për gjykim dhe në vitin 2015 61,2 % e këtyre procedimeve u dërguan për gjykim.

Tabela 6 tregon numrin e procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër personit dhe ndryshimin në përqindje, për periudhën 2015 - 2017.


TABELA 6

Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	85	68	-20,0	59	-13,2
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	434	361	-16,8	294	-18,6
Krime seksuale	68	59	-13,2	64	8,5
Marrëdhënie seksuale me dhunë	32	18	-43,8	25	38,9
Krime të tjera seksuale	36	41	13,9	39	-4,9
Dhuna në familje	1.023	1.157	13,1	1.057	-8,6
Vepra të tjera penale kundër personit	441	399	-9,5	293	-26,6
Gjithsej	2.051	2.044	-0,3	1.767	-13,6

FIGURA 9

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër personit për 2017



Vrasje me dashje

Në vitin 2017, 59 procedime penale për vrasje me dashje janë dërguar për gjykim. Numri i procedimeve penale për gjykim ka rënë me 30,6 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i procedimeve penale për gjykim për vrasje me dashje ka rënë me 17 raste nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ra me 9 procedime.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në 2017, 294 procedime penale për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit u dërguan për gjykim. Numri i këtyre veprave penale ka pësuar rënie me 32,3 % gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër ka rënë me 16,8 % nga 2015 në 2016 dhe me 18,6 % nga 2016 në 2017.


Krime seksuale

Në 2017, 64 procedime penale për krime seksuale u dërguan për gjykim. Numri i këtyre procedimeve pësoi rënie me 9 vepra nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas pësoi rritje të lehtë, me 5 procedime në vitin 2017.

Këto procedime penale janë ndarë në dy nën-kategori (marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale). Ndryshimi në numrin e procedimeve penale për gjykim për krimet seksuale lidhet kryesisht me ndryshimet në numrin e procedimeve penale për gjykim për nënkategorinë marrëdhënie seksuale me dhunë.

FIGURA 10

Numri i procedimeve penale për gjykim për krimet seksuale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Në një vit, numri i procedimeve penale për gjykim për marrëdhënie seksuale me dhunë pësoi rënie me 43,8 %, nga 32 procedime në vitin 2015 në 18 në vitin 2016. Në vitin 2017, numri i procedimeve penale ishte 25, 7 më shumë se në vitin 2016.

Në të njëjtën periudhë, numri i procedimeve penale lidhur me krimet e tjera seksuale është rritur nga 36 procedime në vitin 2015, në 39 procedime në vitin 2017. Grafiku më poshtë tregon trendin e përgjithshëm të numrit të procedimeve penale për dy nënkategoritë e krimeve seksuale.

Dhuna në familje

Dhuna në familje përfshin rrahjen, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.

Numri i procedimeve penale për gjykim për veprën penale të dhunës në familje ka pësuar rritje me 13,1 %, nga 1.023 procedime në vitin 2015 në 1.157 procedime në vitin 2016. Më pas, nga viti 2016 në vitin 2017 ka pësuar një rënie prej 8,6 %, nga 1.157 procedime në 1.057.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në kategorinë "Vepra të tjera penale kundër personit" përfshihen: vepra penale kundër shëndetit të shkaktuara nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër fëmijës, martesës dhe familjes, dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në këto kategori, si: vrasje e mbetur në tentativë, vrasje nga pakujdesia.

Në 2017, 293 procedime për vepra të tjera penale kundër personit u dërguan për gjykim. Numri i procedimeve ka rënë me 33,6 %, nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i procedimeve penale për gjykim për vepra të tjera penale kundër personit ka pësuar rënie me 9,5 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas ka rënë përsëri me 26,6 % në vitin 2017.

2.3.3 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM PËR VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Në 2017, Prokuroria dërgoi për gjykim 4.249 procedime për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka rënë me 35,5 % nga viti 2015 në vitin 2017.

Numri i procedimeve penale ka rënë me 25,1 % nga viti 2015 në vitin 2016. Në vitin pasardhës ka pësuar rënie me 13,9 %.

Gjatë kësaj periudhe, përqindja e procedimeve penale dërguar për gjykim nga totali i procedimeve të regjistruara

për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka pësuar rënie. Në vitin 2015, u dërguan për gjykim 35,7 % e procedimeve penale të regjistruara. Kjo përqindje pësoi rënie në 2016 me 29,7 % dhe në vitin pasardhës përsëri u ul, (24,2 %).

Figura 11 shpreh përqindjen e procedimeve penale për gjykim të nënkategorive të veprave penale në totalin e procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për vitin 2017. Figura tregon se nënkategoria e vjedhjes së pasurisë zë pjesën më të madhe, ndjekur nga veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës. Ndërkohë grabitjet dhe falsifikimet e monedhës paraqesin nënkategoritë me përqindjen më të ulët në totalin e procedimeve për gjykim për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.


TABELA 7

Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	3.519	2427	-31,0	1.611	-33,6
Grabitje	107	83	-22,4	63	-24,1
Mashtime	511	749	46,6	622	-17,0
Shkatërrimi i pasurisë	176	148	-15,9	90	-39,2
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	37	40	8,1	23	-42,5
Falsifikimi i dokumenteve	373	355	-4,8	514	44,8
Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	1.024	669	-34,7	988	47,7
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	843	462	-45,2	338	-26,8
Gjithsej	6.590	4.933	-25,1	4.249	-13,9

FIGURA 11

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale për gjykim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për 2017



Vjedhje e pasurisë

Në vitin 2017, 1.611 procedime penale u dërguan për gjykim për vjedhje të pasurisë, 37,9 % në totalin e procedimeve për gjykim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri i procedimeve penale për gjykim për vjedhje të pasurisë ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër ka rënë me 31,0 % nga viti 2015 në 2016 dhe me 33,6 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Grabitjet

Në vitin 2017, 63 procedime penale për grabitje të pasurisë u dërguan për gjykim. Numri i procedimeve penale për gjykim ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër është ulur me 22,4 % nga 2015 në 2016 dhe me 24,1 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Mashtrimet

Në vitin 2017, 622 procedime penale për mashtrim u dërguan për gjykim. Numri i procedimeve për veprën penale të mashtrimit është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër ka pësuar rritje me 46,4 % nga viti 2015 në 2016 dhe është ulur me 17,0 % nga viti 2016 deri në vitin 2017.

Shkatërrimi i pasurisë

Në 2017, 90 procedime penale për shkatërrimin e pasurisë u dërguan për gjykim. Numri i procedimeve penale për shkatërrimi të pasurisë ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër ka rënë me 15,9 % nga viti 2015 në 2016 dhe nga 39,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Falsifikimi i monedhave

Në vitin 2017, ishin 23 procedime penale për gjykim për falsifikim të monedhave. Numri i procedimeve për falsifikimit të monedhës pësoi rënie nga viti 2015 në 2017. Ky numër u rrit me 8,1 % nga viti 2015 në 2016 dhe më pas pësoi rënie me 42,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Falsifikimi i dokumenteve

Në vitin 2017, janë regjistruar 514 procedime penale për gjykim për falsifikim të dokumenteve. Numri i këtyre procedimeve penale pësoi rritje nga 2015 në 2017. Ky numër pësoi rënie me 4,8 % nga 2015 në 2016 dhe më pas u rrit me 44,8 % nga viti 2016 në 2017.


Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës

Në vitin 2017, 988 procedime penale janë dërguar për gjykim për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës. Numri i procedimeve për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës ka pësuar rënie nga viti 2015 në 2017. Ky numër është ulur me 34,7 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas numri i procedimeve penale është rritur me 47,7 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Gjatë periudhës 2015-2017, procedimet për ndërtimet e paligjshme (neni 199 / a) përbëjnë pjesën më të madhe nga totali i procedimeve për gjykim për veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës, ndjekur nga pushtimi i paligjshëm i tokës (neni 200), siç tregohet në figurën më poshtë.

FIGURA 12

Përqindja që zë çdo nënkategori e veprave penale në totalin e procedimeve penale për gjykim për veprat që çënojnë regjimin juridik të tokës, për periudhën 2015-2017



Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Në këtë kategori janë përfshirë seksionet e tjera të lidhura me kapitullin 3 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë "Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike", si veprat penale të kryera në shoqëri tregtare, veprat penale në fushën e doganave, veprat penale lidhur me tatimet, vepra penale në fushën e falimentimit, zhvillimit të paligjshëm të lojërave të fatit.

Në 2017, 338 procedime penale u dërguan për gjykim për nënkategorinë e veprave të tjera penale kundër pasurisë ose në sferën ekonomike. Numri i procedimeve u ul nga viti 2015 në vitin 2017. Ky numër u ul me 45,2 % nga viti 2015 në 2016 dhe më pas numri i procedimeve penale pësoi rënie të mëtejshme me 26,8 % nga viti 2016 në vitin 2017. Rezultati për nënkategoritë e përfshira procedime penale për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike mund të gjendet në tabelën shtojcë 2.2.

2.3.4 PROCEDIME PENALE PËR GJYKIM PËR KATEGORINË “VEPRA TË TJERA PENALE”

Procedimet penale për gjykim për kategorinë vepra të tjera penale paraqesin të dhëna për ato procedime që nuk janë përfshirë në procedimet penale për vepra penale kundër personit (Seksioni 2.3.2) dhe procedimet penale për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (Seksioni 2.3.3). Në kategorinë e procedimeve të tjera penale janë analizuar procedimet lidhur me veprat penale në fushën e drogës, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave.

Në vitin 2017, u dërguan për gjykim 5.476 procedime penale lidhur me kategorinë “vepra të tjera penale”, 52,7 % e procedimeve të regjistruara për këto vepra penale. Përqindja e procedimeve të dërguara për gjykim nga numri i procedimeve të regjistruara është përafërsisht e njëjtë, përkatësisht 56,3 % në vitin 2015, 53,1 % në vitin 2016.

Numri gjithsej i procedimeve tregon një rënie prej 8,6 % nga 2015 në 2017. Numri i procedimeve penale ka mbetur i njëjtë nga viti 2015 në 2016, duke rënë vetëm me 1 procedim penal dhe në vitin pasardhës ka rënë me 9,0 %.

TABELA 8

Numri gjithsej i procedimeve penale për gjykim në kategorinë Vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	503	734	45,9	809	10,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	3.087	2.906	-5,9	2.734	-5,9
Korrupsioni në sektorin privat	296	431	45,6	344	-20,2
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	17	15	-11,8	36	140,0
Të tjera	2.091	1.934	-7,5	1.553	-19,7
Gjithsej	5.994	6.020	0,4	5.476	-9,0

Vepra penale në fushën e drogës

Në 2017, u dërguan për gjykim 809 procedime për veprat penale në fushën e drogës. Numri i procedimeve penale në fushën e drogës është rritur gjatë kësaj periudhe. Ky numër u rrit me 45,9 % nga 2015 në 2016 dhe ka pësuar përsëri rritje me 10,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor

Në vitin 2017, 2.734 procedime për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor u dërguan për gjykim. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i procedimeve lidhur me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor të dërguara për gjykim ka pësuar rënie. Kjo nënkategori e procedimeve pësoi rënie me 5,9 % nga 2015 në 2016, dhe në vitin pasardhës u ul me 5,9 %.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Në 2017, u dërguan për gjykim 344 procedime penale lidhur me kalimin e paligjshëm të kufirit. Numri i procedimeve penale në gjykim për kalimin e paligjshëm të kufirit ka rënë gjatë periudhës 2015 - 2017. Kjo nënkategori e procedime ka pësuar rritje me 45,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rënie me 20,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Pastrimi i parave

Në vitin 2017, janë dërguar për gjykim 36 procedime penale për veprën penale të pastrimit të parave. Numri i procedimeve penale për gjykim për pastrimin e parave ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër ka rënë me 11,8 % nga viti 2015 në 2016 dhe nga viti 2016 në vitin 2017 numri i procedimeve penale për gjykim është dyfishuar.

2.4 TË PANDEHURIT E VEPRAVE PENALE

I pandehur quhet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si të pandehur.

Në numrin e të pandehurve për një vit janë përfshirë të pandehurit që janë gjykuar gjatë vitit referues. Ky seksion përmban të dhëna për të pandehurit sipas gjinisë, veprave penale dhe grupmoshës.

TABELA 9

Numri gjithsej i personave të pandehur sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %


Kategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	2.991	2.968	-0,8	2.568	-13,5
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën	8.265	6.061	-26,7	5.641	-6,9
Krime në fushën e drogës	1.199	1.693	41,2	1.819	7,4
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	3.350	3.082	-8,0	2.991	-3,0
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	439	640	45,8	6.01	-6,1
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	100	76	-24,0	95	25,0
Të tjera	3.377	2926	-13,4	2.641	-9,7
Gjithsej	19.721	17.446	-11,5	16.356	-6,2

Figura 13 tregon numrin gjithsej të personave të pandehur gjatë periudhës 2015-2017, të paraqitur në kolonë dhe numrin e të pandehurve për 10 mijë banorë, të paraqitur në vijë.

Nëse do paraqitej numri i të pandehurve në raport me popullsinë, në 2017 kishte 56.9 të pandehur për 10 mijë banorë. Viti 2015 ka numrin më të madh të të pandehurve në raport me numrin gjithsej të popullsisë.

FIGURA 13

Numri gjithsej i të pandehurve në vlerë absolute dhe shprehur në raport me popullsinë



Shpërndarja gjinore e të pandehurve nuk ka ndryshuar shumë gjatë periudhës 2015-2017. Përqindja e meshkujve të pandehur varion nga 93,5 % në 94,4 % të numrit total të të pandehurve për veprat penale. Përqindja e femrave të pandehura për veprat penale varion nga 5,6 % në 6,5 %.

FIGURA 14

Përqindja e personave të pandehur të veprave penale sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




Tabela 10 tregon numrin e të pandehurve gjithsej për veprat penale në raport me numrin e popullsisë sipas gjinisë. Në 2017, numri i të meshkujve të pandehur për 10.000 meshkuj ishte 105,7 të pandehur. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i meshkujve të pandehur varionte nga 105,7 në 127,6 të pandehur.

Në vitin 2017, numri i femrave të pandehura për 10 000 banorë ishte 7,5 të pandehur. Gjatë periudhës 2015 – 2017, numri i femrave të pandehura në raport me numrin gjithsej të popullsisë femra varionte nga 7,5 në 7,8 të pandehur.

TABELA 10

Numri gjithsej i personave të pandehur në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017

Viti	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	19.721	68,5	1.096	7,7	18.625	127,6
2016	17.446	60,7	1.103	7,8	16.343	112,2
2017	16.356	56,9	1.066	7,5	15.290	105,7

Veprat penale me numrin më të madh të të pandehurve janë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, ndjekur nga veprat penale lidhur me shkeljet e qarkullimit rrugor dhe vepra penale kundër personit.

Në të gjitha kategoritë e veprave penale, meshkujt zënë përqindjen më të madhe. Përqindja e meshkujve varion nga 2,1 % në 11,6 % për të gjitha kategoritë. Tabela 2.3 në shtojcë paraqet numrin gjithsej të të pandehurve sipas nënkategorive dhe gjinisë.

FIGURA 15

Përqindja e personave të pandehur sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017





FIGURA 16

Përqindja e personave të pandehur sipas gjinisë dhe kategorive të veprave penale për 2017



2.4.2 TË PANDEHUR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në vitin 2017, u regjistruan 2.568 të pandehur për vepra penale kundër personit. Numri gjithsej i të pandehurve për vepra penale kundër personit ka rënë me 14,1 % nga 2015 në 2017. Numri i të pandehurve ka rënë me 0,8 % nga viti 2015 në 2016 dhe ka pësuar rënie me 13,5 % nga viti 2016 në vitin 2017.

TABELA 11


Numri gjithsej i personave të pandehur për vepra penale kundër personit sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	166	192	15,7	98	-49,0
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	828	705	-14,9	698	-1,0
Krime seksuale	94	90	-4,3	79	-12,2
Marrëdhënie seksuale me dhunë	53	36	-32,1	34	-5,6
Krime të tjera seksuale	41	54	31,7	45	-16,7
Dhuna në familje	1.222	1.281	4,8	1.194	-6,8
Vepra të tjera penale kundër personit	681	700	2,8	499	-28,7
Gjithsej	2.991	2.968	-0,8	2.568	-13,5

Grafiku 17 tregon numrin e të pandehurve, të paraqitur në kolonë dhe numrin e të pandehurve në raport me numrin e popullsisë, të paraqitur në vijë. Në vitin 2017 kishte 8.9 të pandehur për 10 mijë banorë. Sa i përket numrit total të të pandehurve, numri më i lartë u regjistrua në vitin 2015, me 10.4 të pandehur.

FIGURA 17

Numri i të pandehurve për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe shprehur në raport me popullsinë



Shpërndarja gjinore e të pandehurve është e dominuar nga meshkujt, siç shihet nga figura 18. Në vitin 2017, 92,8 % e të pandehurve për vepra penale kundër personit janë meshkuj dhe 7,2 % janë femra. Është afërsisht e njëjta shpërndarje gjinore për vitin 2016, përkatësisht 93,0 % me 7,0 %. Ndërkohë në vitin 2015, përqindja e të pandehurve meshkuj është më e lartë, 94,2 % dhe përqindja e femrave është 5,8 %.

FIGURA 18
Përqindja e personave të pandehur për vepra penale kundër personit sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




Tabela 12 paraqet numrin e të pandehurve për vepra penale kundër personit në raport me numrin e popullsisë. Ky numër është më i lartë për meshkujt në krahasim me femrat dhe shënon 16,5 meshkuj të pandehur për 10.000 banorë meshkuj. Gjatë periudhës 2015- 2107, numri i të pandehurve meshkuj në raport me numrin e popullsisë meshkuj varionte nga 16,5 në 19,3 të pandehur. Ndërkohë numri i femrave të pandehura në raport me numrin e popullsisë femra varion nga 1,2 në 1,5 të pandehur.


TABELA 12
Numri gjithsej i personave të pandehur për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017

Vite	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	2.991	10,4	174	1,2	2.790	19,3
2016	2.968	10,3	206	1,5	2.711	19
2017	2.568	8,9	184	1,3	2.351	16,5

Nga veprat penale kundër personit, vepra penale e dhunës në familje është nënkategoria me përqindjen më të madhe të të pandehurve. Siç tregohet në figurën më poshtë, përqindja e të pandehurve për dhunë në familje është rritur nga 40,9 % në 46,5 % gjatë periudhës 2015 – 2017.

FIGURA 19

Përqindja e personave të pandehur për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017




Në 2017, përqindja e femrave të pandehura në nënkategorinë vepra të tjera penale kundër personit është më e lartë krahasuar me numrin e të pandehurve në nënkategoritë e tjera të veprave penale, siç shihet në figurën më poshtë.

Tabela 2.4 lidhur me numrin e të pandehurve për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë është paraqitur në shtojcë.

FIGURA 19

Përqindja e të pandehurve për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë, 2017



Vrasje me dashje

Numri i të pandehurve për vrasje me dashje u rrit nga 166 në vitin 2015 në 192 në vitin 2016. Një vit më pas numri i të pandehurve për vrasje me dashje pësoi rënie në 98 të pandehur. Numri i të pandehurve për vrasje me dashje u rrit me 15,7 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 49,0 %.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në vitin 2017, u regjistruan 698 të pandehur për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Numri i të pandehurve ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u ul me 14,9 % nga 2015 në 2016 dhe një vit më pas pësoi përsëri rënie me 1,0 %.


Krime seksuale

Numri i të pandehurve për krime seksuale ka rënë nga 94 të pandehur në 79 gjatë periudhës 2015-2017. Kjo rënie ndikohet kryesisht nga rënia e numrit të të pandehurve për marrëdhënie seksuale me dhunë nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i të pandehurve për marrëdhënie seksuale me dhunë ka rënë nga 53 të pandehur në vitin 2015 në 36 të pandehur në vitin 2016. Një vit më pas ky numër pësoi rënie, në 34 të pandehur. Numri i të pandehurve për krime të tjera seksuale në vitin 2017 ishte 45 të pandehur, 9 të pandehur më pak se në vitin 2016 dhe 4 të pandehur më shumë krahasuar me vitin 2015.

Figura më poshtë tregon trendin e numrit të së pandehurve për nënkategoritë e krimeve seksuale.

FIGURA 21

Numri i të pandehurve për krime seksuale, gjatë periudhës 2015-2017



Dhuna në familje

Numri i të pandehurve për dhunë në familje është rritur nga 1.222 të pandehur në vitin 2015 në 1.281 të pandehur në vitin 2016. Në vitin pasardhës numri i të pandehurve për dhunë në familje u ul, në 1.194 të pandehur. Numri i të pandehurve për dhunë në familje pësoi rritje me 4,8 % nga 2015 në 2016 dhe pësoi rënie me 6,8 % nga 2016 në 2017.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në kategorinë "Vepra të tjera penale kundër personit" përfshihen: vepra penale kundër shëndetit të shkaktuara nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër fëmijës, martesës dhe familjes, dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në këto kategori, si vrasje në tentativë, vrasje nga pakujdesia.

Numri i të pandehurve për këto vepra ka pësuar rritje, nga 681 të pandehur në vitin 2015 në 700 të pandehur në vitin 2016. Në vitin 2017, kjo kategori ka pësuar rënie, në 499 të pandehur. Numri i të pandehurve u rrit me 2,8 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin më pas pësoi rënie me 28,7 %.

2.4.3 TË PANDEHUR PËR VEpra PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Ky seksion u referohet personave të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të paraqitura sipas nënkategorive të veprave penale, gjinisë dhe dy ndarjeve kryesore moshore.

Në vitin 2017, numri i të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ishte 5.641.

Numri gjithsej i të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka rënë nga viti 2015 në 2017. Numri i të pandehurve ka rënë me 26,7 % nga viti 2015 në vitin 2016 dhe më pas është rritur me 6,9 % nga viti 2016 deri në vitin 2017.

TABELA 13


Numri gjithsej i personave të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	4.274	2.974	-30,4	2.051	-31,0
Grabitje	205	144	-29,8	125	-13,2
Mashtrime	581	696	19,8	827	18,8
Shkatërrimi i pasurisë	257	229	-10,9	155	-32,3
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	40	54	35,0	41	-24,1
Falsifikimi i dokumenteve	579	512	-11,6	781	52,5
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	1.251	832	-33,5	1.125	35,2
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	1.078	620	-42,5	536	-13,5
Gjithsej	8.265	6.061	-26,7	5.641	-6,9

Figura 22 tregon numrin e të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e të pandehurve për 10 mijë banorë. Në vitin 2017 ishin 19,6 persona të pandehur për 10 mijë banorë. Në lidhje me numrin absolut të të pandehurve, viti 2015 ka numrin më të madh të të pandehurve në raport me popullsinë. Gjatë periudhës 2015-2017, norma e të pandehurve ka rënë nga 28,7 në 19,6 të pandehur për 10 mijë banorë.

FIGURA 22

Numri i të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe shprehur në raport me popullsinë



Shpërndarja gjinore e të pandehurve dominohet nga meshkujt, siç shihet nga figura më poshtë. Në 2017, 89,9 % e të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë meshkuj dhe 10,1 % janë femra. Përqindja e femrave të pandehurave ka pësuar rritje. Nga viti 2015 në vitin 2017, përqindja e femrave të pandehura për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, varion nga 7,4 % në 10,1 %.

FIGURA 23

Përqindja e personave të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




Tabela 14 tregon numrin e të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në lidhje me numrin e popullsisë. Nga viti 2015 në vitin 2017, numri i të pandehurve meshkuj në raport me numrin gjithsej të popullsisë meshkuj varionte nga 35,1 në 52,4 të pandehur. Numri i të pandehurave femra në raport me popullsinë gjithsej femra varionte nga 4 në 4,3 të pandehur.

TABELA 14


Numri gjithsej i personave të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017

	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	8.265	28,7	615	4,3	7.650	52,4
2016	6.061	21,1	585	4,1	5.476	37,6
2017	5.641	19,6	572	4	5.069	35,1

Në veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike të pandehurit për vjedhje të pasurisë përbëjnë përqindjen më të madhe. Gjatë periudhës 2015-2017, përqindja e të pandehurve për vjedhje të pasurisë ka pësuar rënie nga 51,7 % në 36,4 %.

FIGURA 24


Përqindja e personave të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Në të gjitha nënkategoritë e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike meshkujt janë ata që zënë përqindjen më të madhe. Përqindja e femrave varion nga 4,7 % në 14,3 % për të gjitha nënkategoritë, përveç veprës penale të mashtrimit, ku përqindja e femrave është 27,2 %. Të dhënat për numrin e të pandehurve sipas nënkategorive dhe gjinisë janë paraqitur në tabelën 2.5 në shtojcë.

FIGURA 25

Përqindja e të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas kategorive të veprave penale dhe gjinisë, 2017



Vjedhja e pasurisë

Në 2017, u regjistruan 2.051 të pandehur për vjedhje të pasurisë. Numri i të pandehurve për këtë nënkategori ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u ul me 30,4 % nga 2015 në 2016 dhe me 31,0% nga 2016 në 2017.

Grabitje

Gjatë kësaj periudhe, numri i të pandehurve për nënkategorinë grabitje të pasurisë ka rënë nga 205 të pandehur në vitin 2015 në 144 të pandehur në vitin 2016. Në vitin më pas numri i të pandehurve për grabitje ra në 125 të pandehur. Numri i të pandehurve për grabitje pësoi rënie me 29,8 % nga 2015 në 2016. Në vitin pasardhës ra përsëri me 13,2 %.

Mashtrim

Numri i të pandehurve për mashtrim ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017, nga 581 të pandehur në vitin 2015 në

827 të pandehur në vitin 2017. Ky numër u rrit me 19,8 % nga 2015 në 2016 dhe me 18,8 % një vit më pas.

Shkatërrim i pasurisë

Gjatë kësaj periudhe, numri i të pandehurve për shkatërrimin e pasurisë ka rënë, nga 257 të pandehur në vitin 2015 në 229 të pandehur në vitin 2016. Numri i të pandehurve ka rënë me 10,9 % nga 2015 në 2016 dhe ra përsëri me 32,3% nga 2016 në 2017.

Falsifikim i monedhave

Në 2017, u regjistruan 41 të pandehur për falsifikim të monedhave. Numri i të pandehurve për falsifikim të monedhave pësoi rritje gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u rrit me 35,0 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 24,1 %.

Falsifikim i dokumenteve

Në vitin 2017, u regjistruan 781 të pandehur për falsifikim të dokumenteve. Ky numër ka pësuar rritje nga 2015 në 2017. Numri i të pandehurve u ul me 11,6 % nga 2015 në 2016 dhe më pas u rrit me 52,5 % nga 2016 në 2017.

Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës

Në vitin 2017, u regjistruan 1.125 të pandehur për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës. Gjatë kësaj periudhe, numri i të pandehurve për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës ka pësuar rënie me 33,5 % nga 2015 në vitin 2016. Në vitin më pas, numri i të pandehurve u rrit me 35,2 %.

Gjatë periudhës 2015 – 2017, të pandehurit për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm (neni 199/a) përbëjnë edhe përqindjen më të lartë të totalit të të pandehurve për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës, ndjekur nga të pandehur për pushtim të paligjshëm të tokës (neni 200), siç tregohet në figurën më poshtë.


Të pandehur për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Të pandehurit për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përfshijnë personat e pandehur që nuk janë përfshirë në kategoritë e përmendura më lart. Tabela 2.6 në shtojcë, paraqet numrin e personave të pandehur për këtë kategori sipas veprave penale dhe gjinisë.

Në 2017, u regjistruan 536 të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Numri i të pandehurve ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër ka rënë me 42,5 % nga 2015 në 2016 dhe përsëri ka rënë me 13,5 % nga 2016 në 2017.

FIGURA 26

Përqindja e personave të pandehur për veprat që çënojnë regjimin juridik të tokës sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



2.4.4 TË PANDEHUR PËR KATEGORINË “VEPRA TË TJERA PENALE”

Personat e pandehur për kategorinë vepra të tjera penale u referohen të pandehurve që nuk përfshihen në seksionin vepra penale kundër personit dhe vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Të dhënat paraqiten sipas gjinisë dhe dy ndarjeve kryesore moshore.

Në vitin 2017, u regjistruan 8.147 të pandehur për kategorinë e veprave të tjera penale. Numri gjithsej i të pandehurve në kategorinë e veprave të tjera penale tregon një rënie prej 3,8 % nga 2015 në 2017. Numri i të pandehurve ka rënë me 0,6 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës përsëri u ul me 3,2 %.

TABELA 15

Numri i personave të pandehur për kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %


Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	1.199	1.693	41,2	1.819	7,4
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	3.350	3.082	-8,0	2.991	-3,0
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	439	640	45,8	601	-6,1
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	100	76	-24,0	95	25,0
Të tjera	3.377	2.926	-13,4	2.641	-9,7
Gjithsej	8.465	8.417	-0,6	8.147	-3,2

Figura 27 tregon numrin e të pandehurve për kategorinë vepra të tjera penale gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e të pandehurve në raport me 10 mijë banorë.

Norma e të pandehurve në 2015 dhe 2016 ka qënë përafërsisht e njëjtë, në vitin pasardhës kjo normë u ul në 28,4 të pandehur.

FIGURA 27


Numri i personave të pandehur për kategorinë vepra të tjera penale në vlerë absolute (aksi majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (aksi djathtë dhe vijat), për periudhën 2015-2017



Shpërndarja gjinore e të pandehurve është e dominuar nga meshkujt, siç shihet në Figurën 28. Në 2017, 96,2 % e të pandehurve për vepra të tjera penale janë meshkuj dhe 3,8 % janë femra. Shpërndarja gjinore e meshkujve dhe femrave nuk ka pësuar shumë ndryshime gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 28

Përqindja e personave të pandehur për kategorinë vepra të tjera penale sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017




Vepra penale në fushën e drogës

Në vitin 2017, u regjistruan 1.819 të pandehur për vepra penale në fushën e drogës. Numri i të pandehurve në këtë kategori ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 41,2 % nga 2015 në 2016 dhe përsëri është rritur me 7,4 % nga 2016 në 2017.

FIGURA 29

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur për vepra penale, për periudhën 2015-2017



Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Gjatë kësaj periudhe, numri i të pandehurve për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor ka rënë, nga 3.350 të pandehur në vitin 2015 në 2.991 të pandehur në vitin 2017. Numri i të pandehurve në këtë kategori ka rënë me 8,0 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ka rënë me 3,0%.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Numri i të pandehurve për veprat penale që kanë të bëjnë me kalimin e paligjshëm të kufirit ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015-2017, nga 439 të pandehur në vitin 2015 në 601 të pandehur në vitin 2017. Nga 2015 në 2016, numri i të pandehurve ka pësuar rritje me 45,8 % dhe nga 2016 në 2017 ka rënë me 6,1 %.

Pastrimi i parave

Numri i të pandehurve për nënkategorinë pastrim të parave ka rënë gjatë periudhës 2015-2017, nga 100 të pandehur në vitin 2015 deri në 95 të pandehur në vitin 2017. Nga 2015 në 2016, ky numër ka rënë me 24,0 % dhe një vit më pas ka pësuar rritje me 25,0 %.


2.4.5 TË MITURIT

Ky seksion paraqet statistika për të pandehurit e mitur, që janë personat e pandehur të moshës nga 14 deri në 17 vjeç.

Në 2017, numri gjithsej i të pandehurve ishte 16.356 persona, 570 prej tyre ishin të moshës 14-17 vjeç. Numri i të pandehurve të mitur ka rënë me 42,7 % gjatë periudhës 2015-2017, ndërkohë që numri i të pandehurve të rritur është ulur me 15,7 % nga 2015 në 2017.

FIGURA 30

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur sipas kategorive të vepra penale, për 2017



Numri i të pandehurve të mitur është më i lartë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe për veprat penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor krahasuar me kategoritë e tjera. Në figurën 31 vihet re se në vitin 2017, nga totali i 570 të

Nga numri gjithsej i të pandehurve në vitin 2017, u regjistruan 3,5 % të pandehur të mitur. Përqindja e të pandehurve të mitur ka rënë gjatë kësaj periudhe; kjo përqindje varion nga 3,5 % në 5,0 %.

Figura 30 paraqet përqindjen e të pandehurve sipas kategorive të veprës penale dhe dy grupmoshave kryesore. Siç shihet nga figura, përqindja që të pandehurit të mitur zënë në numrin gjithsej të të pandehurve është më pak se 5,0 %.

pandehurve të mitur, 48,9 % e tyre janë të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 24,4 % për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe 11,6 % për vepra penale kundër personit.

FIGURA 31

Përqindja e personave të mitur të pandehur sipas kategorive të veprave penale, për 2017



2.4.4.1 TË PANDEHUR TË MITUR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në 2017, u regjistruan 2.568 të pandehur për vepra penale kundër personit, 66 prej tyre ishin të mitur. Numri i të pandehurve të mitur ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të pandehurve të mitur ka rënë me 14,0 % nga 2015 në 2016 dhe me 23,3 % nga 2016 në 2017.

Nga të pandehurit për vepra penale kundër personit në 2017, 2,6 % ishin të mitur, 14-17 vjeç. Përqindja e të pandehurve të mitur varion nga 2,6 % në 3,3 %.

FIGURA 32

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur për vepra penale kundër personit, për periudhën 2015-2017





Figura më poshtë tregon përqindjen e të pandehurve sipas nënkategorive të veprave penale kundër personit. Siç duket në figurë, për veprat penale kundër personit, të pandehurit e mitur zënë një përqindje të vogël, më pak se 7,0 % në gjithë nënkategoritë.

FIGURA 33


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur për krime kundër personit sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Numri i të pandehurve të mitur është më i lartë për veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit, dhunës në familje dhe vepra të tjera penale kundër personit krahasuar me nënkategori të tjera të veprave penale kundër personit. Në 2017, nga totali i 66 të pandehurve, 50,0% e tyre janë të pandehur për vepra penale kundër shëndetit.

FIGURA 34

Përqindja e personave të mitur të pandehur për krime kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



Në tabelën shtojcë 2.8 paraqitet numri i të pandehurve të rritur dhe të mitur për vepra penale kundër personit për nënkategoritë e paraqitura më lart.

2.4.4.2 TË PANDEHUR TË RRIUR DHE TË MITUR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Nga totali i të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në 2017, 4,9 % e tyre ishin të mitur, 14-17 vjeç.

Gjatë kësaj periudhe, përqindja e të pandehurve të mitur është ulur, kjo përqindja varion nga 4,9 % në 6,1 %.

FIGURA 35

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, për periudhën 2015-2017





Figura më poshtë paraqet përqindjen e të pandehurve të mitur dhe të rritur sipas nënkategorive të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Siç shihet nga figura, të pandehurit e mitur zënë një përqindje të vogël në nënkategoritë e të pandehurve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, më pak se 15,0 % në të gjitha nënkategoritë dhe më pak se 1,0 % në disa prej tyre.

FIGURA 36


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



Siç shihet në figurën 37, për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike numri i të pandehurve të mitur është më i lartë për veprën penale të vjedhjes së pasurisë. Në vitin 2017, nga 279 të pandehur të mitur gjithsej, 88,2 % prej tyre janë të pandehur për vjedhje të pasurisë. Në vitin 2015 dhe 2016, kjo përqindje ishte 89,7 %.

FIGURA 37

Përqindja e personave të mitur të pandehur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



Në Shtojcë, tabela 2.9, paraqitet numri i të pandehurve të rritur e të mitur për veprën penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për nënkategoritë e paraqitura më sipër.


2.4.4.3 TË PANDEHUR TË RRITUR DHE TË MITUR PËR KATEGORINË VEPRATË TJERA PENALE

Nga totali i të pandehurve për kategorinë vepra të tjera penale në vitin 2017, 2,8 % e të pandehurve ishin të mitur, 14-17 vjeç. Gjatë kësaj periudhe, përqindja e të pandehurve të mitur ka rënë. Numri i të pandehurve të mitur ka rënë me 20,2 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul përsëri me 32,8 %.

Përqindja e të pandehurit të mitur varion nga 2,8 % në 5,0%.

FIGURA 38


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur në kategorinë vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017



Grafiku më poshtë paraqet përqindjen e të pandehurve të mitur dhe të rritur për kategorinë vepra të tjera penale. Siç shihet nga figura, të pandehurit e mitur zënë një përqindje të vogël në nënkategoritë e të pandehurve për kategorinë vepra të tjera penale, më pak se 4,6 % në të gjitha nënkategoritë dhe asnjë të pandehur të mitur në disa prej tyre.

FIGURA 39


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të pandehur në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017



Siç shihet në figurën 40, në kategorinë vepra të tjera penale, numri i të pandehurve të mitur është më i lartë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Në vitin 2017, nga 225 të pandehur të mitur gjithsej, 61.8 % prej tyre janë të pandehur për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Në vitin 2015 dhe 2016, kjo përqindje ishte 59,0 % dhe 53,7 %.

FIGURA 40

Përqindja e personave të mitur të pandehur në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



PERSONA TË DËNUAR SIPAS VEPRAVE PENALE

3.1 HYRJA

Ky kapitull paraqet të dhëna për personat e dënuar sipas veprës penale dhe karakteristikave të tyre. Burimi i të dhënave është Ministria e Drejtësisë dhe paraqet të dhëna për 3 vite, 2015 – 2017. Për këtë raportim, janë marrë në shqyrtim vetëm të dhënat e Gjykatave të Shkallës së Parë, kështu në numrin e personave të dënuar janë përfshirë vetëm personat e dënuar në Gjykatat e Shkallës së Parë.

Fokusi i prezantimit do të jetë kryesisht në kategoritë: vepra penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, vepra penale në fushën e drogës, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, kalim i paligjshëm i kufirit dhe pastrimi i parave.

3.2 TË DËNUAR

Person i dënuar konsiderohet personi i shpallur fajtor për një vepër penale kundër ligjit. Në numrin e personave të dënuar për një vit përfshihen personat e dënuar me gjobë dhe të dënuar me burgim gjatë vitit referues. Ky numër përfshin vetëm persona të dënuar në gjykatat e shkallës së parë.

3.2.1 NUMRI GJITHSEJ I PERSONAVE TË DËNUAR PËR VEPRAVE PENALE

Në vitin 2017, numri gjithsej i të dënuarve ishte 10.903 persona, 32,5 % më pak krahasuar me vitin 2015. Numri i personave të dënuar është ulur me 9,5 % nga 2015 në 2016 dhe përsëri ka pësuar rënie me 25,4 % nga 2016 në 2017.

TABELA 1


Numri gjithsej i personave të dënuar sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Kategoritë e veprave penale	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr,	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vepra penale kundër personit	2.350	2.348	-0,1	1.695	-27,8
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	7.179	5.416	-24,6	3.782	-30,2
Krime në fushën e drogës	633	848	34,0	977	15,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	1.961	2.869	46,3	2.398	-16,4
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	303	415	37,0	293	-29,4
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	61	38	-37,7	27	-28,9
Të tjera	3.654	2.680	-26,7	1.731	-35,4
Gjithsej	16.141	14.614	-9,5	10.903	-25,4

Figura 1 tregon numrin total të personave të dënuar gjatë periudhës 2015-2017, të paraqitur në kolonë dhe numrin e të dënuarve në raport me 10 mijë banorë, të paraqitur në vijë. Nëse do të shprehim numrin e të dënuarve në raport me popullsinë, në vitin 2017 numëroheshin 37,9 persona të dënuar për 10 mijë banorë. Norma më e lartë e të dënuarve është shënuar në vitin 2015, e cila përkon edhe me numrin absolut më të madh të të dënuarve.

FIGURA 1

Numri gjithsej i personave të dënuar në vlerë absolute dhe shprehur në raport me popullsinë, për periudhën 2015-2017



Shpërndarja gjinore e të dënuarve ka ndryshuar gjatë periudhës 2015-2017. Përqindja e meshkujve të dënuar ka rënë; ndërkohë që përqindja e femrave të dënuara është rritur. Përqindja e meshkujve është ulur nga 94,5 % në vitin 2015 në 90,6 % në vitin 2017. Përqindja e femrave është rritur nga 5,5 % në vitin 2015 në 9,4 % në 2017.

FIGURA 2

Përqindja e personave të dënuar të veprave penale sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




Tabela 2 paraqet numrin gjithsej të personave të dënuar për vepra penale në raport me numrin e popullsisë. Norma e të dënuarve është më e lartë për meshkujt në krahasim me femrat dhe shënon 68,3 meshkuj të dënuar për 10 000 banorë meshkuj. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i meshkujve të dënuar varionte nga 68,3 në 104,5 të dënuar.

Në vitin 2017, numri i femrave të dënuara për 10 000 femra shënon 7,2 të dënuara. Në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2017, numri i të femrave të dënuara varionte nga 6,2 në 7,2 të dënuara.

TABELA 2


Numri gjithsej i personave të dënuar në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë (përqindja), për periudhën 2015-2017

Vite	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	16.141	56,0	881	6,2	15.260	104,5
2016	14.614	50,8	976	6,9	13.638	93,7
2017	10.903	37,9	1.025	7,2	9.878	68,3

Veprat penale me numrin më të madh të personave të dënuar janë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, ndjekur nga shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe veprat penale kundër personit, siç tregohet në figurën më poshtë.

FIGURA 3


Përqindja e personave të dënuar sipas kategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017



Në të gjitha kategoritë e veprave penale meshkujt zënë përqindjen më të madhe në numrin e të dënuarve. Përqindja e femrave varion nga 1,5 % në 18,5 % për të gjitha kategoritë. Numri gjithsej i personave të dënuar sipas kategorive të veprave penale dhe gjinisë është paraqitur në Tabelën shtojcë 3.1.

FIGURA 4

Përqindja e secilës gjini ndaj numrit të personave të dënuar, sipas kategorisë së veprave penale në vitin 2017



3.2.1.1 MASAT E DËNIMIT PËR PERSONAT E DËNUAR

Masat e dënimit të vendosura për të dënuarit konsistojnë në dënim me burgim dhe me gjobë. Numri i personave të dënuar me gjobë ka rënë me 46,4 % nga viti 2015 deri në vitin 2017. Numri i personave të dënuar me burg (e gjithë kohëzgjatja e dënimit) është ulur me 28,6 %, nga 12.633 në 9.022, gjatë së njëjtës periudhë .

TABELA 3

Numri gjithsej i personave të dënuar sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017

Vite	Gjobë	Deri në 2 vjet	2 - 5 vite	5 - 10 vite	10-25 vite	25 - 35 vite	Burgim i përjetshëm	Të dënuar
2015	3.508	11.132	918	407	166	4	6	16.141
2016	3.032	10.096	994	341	134	7	10	14.614
2017	1.881	7.491	1.114	324	79	6	8	10.903

Përqindja e personave të dënuar sipas masave të dënimit është paraqitur në figurën mëposhtë. Në 2017, nga 10.903 të burgosur, 68,7 % prej tyre janë dënuar me burgim deri në 2 vjet, 17,3 % prej tyre janë dënuar me gjobë, 10,2 % janë dënuar me 2-5 vjet burgim, 3,0 % prej tyre janë dënuar me 5-10 vjet burgim dhe 0,9 % janë dënuar me më shumë se 10 vjet burgim.

FIGURA 5

Përqindja e secilës masë dënimi ndaj numrit gjithsej të personave të dënuar, për periudhën 2015-2017




TABELA 4

Numri gjithsej i personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vrasje me dashje	168	135	-19,6	95	-29,6
Vepra penale me dashje kundër shëndetit	559	452	-19,1	297	-34,3
Krime seksuale	65	72	10,8	57	-20,8
Marrëdhënie seksuale me dhunë	34	30	-11,8	27	-10,0
Krime të tjera seksuale	31	42	35,5	30	-28,6
Dhuna në familje	821	885	7,8	740	-16,4
Vepra të tjera penale kundër personit	737	804	9,1	506	-37,1
Gjithsej	2.350	2.348	-0,1	1.695	-27,8

3.2.2 PERSONAT E DËNUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në veprat penale kundër personit përfshihen dhjetë seksione nga Kapitulli II i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për qëllime statistikore, ne do të analizojmë veprat penale kryesore, si: vrasje me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krime seksuale të ndara në marrëdhënie seksuale me dhunë dhe krime të tjera seksuale dhe vepra penale e dhunës në familje.


Në vitin 2017, u regjistruan 1.695 persona të dënuar për vepra penale kundër personit. Numri total i të dënuarve për vepra penale kundër personit ka rënë me 27,9 % nga viti 2015 në vitin 2017. Numri i të dënuarve ka rënë me 0,1 % nga 2015 në 2016 dhe pësoi përsëri rënie me 27,8 % nga 2016 në 2017.

Tabela 4 paraqet një pasqyrë të numrit të personave të dënuar dhe ndryshimin ndërmjet viteve të ndryshme për nënkategoritë e veprave penale kundër personit. Siç tregohet në kolonën e djathtë, të gjitha nënkategoritë kanë pësuar rënie midis viteve 2016 dhe 2017; gjithashtu numri i personave të dënuar ka rënë në të gjitha nënkategoritë midis viteve 2015 dhe 2017.

Figura 6 paraqet numrin e të dënuarve për vepra penale kundër personit paraqitur me kolonë dhe numrin e personave të dënuar në raport me popullsinë, paraqitur në vijë. Në vitin 2017, numri i të dënuarve në raport me popullsinë ishte 5,9 persona për 10 mijë banorë. Në vitin 2015 dhe 2016 norma e të dënuarve ishte e njëjtë, 8,2 të dënuar për 10 mijë banorë.

FIGURA 6

Numri i personave të dënuar për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe shprehur në raport me popullsinë, për periudhën 2015-2017



Shpërndarja gjinore e personave të dënuar për vepra penale kundër personit mbizotërohet nga të dënuarit meshkuj, siç shihet në figurën e mëposhtme. Në 2017, 86,1 % e të dënuarve për vepra penale kundër personit janë meshkuj dhe 13,9 % janë femra. Përqindja e femrave të dënuara është rritur nga 2015 në 2017; përqindja e meshkujve të dënuar ka rënë.

FIGURA 7

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas gjinisë për periudhën 2015-2017




Tabela 5 paraqet numrin e të dënuarve për vepra penale kundër personit në raport me numrin e popullsisë. Kjo normë shënon 10,1 meshkuj të dënuar për 10.000 banorë dhe 1,7 femra të dënuara për 10.000 banorë femra. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i meshkujve të dënuar në raport me popullsinë meshkuj varion nga 10,1 në 14,8 të dënuar. Ndërkohë norma e femrave të dënuara varion nga 1,3 në 1,7 të dënuar.

TABELA 5


Numri i personave të dënuar për vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas gjinisë, për vitet 2015-2017

Vite	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	2.350	8,2	185	1,3	2.165	14,8
2016	2.348	8,2	216	1,5	2.132	14,6
2017	1.695	5,9	236	1,7	1.459	10,1

Dhuna në familje është vepra penale më numrin më të lartë të personave të dënuar në totalin e të dënuarve për vepra penale kundër personit. Gjatë periudhës 2015-2017, përqindja e personave të dënuar për dhunë në familje varion nga 34,9 % dhe 43,7 %.

FIGURA8

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017




Në të gjitha nënkategoritë e veprave penale kundër personit meshkujt zënë përqindjen më të lartë të të dënuarve. Përqindja e femrave varion nga 1,8 % në 22,5 % për të gjitha nënkategoritë e paraqitura në figurën 9.

Tabela 3.2 në shtojcë paraqet numrin e personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorisë së veprave penale dhe gjinisë.

FIGURA 9

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë, 2017



Vrasje me dashje

Numri i personave të dënuar për vrasje me dashje ishte 95 në 2017 dhe ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve u ul me 19,6 % nga 2015 në 2016 dhe në 2017 ra përsëri me 29,6 %.

Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Në vitin 2017, u regjistruan 297 të dënuar për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit. Gjatë periudhës 2015-2017 numri i të dënuarve ka rënë. Ky numri ka rënë me 19,1% nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 34,3 %.


Krime seksuale

Numri i të dënuarve për krime seksuale ishte 57 të dënuar në vitin 2017 dhe ka rënë gjatë periudhës 2015 - 2017. Ky numër fillimisht është rritur me 10,8 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rënie me 20,8 % nga 2016 në 2017.

Rënia është ndikuar kryesisht nga ulja e numrit të dënuarve për marrëdhënie seksuale me dhunë nga viti 2015 deri në vitin 2017. Numri i të dënuarve për marrëdhënie seksuale me dhunë ka rënë nga 34 të dënuar në vitin 2015 në 30 të dënuar në vitin 2016. Vitin në vijim u ul sërish në 27 të dënuar; gjatë periudhës 2015-2017 numri i të dënuarve për marrëdhënie seksuale me dhunë u ul me 20,6 %. Numri i personave të dënuar për krime të tjera seksuale u rrit ndërmjet 2015 dhe 2016, nga 31 në 42 dhe më pas u zvogëlua në 30 persona të dënuar në vitin 2017. Gjatë periudhës 2015-2017 numri i personave të dënuar u ul me 3,2 %. Grafiku më poshtë tregon trendin e numrit të dënuarve për dy nënkategoritë e krimeve seksuale.

FIGURA 10

Numri i personave të dënuar për krime seksuale, për periudhën 2015-2017



Dhuna në familje

Dhuna në familje përfshin rrahjen, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.

Në 2017, numërohen 740 persona të dënuar për dhunë në familje. Ky numër ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i personave të dënuar për dhunë në familje fillimisht u rrit me 7,8 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ra me 16,4 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Vepra të tjera penale kundër personit

Në kategorinë vepra të tjera penale kundër personit janë përfshirë: vepra penale kundër shëndetit të shkaktuara nga pakujdesia, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale

kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në këto nënkategori, si vrasje në tentativë, vrasje nga pakujdesia.

Numri i personave të dënuar për vepra të tjera penale kundër personit ishte 506 në 2017 dhe ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër u rrit në fillim me 9,1 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës u ul me 37,1 %.

3.2.2.1 MASAT E DËNIMIT PËR PERSONAT E DËNUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Masat e dënimit të personave të dënuar konsistojnë në dënim me burg dhe me gjobë. Numri i personave të dënuar për vepra penale kundër personit të dënuar me gjobë në vitin 2017 ishte 252. Numri i personave të dënuar me gjobë ka rënë me 48,3 % nga viti 2015 deri në vitin 2017. Numri i personave të dënuar për vepra penale kundër personit të dënuar me burg (e gjithë kohzgjatja e dënimit) ka rënë me 22,5 %, nga 2.350 në 1.695, gjatë të njëjtës periudhë.

TABELA 6

Numri i personave të dënuar sipas masave të dënimit për vepra penale kundër personit, për periudhën 2015-2017


Vite	Gjobë	Deri në 2 vjet	2 - 5 vite	5 - 10 vite	10-25 vite	25 - 35 vite	Burgim i përjetshëm	Të dënuar
2015	487	1.557	118	69	109	4	6	2.350
2016	422	1.636	122	74	84	6	4	2.348
2017	252	1.227	114	50	41	6	5	1.695

Përqindja e personave të dënuar sipas masave të dënimit në totalin e personave të dënuar është paraqitur në figurën mëposhtë. Gjatë periudhës 2015-2017, personat e dënuar deri në 2 vjet zënë përqindjen më të madhe, ndjekur nga persona të dënuar me gjobë. Në vitin 2017, nga 1.695

personave të dënuar, 72,4 % prej tyre u dënuan me burg deri në 2 vjet, 14,9 % u dënuan me gjobë, 6,7 % u dënuan me 2-5 vjet burg, 2,9 % prej tyre 5-10 vjet burg dhe 3,1 % u dënuan me më shumë se 10 vjet burg.

FIGURA 11

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër personit sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017



3.2.3 PERSONA TË DËNUAR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike i referohen neneve 134-200 të Kodit Penal, të Republikës së Shqipërisë. Në total janë 11 seksione që lidhen me këtë kapitull.

Në vitin 2017, numri i personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ishte 3.782 persona. Numri total i të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ka rënë nga viti 2015 në 2017. Numri i të dënuarve ka rënë me 24,6 % nga viti 2015 në 2016 dhe me 30,2 % nga viti 2016 në vitin 2017.

Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të numrit të personave të dënuar dhe ndryshimin midis viteve të ndryshme për nënkategoritë e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Siç tregohet në kolonën e djathtë, shumica e nënkategorive ka pësuar rënie në periudhën 2016 dhe 2017, gjithashtu numri i personave të dënuar ka rënë në shumicën e nënkategorive midis 2015 dhe 2017. Mashtrimi dhe falsifikimi i dokumenteve janë nënkategoritë ku numri i të dënuarve është rritur për të dyja periudhat, 2016-2017 dhe 2015-2017.

TABELA 7


Numri gjithsej i personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në % midis viteve

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Vjedhja e pasurisë	3.994	2.748	-31,2	1.520	-44,7
Grabitje	165	112	-32,1	99	-11,6
Mashtrime	499	530	6,2	779	47,0
Shkatërrimi i pasurisë	160	182	13,8	66	-63,7
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	32	49	53,1	38	-22,4
Falsifikimi i dokumenteve	414	466	12,6	492	5,6
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve	1.000	745	-25,5	458	-38,5
Vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	915	584	-36,2	330	-43,5
Gjithsej	7.179	5.416	-24,6	3.782	-30,2

Figura 12 tregon numrin e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e të dënuarve në raport me 10 mijë banorë. Në vitin 2017 u regjistruan 13.2 persona të dënuar për 10 mijë banorë. Viti 2015 regjistron numrin dhe normën më të lartë të të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

FIGURA 12

Numri i të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, për periudhën 2015-2017



Në vitin 2017, 85,5 % e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë meshkuj dhe 14,5 % janë femra. Përqindja e femrave të dënuara është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Kjo përqindje varion nga 6,8 % në 14,5 %; ndërkohë përqindja e meshkujve të dënuar varion nga 85,5 % në 93,2 %.

FIGURA 13

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017




Tabela 8 paraqet numrin e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në raport me numrin e popullsisë. Gjatë periudhës 2015-2017, numri i meshkujve të dënuar në raport me popullsinë meshkuj varionte nga 22,4 në 45,8 të dënuar. Numri i femrave të dënuara në raport me popullsinë femra varion nga 3,4 në 3,9 të dënuar.

TABELA 8


Numri gjithsej i personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë, për periudhën 2015-2017

Vite	Gjithsej		Femra		Meshkuj	
	Numër	Tregues	Numër	Tregues	Numër	Tregues
2015	7.179	24,9	488	3,4	6.691	45,8
2016	5.416	18,8	521	3,7	4.895	33,6
2017	3.782	13,2	550	3,9	3.232	22,4

Figura më poshtë paraqet përqindjen që nënkategori të ndryshme zënë në totalin e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Të dënuarit për vjedhje të pasurisë përbëjnë përqindjen më të lartë. Gjatë vitit 2015 dhe 2016, nënkategoria vjedhje e pasurisë përbën pak më shumë se ngjysmën e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, në 2017 kjo përqindje ulet në 40,2 % të totalit të dënuarve.

FIGURA 14

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017




Në të gjitha nënkategoritë e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, meshkujt zënë pjesën më të madhe të të dënuarve. Përqindja e femrave varion midis 4,4 % dhe 14,5 % për të gjitha nënkategoritë, me përjashtim të mashtrimit, ku femrat e dënuara zënë 36,3 % të totalit të dënuarve për këtë nënkategori.

Tabela 3.3 në shtojcë paraqet numrin e të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë.

FIGURA 15

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas kategorive të veprave penale dhe gjinisë, 2017



Vjedhje e pasurisë

Numri i personave të dënuar për vjedhje ishte 1.520 në vitin 2017 dhe ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve ka rënë me 31,2 % nga 2015 në 2016 dhe me 44,7 % nga 2016 në 2017.

Grabitje

Numri i personave të dënuar për grabitje ishte 99 në 2017. Numri i të dënuarve ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër ka rënë me 32,1 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ka rënë me 11,6 %.

Mashtrime

Numri i personave të dënuar për mashtrim ishte 779 në 2017 dhe ka pësuar rritje gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve është rritur me 6,2 % nga 2015 në 2016 dhe me 47,0 % nga 2016 në 2017.

Shkatërrim i pasurisë

Numri i personave të dënuar për shkatërrim të pasurisë ishte 66 në 2017. Numri i të dënuarve ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër në fillim është rritur me 13,8 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka pësuar rënie me 63,7 % nga 2016 në 2017.

Falsifikim i monedhave

Numri i personave të dënuar për falsifikim të monedhave ishte 38 në 2017. Numri i të dënuarve është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër në fillim është rritur me 53,1 % nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ka rënë me 22,4 %.

Falsifikim i dokumenteve


Numri i personave të dënuar për falsifikim të dokumenteve ishte 492 në 2017. Numri i të dënuarve është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 12,6 % nga 2015 në 2016 dhe me 5,6 % nga 2016 në 2017.

Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës

Numri i personave të dënuar për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës ishte 458 në 2017 dhe ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve ka rënë me 25,5 % nga 2015 në 2016 dhe me 38,5 % nga 2016 në 2017.

FIGURA 16

Përqindja e personave të dënuar për veprat që çënojnë regjimin juridik të tokës sipas nënkategorive, për periudhën 2015-2017



Persona të dënuar për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Personat e dënuar për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përfshijnë personat e dënuar që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e përmendura më lart. Seksionet e kodit penal pjesë e kësaj nënkategorie paraqiten në kapitullin e metodologjisë.

Numri i të dënuarve për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike ishte 330 në 2017 dhe ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve ra me 36,2 % nga 2015 në 2016 dhe me 43,5 % nga viti 2016 deri në vitin 2017. Tabela 3.4 në shtojcë tregon numrin e personave të dënuar për vepra të tjera penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të veprave penale dhe gjinisë.

TABELA 9

Numri i personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017


Vite	Gjobë	Deri në 2 vjet	2 - 5 vite	5 - 10 vite	10-25 vite	25 - 35 vite	Burgim i përjetshëm	Të dënuar
2015	1.631	5.187	257	73	31	0	0	7.179
2016	1.036	4.146	173	42	15	1	3	5.416
2017	656	2.828	221	60	15	0	2	3.782

Dënimi deri në 2 vjet ka numrin më të madh të të dënuarve për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, pasuar nga të dënuarit me gjobë. Në 2017, nga 3.782 të dënuar, 74,8 % prej tyre u dënuan me burgim deri në 2 vjet, 17,3 % prej tyre u dënuan me

gjobë, 5,8 % u dënuan me 2-5 vjet burgim, 2,0 % prej tyre u dënuan me më shumë se 5 vite burg. Përqindja e të dënuarve sipas masave të dënimit në totalin e personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike jepet në figurën më poshtë.

FIGURA 17

Përqindja e personave të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017



3.2.4. PERSONAT E DËNUAR PËR KATEGORINË VEPRATË TJERA PENALE

Personat e dënuar për kategorinë vepra të tjera penale i referohen personave të dënuar që nuk përfshihen në numrin e të dënuarve për vepra penale kundër personit dhe vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Në vitin 2017, u regjistruan 5.426 të dënuar për kategorinë e veprave të tjera penale. Numri total i të dënuarve për kategorinë vepra të tjera penale tregon një rënie prej 17,9 % nga 2015 në 2017. Numri i të dënuarve është rritur me 3,6 % nga viti 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhë ka rënë me 20,8 %.

TABELA 10


Numri i personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për periudhën 2015-2017 dhe ndryshimi në %

Nënkategoritë	2015	2016	2016-2015	2017	2017-2016
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Krime në fushën e drogës	633	848	34,0	977	15,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	1.961	2.869	46,3	2.398	-16,4
Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	303	415	37,0	293	-29,4
Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	61	38	-37,7	27	-28,9
Të tjera	3.654	2.680	-26,7	1.731	-35,4
Gjithsej	6.612	6.850	3,6	5.426	-20,8

Figura 18 paraqet numrin e personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale gjatë periudhës 2015-2017 dhe numrin e personave të dënuar në raport me 10 mijë banorë. Në vitin 2017 numërohen 18,9 persona të dënuar për 10 mijë banorë. Viti 2016 shënon numrin dhe normën më të lartë të të dënuarve.

FIGURA 18


Numri i personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale në vlerë absolute (boshti i majtë dhe kolonat) dhe në raport me popullsinë (boshti i djathtë dhe vijat), për periudhën 2015-2017



Ashtu si në kategoritë e tjera të veprave penale, shpërndarja gjinore e të dënuarve dominohet nga meshkujt, siç shihet në figurën 19. Në 2017, 95,6 % e të dënuarve për vepra të tjera penale janë meshkuj dhe 4,4 % janë femra. Shpërndarja gjinore e meshkujve dhe femrave nuk ka ndryshuar shumë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 19

Përqindja e personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017



Vepra penale në fushën e drogës

Numri i të dënuarve për vepra penale në fushën e drogës ishte 977 në 2017 dhe është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 34,0 % nga 2015 në 2016 dhe me 15,2 % nga 2016 në 2017.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor

Numri i personave të dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor ishte 2.398 në 2017 dhe është rritur gjatë periudhës 2015-2017. Ky numër është rritur me 46,3

% nga 2015 në 2016 dhe në vitin pasardhës ky numër ka rënë me 16,4 %.

Kalim i paligjshëm i kufirit

Numri i të dënuarve për kalimit të paligjshëm të kufirit ishte 293 të dënuar në vitin 2017. Në fillim ky numër ka pësuar rritje me 37,0 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka rënë me 29,4 % nga 2016 në 2017.

Pastrim i parave

Numri i personave të dënuar për nënkategorinë pastrim të parave ishte 27 në vitin 2017 dhe ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve ka rënë me 37,7 % nga 2015 në 2016 dhe më pas ka rënë me 28,9 % nga 2016 në 2017.

3.2.4.1 MASAT E DËNIMIT E PERSONAVE TË DËNUAR PËR KATEGORINË VEPRA TË TJERA PENALE

Masat e dënimit të personave të dënuar për kategorinë e veprave të tjera penale ndahen në dënim me burg dhe dënim me gjobë. Numri i personave të dënuar për kategorinë e veprave të tjera penale të dënuar me gjobë në vitin 2017 ishte 973, numri i personave të dënuar me gjobë ka pësuar rënie me 30,0 % nga viti 2015 deri në vitin 2017.

Numri i personave të dënuar me burg për kategorinë e veprave të tjera penale (të gjitha afatet e dënimit me burg) ka rënë me 14,7 %, nga 5.222 në 4.453, gjatë të njëjtës periudhë.

Ashtu si në kategoritë e tjera penale, dënimi me kohëzgjatje deri në 2 vjet përbën numrin më të madh të të dënuarve, ndjekur nga të dënuarit me gjobë.

TABELA 11


Numri i personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017

Vitet	Gjobë	Deri në 2 vjet	2 - 5 vite	5 - 10 vite	10-25 vite	25 - 35 vite	Burgim i përjetshëm	Të dënuar
2015	1.390	4.388	543	265	26	0	0	6.612
2016	1.574	4.314	699	225	35	0	3	6.850
2017	973	3.436	779	214	23	0	1	5.426

Në vitin 2017, nga 5.426 të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale, 63,3 % e tyre u dënuan me burgim deri në 2 vjet, 17,9 % u dënuan me gjobë, 14,4 % u dënuan me 2-5 vjet burgim, 3,9 % u dënuan me 5-10 vjet burgim dhe 0,4 % me më shumë se 10 vjet burgim. Kjo përqindje e të dënuarve në totalin e personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale është paraqitur në figurën më poshtë.

FIGURA 20

Përqindja e personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas masave të dënimit, për periudhën 2015-2017




3.2.5 TË MITURIT E DËNUAR

Ky seksion jep informacione për të miturit, të dënuar të moshës 14-17 vjeç. Në vitin 2017, numri i personave të dënuar ishte 10.903 ku 283 prej tyre ishin të mitur. Numri i të miturve të dënuar tregon një rënie prej 52,9 % gjatë periudhës 2015-2017, ndërkohë që numri i të rriturve të dënuar është ulur me 31,7 % nga 2015 në 2017.

Në totalin e personave të dënuar në vitin 2017, të miturit përbënin 2,6 %. Përqindja e të miturve të dënuar ka rënë gjatë periudhës 2015-2017; kjo përqindje varion nga 3,7 % në 2,6 %.

FIGURA 21


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar për vepra penale, për periudhën 2015-2017



Në figurën më poshtë paraqitet përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar sipas kategorive të veprës penale. Vihet re se përqindja e të dënuarve të mitur në totalin e të dënuarve është më e vogël se 4,0 %. Numri i të dënuarve të mitur është më i lartë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe për vepra penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor krahasuar me kategoritë e tjera.

FIGURA 22


Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar sipas kategorive të vepra penale, për 2017



Nga 283 të dënuar të mitur, 44,9 % e tyre janë dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 34,6 % për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe 8,8 % për vepra penale kundër personit.

FIGURA 23

Përqindja e personave të mitur të dënuar sipas kategorive të veprave penale, për vitin 2017



Në tabelën shtojcë 3.5 është paraqitur numri total i të dënuarve të mitur dhe të rritur sipas kategorive të veprave penale.

3.2.5.1. TË DËNUAR TË MITUR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në vitin 2017 u regjistruan 1.695 persona të dënuar për vepra penale kundër personit, 25 prej tyre ishin të mitur. Numri i të miturve të dënuar ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve të mitur u rrit me 81,3% nga 2015 në 2016 dhe më pas ra me 56,9 % nga viti 2016 deri në vitin 2017.

Nga personat e dënuar për vepra penale kundër personit në vitin 2017, 1,5 % ishin të mitur. Përqindja e të miturve të dënuar varion nga 1,4 % në 2,5 %.

FIGURA 24

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar për vepra penale kundër personit, për periudhën 2015-2017




Figura më poshtë jep të dhëna për të dënuarit e mitur dhe të rritur sipas nënkategorisë së veprave penale kundër personit. Siç shihet nga figura, për vepra penale kundër personit, përqindja e të dënuarve të mitur është shumë më e ulët, më pak se 2,0 % në të gjitha nënkategoritë e veprës penale kundër personit.

FIGURA 25

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017




Figura 26 tregon se numri i të dënuarve të mitur është më i lartë për vepra penale kundër shëndetit, dhunës në familje dhe për vepra të tjera penale kundër personit në krahasim me nënkategoritë e tjera në veprat penale kundër personit. Në vitin 2017, nga 25 të dënuar të mitur gjithsej, 40,0 % prej tyre janë dënuar për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit dhe 20,0 % secila në nënkategoritë e dhunës në familje dhe vepra të tjera penale kundër personit.

FIGURA 26

Përqindja e personave të mitur të dënuar për vepra penale kundër personit sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017




Tabela në shtojcë 3.6 paraqet numrat e të dënuarve të mitur dhe të rritur për vepra penale kundër personit për nënkategoritë e dhëna më lart.

3.2.5.2. TË DËNUAR TË MITUR PËR VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

Në 2017, u regjistruan 3.782 të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 127 prej tyre ishin të mitur. Numri i të dënuarve të mitur ka pësuar rënie gjatë periudhës 2015-2017. Numri i personave të dënuar të mitur ka rënë me 26,9 % nga 2015 në 2016 dhe me 46,2 % nga 2016 në 2017.

Nga të dënuarit për vepra penale kundër personit në 2017, 3,4 % ishin të mitur. Përqindja e të dënuarve të mitur ka rënë gjatë kësaj periudhe.

FIGURA 27

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, për periudhën 2015-2017




Figura 28 paraqet përqindjen e të dënuarve të mitur sipas nënkategorive të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Siç shihet nga figura, të dënuarit e mitur zënë një përqindje të vogël, më pak se 8,0 % në të gjitha nënkategoritë në vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Nga figura vërehet se të miturit janë prezent vetëm në tre nga tetë nënkategoritë.

FIGURA 28

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017




Figura 29 paraqet të dënuar të mitur sipas nënkategorive të veprave penale. Në vitin 2017, nga 127 të dënuar të mitur gjithsej për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 93,7 % e tyre janë dënuar për vjedhje të pasurisë, 5,5 % për grabitje dhe 0,8 % për shkatërrimin e pasurisë.

FIGURA 29

Të mitur të dënuar sipas veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, në vitin 2017.




Tabela 3.7 në shtojcë tregon numrin e të dënuarve të mitur dhe të rritur për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike për nënkategoritë e paraqitura më lart.

3.2.5.3. TË DËNUARIT E MITUR PËR KATEGORINË VEPRA TË TJERA PENALE

Në vitin 2017, u regjistruan 5.426 persona të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale, 131 prej tyre ishin të mitur. Numri i të dënuarve të mitur ka rënë gjatë periudhës 2015-2017. Numri i të dënuarve të mitur në fillim u rrit me 8,9 % nga 2015 në 2016 dhe më pas pësoi rënie me 51,1 % nga 2016 deri në 2017.

Nga personat e dënuar për kategorinë vepra të tjera penale në vitin 2017, 2,4 % ishin të mitur. Përqindja e të dënuarve të mitur ka rënë gjatë periudhës, nga 3,7 % në vitin 2015 në 2,4 % në 2017.

FIGURA 30

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar në kategorinë vepra të tjera penale, për periudhën 2015-2017




FIGURA 31

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të vepra penale, për 2017





Figura 32 paraqet përqindjen e të miturve të dënuar sipas nënkategorive të veprave penale. Në vitin 2017, nga 127 të dënuar të mitur gjithsej për kategorinë vepra penale të tjera, 74,8 % prej tyre janë dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, 9,2 % për vepra penale në fushën e drogës, 1,5 % për kalim të paligjshëm të kufirit dhe 14,5% për vepra të tjera penale.

FIGURA 32

Përqindja e personave të mitur të dënuar në kategorinë vepra të tjera penale sipas nënkategorive të veprave penale, për 2017



PERSONA TË BURGOSUR

4.1 HYRJA

Ky kapitull paraqet të dhëna për numrin e të personave të burgosur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Të dhënat janë paraqitur sipas veprës penale për të cilën janë burgosur, grupmohës dhe nivelit arsimor. Seksioni i parë do jetë një paraqitje e numrit gjithsej të personave të mbajtur në burgje, seksioni i dytë do të jetë një prezantim i të dhënave mbi të dënuarit me burg dhe seksioni i tretë paraqet të dhëna mbi personat e paraburgosur. Në dallim nga kapitujt e tjerë, kategoritë e veprave penale të paraqitura në këtë kapitull nuk mund të krahasohen me kategoritë dhe nënakategoritë e veprave penale të paraqitura në kapitujt më parë. Burimi i të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe paraqet të dhëna për 2 vite, 2016 dhe 2017.

4.1.1. TË BURGOSUR

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në 31 dhjetor të çdo viti.

4.1.2. TË DËNUAR ME BURG

Të dënuar me burg i referohet personave të cilët ndodhen në burgje, të cilët kanë dënimin përfundimtar me burgim. Statistikat tregojnë numrin e të dënuarve me burg deri në datën 31 dhjetor të çdo viti.

4.1.3. PERSONAT E PARABURGOSUR

Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg". Numri i personave të paraburgosur i referohet gjëndjes së tyre më 31 dhjetor të çdo viti.

4.2. TË BURGOSUR GJITHSEJ

Në vitin 2017, numri gjithsej i personave të burgosur ishte 5.418. Numri i të burgosurve ka rënë me 8,9 % krahasuar me vitin 2016. Në vitin 2017, 43,1 % e personave të burgosur ishin të paraburgosur, ndërsa 56,9 % ishin të dënuar me burg. Në vitin 2016, përqindja e personave të paraburgosur ishte më e lartë, 47,8 %. Nga viti 2016 në vitin 2017, numri i personave të burgosur për 10 mijë banorë ka pësuar rënie nga 20,7 të burgosur në 18,9 të burgosur.

TABELA 1

Numri i të paraburgosurve dhe dënuarve me burg dhe përqindja e tyre në totalin e personave të burgosur për vitet 2016 dhe 2017

Të burgosur	Nr			[%]		
	Të paraburgosur	Të dënuar me burg	Gjithsej	Të paraburgosur	Të dënuar me burg	Gjithsej
2016	2.842	3.104	5.946	47,8	52,2	100
2017	2.335	3.083	5.418	43,1	56,9	100

TABELA 2

Numri i personave të burgosur sipas gjinisë dhe në raport me popullsinë, për vitet 2016-2017

Të burgosur	Nr			Tregues		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
2016	103	5.843	5.946	0,7	40,1	20,7
2017	95	5.323	5.418	0,7	36,8	18,9

Në vitin 2017, nga totali i personave të burgosur 95 ishin femra. Ndërsa në vitin 2016, 105 nga 5.946 të burgosur ishin femra. Në vitin 2017, numri i femrave të burgosura përbënte një 1,8 % të totalit të të burgosurve.

4.2.1 TË BURGOSURIT SIPAS VEPRAVE PENALE


Në këtë seksion paraqiten të dhëna për të burgosurit sipas veprave penale. Të dhënat paraqesin numrin gjithsej të të burgosurve, gjëndjen e personave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale çdo fund viti dhe jo sa prej tyre kanë hyrë në këto institucione në një datë të caktuar. Prandaj numri i personave të burgosur për një vepër penale specifike do të ndikohet nga koha e qëndrimit të të burgosurve në këto institucione.

Numri i personave të burgosur për vrasje (vrasje me dashje, vrasje dhe vrasje të tjera) ishte 994 në 2017, 33 persona ose 3,4 % më shumë krahasuar me 2016.

Nga totali i personave të burgosur në 2017, të burgosurit për krime në fushën e drogës përbëjnë numrin më të madh (si kultivimi i narkotikëve, trafikimi i narkotikëve, pjesëmarrja në organizatat kriminale në fushën e drogës dhe vepra penale të tjera në fushën e drogës). Në vitin 2017 numërohen 1.598 të burgosur, të cilët përbëjnë 29,5 % të të burgosurve gjithsej. Numri i të burgosurve për krime në fushën e drogës u rrit me 4,4 % krahasuar me 2016.

Numri i personave të burgosur për nënkategorinë vjedhje (vjedhje, vjedhje e energjisë elektrike, vjedhje të tjera dhe femrabitje me armë dhe me dhunë) në 2017 ishte 1.049 ose 19,4 % e totalit të të burgosurve. Ky numër ka pësuar rritje me 93 persona ose 9,7 % krahasuar me vitin 2016.

FIGURA 1
Personat e burgosur sipas gjinisë për 2016 dhe 2017



Numri i të burgosurve për veprën penale të dhunës në familje në vitin 2017 ishte 377 të burgosur, 31,8 % më shumë krahasuar me 2016. Nga viti 2016 në vitin 2017 numri i të burgosurve për marrëdhënie seksuale me dhunë (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë ose marrëdhënie homoseksuale me të mitur) është rritur nga 83 të burgosur në 90. Gjatë së njëjtës periudhë, numri i personave të burgosur për plagosje me dashje është rritur nga 100 në 2016 në 103 në 2017. Të dhëna më të detajuara për numrin e personave të burgosur sipas veprave penale mund të gjenden në tabelën 4.1 të shtojcës.

TABELA 3
Numri i personave të burgosur sipas veprave penale, ndryshimi në numër dhe në përqindje për 2016 dhe 2017

Vepra penale	2016	2017	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
Vjedhje e pasurisë	956	1049	93	9,7
Vrasje	961	994	33	3,4
Plagosje	100	103	3	3,0
Krime seksuale	83	90	7	8,4
Krime në fushën e drogës	1.530	1.598	68	4,4
Organizata kriminale	22	26	4	18,2
Mashtrime	53	99	46	86,8
Shfrytëzim prostitucioni	58	90	32	55,2
Dhuna në familje	286	377	91	31,8
Të tjera	1.897	992	-905	-47,7
Gjithsej	5.946	5.418	-528	-8,9


4.2.2 SHPËRNDARJA GJINORE E PERSONAVE TË BURGOSUR

Në vitin 2017, nga totali i personave të burgosur 95 ishin femra, 8 më pak krahasuar me një vit më parë.

Meshkujt përbëjnë shumicën e personave të burgosur në lidhje me të gjitha llojet e veprave penale. Edhe pse femrat përbëjnë jo më shumë se 1,8 % ose më pak nga numri gjithsej i personave të burgosur për shumicën e veprave penale, për vepra penale që lidhen me shfrytëzimin e prostitucionit dhe mashtrimit, femrat përbëjnë 14,1 % dhe 16,7 % të totalit të personave në burgje.

FIGURA 2


Përqindja e secilës gjini ndaj numrit të personave të burgosur sipas veprave penale, 2017



Nga totali i femrave të burgosura, 16,8 % e tyre janë në burgje për vepra penale në fushën e drogës, ndërkohë kjo përqindje për meshkujt ishte 29,7 %. Për veprat penale që lidhen me vjedhjet, përqindja e femrave dhe meshkujve të burgosur ishte përkatësisht 19,5 % dhe 12,6 %. Për vrasje, përqindja e femrave dhe meshkujve në institucionet korrektuese ishte e ngjashme, 18,9 % për femrat dhe 18,3 % për meshkujt. Shumica e femrave të burgosura ishin për vrasje, vepra penale në fushën e drogës, shfrytëzim prostitucioni, mashtrim dhe vjedhje. Ndërkohë shumica e meshkujve të burgosur ishin për vepra penale në fushën e drogës, vjedhje dhe vrasje.

FIGURA 3

Përqindja e të burgosurve sipas veprave penale dhe gjinisë, 2017



Të dhëna më të detajuara për numrin e personave në institucionet korrektuese sipas veprave penale dhe gjinisë mund të gjenden në tabelën 4.2 të shtojcës.

4.2.3 STRUKTURA MOSHORE E PERSONAVE TË BURGOSUR

Nga viti 2016 në vitin 2017, shpërndarja moshore e të burgosurve ka ndryshuar. Në vitin 2017, 50,6 % e personave burgosur ishin më të rinj se 30 vjeç, ndërsa në 2016, të rinjtë përbënin 39,3 % të të burgosurve.

TABELA 4


Numri i personave të burgosur sipas grupmoshës, ndryshimi në numër dhe në përqindje për 2016 dhe 2017

Grupmosha	2016	2017	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
	Nr	Nr		
14-17	58	39	-19	-32,8
18-20	268	407	139	51,9
21-24	717	1.148	431	60,1
25-29	1.291	1.148	-143	-11,1
30-39	1.617	1.289	-328	-20,3
40-49	1.215	811	-404	-33,3
50-59	633	440	-193	-30,5
60+	147	136	-11	-7,5
Gjithsej	5.946	5.418	-528	-8,9

Në vitin 2017, nga totali i personave të burgosur, 7,5 % ishin 18-20 vjeç, 21,2 % ishin 21-24 vjeç, 21,2 % ishin 25-29 vjeç, 23,8 % ishin 30-39 vjeç, 15,0 % ishin 40-49 vjeç, 8,1 % ishin 50-59 vjeç dhe 2,5 % ishin të moshës 60 vjeç e lart. Gjatë periudhës 2016 – 2017, numri i të burgosurve u rrit për moshat 18-20 vjeç dhe 21-24 vjeç, përkatësisht me 51,9 % dhe 60,1 %. Për të gjitha grupmoshat e tjera numri i të burgosurve ka rënë.

FIGURA 4

Përqindja e personave të burgosur sipas grupmoshave, 2016 dhe 2017




Numri i personave të burgosur për 10 mijë banorë, në vitin 2017, ishte më i lartë për grupmoshën 21-29 vjeç, me 52,8 të burgosur, ndërsa në vitin 2016 norma më e lartë e të burgosurve ishte për të njëjtën grupmoshë, 21-29 vjeç të moshës me 46,4 të burgosur për 10 mijë banorë.

Norma më e ulët e personave të mbajtur në institucionet korrektuese për 10 mijë banorë, ishte për grupmoshën nën moshën 20 vjeç dhe mbi 60 vjeç, për të dy vitet.

FIGURA 5

Norma e të burgosurve sipas grupmoshës, 2016 dhe 2017




Në vitin 2017, shumica (65,3 %) e femrave në institucionet korrektuese ishin të moshës 30 ose më të vjetër. Ndërkohë, në totalin e personave të burgosur e njëjta grupmoshë përbënte 49,4 % për të njëjtin grupmoshë. Nga femrat e burgosura, 6,3 % ishin 18-20 vjeç.

Në vitin 2017, pak më pak se gjysma (49,1 %) e meshkujve të burgosur ishin të moshës 30 vjeç e lart. Grupmosha 30-39 vjeç përbënte numrin më të madh të meshkujve, 23,8 %. Nga meshkujt në institucionet ndëshkimore, 7,5 % ishin 18-20 vjeç.

FIGURA 6

Përqindja e femrave dhe meshkujve sipas grupmoshës, 2017



4.2.4 NIVELI ARSIMOR I TË BURGOSURVE

Për shumicën 51,9 % e personave të burgosur në vitin 2017, niveli më i lartë arsimor i ndjekur ishte arsimi 9 vjeçar. Niveli më i lartë i arsimit në vitin 2017 për 26,0 % të personave të burgosur ishte arsimi i mesëm. Në vitin 2016, kjo përqindje ishte 27,1 %. Numri i personave në institucionet korrektuese me arsim të lartë, në vitin 2017, ishte 333, 6,1 % e totalit të të burgosurve. Në vitin 2016, u regjistruan 450 persona me arsim të lartë dhe përbënin 7,6 % të numrit gjithsej të të burgosurve.

Për femrat dhe meshkujt e burgosur, niveli më i lartë arsimor i arritur është arsimi i mesëm, 46,3 % dhe 52,0 % në vitin 2017. Për meshkujt, është e njëjta përqindje edhe për 2016, ndërsa për femrat shpërndarja është pothuajse e barabartë ndërmjet arsimit fillor, 9 vjeçar dhe të mesëm, përqindja varion ndërmjet 22,3 % dhe 26,2 %.

TABELA 5

Niveli arsimor i personave të burgosur sipas gjinisë, për vitin 2016 dhe 2017

	2016						2017					
	Femra		Meshkuj		Gjithsej		Femra		Meshkuj		Gjithsej	
Niveli arsimor	Nr	% nga totali	Nr	% nga totali	Nr	% nga totali	Nr	% nga totali	Nr	% nga totali	Nr	% nga totali
Pa arsim	8	7,80%	246	4,50%	254	4,30%	2	2,10%	215	4,00%	217	4,00%
Fillor	27	26,20%	556	10,10%	583	9,80%	7	7,40%	641	12,00%	648	12,00%
9 vjeçar	26	25,20%	2.974	54,20%	3.000	50,50%	44	46,30%	2.770	52,00%	2.814	51,90%
I mesëm	23	22,30%	1.591	29,00%	1.614	27,10%	23	24,20%	1.383	26,00%	1.406	26,00%
I lartë	19	18,40%	431	7,90%	450	7,60%	19	20,00%	314	5,90%	333	6,10%
Panjohur	0	0,00%	45	0,80%	45	0,80%	0	0,00%	0	0,00%	0	0,00%
Gjithsej	103	100%	5.483	100%	5.946	100%	95	100%	5.323	100%	5.418	100%

4.2.5 RECIDIVIZMI

Recidivistë janë persona që kanë përsëritur një vepër penale pas përfundimit të një dënimi të mëparshëm. Recidivistët janë të ndarë në të përgjithshëm dhe specifik.

Recidivistët e përgjithshëm janë persona të cilët janë burgosur për një vepër të ndryshme penale nga ajo e mëparshme për të cilën janë dënuar; recidivistë të veçantë janë ata që janë dënuar për të njëjtën vepër penale si ajo e mëparshme.

Nga numri gjithsej i personave të burgosur, 513 ose 9,5 % ishin recidivistë në vitin 2017. Në vitin 2016, numri i recidivistëve ishte më i ulët, 481 persona, rreth 8,1 % e popullsisë në institucionet korrektuese. Gjatë periudhës 2016-2017, shumica e recidivistëve ishin recidivistë të përgjithshëm. Në vitin 2017, 70,4 % e numrit gjithsej të recidivistëve ishin të përgjithshëm dhe 29,6 % ishin specifikë. Në vitin 2016, 66,9 % ishin recidivistë të përgjithshëm dhe 33,1 % recidivistë specifikë.

4.3 TË DËNUAR ME BURG

Të dënuar me burg i referohet personave të dënuar me burg me vendim përfundimtar nga gjykatat. Statistikat tregojnë numrin e të burgosurve më 31 dhjetor të çdo viti.

Në 2017, numëroheshin 3.083 të dënuar me burg. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i të dënuarve me burg u ul me 21 persona, ose 0,7 % të dënuar me burg më pak. Në raport me numrin e popullsisë, në vitin 2017 u regjistruan 10,7 të dënuar me burg për 10 mijë banorë, përafërsisht e njëjta përqindje në vitin 2016, 10,8 të dënuar për 10 mijë banorë.

TABELA 6

Numri i personave të dënuar me burg sipas gjinisë dhe në raport me popullsinë, 2016 dhe 2017

Të dënuar me burg	Nr			Tregues		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
2016	56	3.048	3.104	0,4	20,9	10,8
2017	54	3.029	3.083	0,4	20,9	10,7

4.3.1 TË DËNUAR ME BURG SIPAS VEPRËS PENALE

Nga numri gjithsej i personave të dënuar me burg gjatë vitit 2017, 822 persona ose 26,7 % ishin burgosur për vrasje. Një përqindje tjetër 25,5 % (787) gjendej në burg për vepra penale në fushën e drogës, 19,4 % ishin burgosur për vepra të vjedhjes dhe 4,4 % për dhunë në familje.

Numri i të dënuave me burg për dhunë në familje është rritur me 51,1 %, nga 2016 në 2017. Ndërsa numri i të dënuarve me burg për vepra penale të lidhura me vjedhjet është rritur me 10,1 %. Të dënuarit me burg për vrasje ishin pothuajse në numër të njëjtë si në 2016 dhe 2017. Në të njëjtën periudhë, numri i të dënuarve me burg për veprat penale në fushën e drogës ka rënë me 12,8 %. Të dhëna më të hollësishme për numrin e të dënuarve me burg për vepra penale paraqiten në tabelën 4.3 në shtojcë.

TABELA 7

Numri i të dënuarve me burg sipas veprave penale, ndryshimi në numër dhe në përqindje, 2016 dhe 2017

Vepra penale	2016	2017	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
Vjedhje e pasurisë	544	599	55	10,1
Vrasje	821	822	1	0,1
Plagosje	60	46	-14	-23,3
Krime seksuale	61	49	-12	-19,7
Krime në fushën e drogës	903	787	-116	-12,8
Organizata kriminale	6	14	8	133,3
Mashtrime	32	64	32	100
Shfrytëzim prostitucioni	37	54	17	45,9
Dhuna në familje	90	136	46	51,1
Të tjera	550	512	-38	-6,9
Gjithsej	3.104	3.083	-21	-0,7

4.3.2. STRUKTURA MOSHORE E PERSONAVE TË DËNUAR ME BURG

Nga viti 2016 në vitin 2017, struktura moshore e të dënuarve me burg ka ndryshuar. Në vitin 2017, pak më shumë se gjysma (51,8 %) e të dënuarve me burg ishin më të rinj se 30 vjeç, ndërsa në vitin 2016 vetëm 37,1% e të burgosurve ishin më të rinj se 30 vjeç.

TABELA 8


Numri i personave të dënuar me burg sipas grupmoshës dhe ndryshimi në numër dhe përqindje, 2016 dhe 2017

Grupmosha	2016	2017	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
	Nr	Nr		
14-17	15	7	-8	-53,3
18-20	68	196	128	188,2
21-24	331	688	357	107,9
25-29	739	705	-34	-4,6
30-39	812	711	-101	-12,4
40-49	689	438	-251	-36,4
50-59	335	244	-91	-27,2
60+	115	94	-21	-18,3
Gjithsej	3.104	3.083	-21	-0,7

Grupmosha me numrin më të madh të të dënuarve me burg është 30-39 vjeç, për të dy vitet në fjalë.

FIGURA 7

Përqindja e personave të dënuar me burg sipas grupmoshës, 2016 dhe 2017




Të dhëna më të hollësishme për numrin e të dënuarve me burg sipas veprave penale dhe grupmoshës paraqiten në tabelën 4.4 në shtojcë.

Figura më poshtë paraqet normën e të dënuarve me burg për 10 mijë banorë. Nga viti 2016 në vitin 2017, kjo normë është rritur për moshat më të reja se 30 vjeç. Gjatë të njëjtës periudhë, kjo normë ka rënë për të gjitha moshat 30 vjeç e lart. Në 2016, grupmosha 21 – 29 vjeç ka normën më të madhe të të dënuarve me burg për 10 mijë banorë, me 24,7 të dënuar me burg. Në vitin pasardhës kjo normë u rrit ndjeshëm, në 32,0 të dënuar me burg, duke shfaqur dallime edhe më të forta me grupmoshat e tjera. Numri gjithsej i të dënuarve me burg për 10 mijë banorë ka ndryshuar shumë pak në dy vite, nga 10,8 në 2016 në 10,7 në 2017.

FIGURA 8

Numri i personave të dënuar me burg në raport me popullsinë, 2016 dhe 2017



4.4 TË PARABURGOSURIT

Të paraburgosurit i referohen personave ndaj të cilëve është marrë masa arrest me burg. Ata mbahen në institucionet e paraburgimit dhe në burgje dhe numri i tyre reflekton gjëndjen e tyre deri në datën 31 dhjetor të vitit të dhënë.

Në vitin 2017, ishin 2.335 persona të paraburgosur, 43,1 % në totalin e gjithë personave të burgosur. Krahësuar me vitin 2016, numri i të paraburgosurve ka rënë me 507 persona, ose 17,8 %. Në vitin 2017, numri i të paraburgosurve për 10 mijë banorë ishte 8,1 dhe për 2016 ishin 9,9 të paraburgosur. Norma e meshkujve të paraburgosurve është më e lartë në krahasim me normën femrave të paraburgosura.

TABELA 9

Numri i personave të paraburgosur sipas gjinisë dhe në raport me popullsinë, 2016 dhe 2017

Paraburgosur	Nr			Tregues		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
2016	47	2.795	2.842	0,3	19,2	9,9
2017	41	2.294	2.335	0,3	15,9	8,1

4.4.1. TË PARABURGOSUR SIPAS VEPRËS PENALE

Nga totali i personave në paraburgim gjatë vitit 2017, 811 ose 34,7 % u paraburgosën për vepra penale në fushën e drogës, 19,3 % për veprat penale të vjedhjes, 10,3 % për dhunë në familje dhe 172 persona për vrasje. Numri i të paraburgosurve për të gjitha këto kategori të veprave penale është rritur krahasuar me vitin 2016. Numri i të paraburgosurve për veprat penale në fushën e drogës ka pësuar rritje me 29,3 % nga viti 2016. Ndërsa për të njëjtën periudhë numri i të paraburgosurve për dhunë në familje, veprat penale të vrasjes dhe veprat penale në lidhje me vjedhjet janë rritur me 23,0 %, përkatësisht 22,9 % dhe 9,2 %.

TABELA 10

Numri i të paraburgosurve sipas veprave penale, ndryshimi në numër dhe në përqindje, 2016 dhe 2017

Vepra penale	2016	2017	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
Vjedhje e pasurisë	412	450	38	9,2
Vrasje	140	172	32	22,9
Plagosje	40	57	17	42,5
Krime seksuale	22	41	19	86,4
Krime në fushën e drogës	627	811	184	29,3
Organizata kriminale	16	12	-4	-25
Mashtrime	21	35	14	66,7
Shfrytëzim prostitucioni	21	36	15	71,4
Dhuna në familje	196	241	45	23
Të tjera	1.347	480	-867	-64,4
Gjithsej	2.842	2.335	-507	-17,8

Më shumë informacion në lidhje me moshën dhe veprën penale për të paraburgosurit e gjeni në tabelën shtojcë 5.

4.4.2. STRUKTURA MOSHORE E TË PARABURGOSURVE

Numri i personave në paraburgim është rritur për grupmoshat 18-20 vjeç, 21-24 vjeç dhe për personat 60 vjeç e lart, për grupmoshat e tjera numri i të paraburgosurve ka rënë. Në vitin 2017, 49,1 % e të paraburgosurve ishin më të rinj se 30 vjeç, në vitin 2016, 41,6 % ishin më të rinj se 30 vjeç.

TABELA 11


Numri i personave të paraburgosur sipas grumpmoshave dhe ndryshimi në numër dhe përqindje, 2016 dhe 2017

	2016	2017		
Grupmosha	Nr	Nr	Ndryshimi në nr	Ndryshimi në %
14-17	43	32	-11	-25,6
18-20	200	211	11	5,5
21-24	386	460	74	19,2
25-29	552	443	-109	-19,7
30-39	805	578	-227	-28,2
40-49	526	373	-153	-29,1
50-59	298	196	-102	-34,2
60+	32	42	10	31,3
Gjithsej	2.842	2.335	-507	-17,8

Nga numri gjithsej i të paraburgosurve, shumica në vitin 2016 dhe 2017 janë ndërmjet moshës 21 dhe 49 vjeç. Përqindja më e lartë e të paraburgosurve ishte për grupmoshën 30-39 vjeç, për të dyja vitet 2016 dhe 2017.

FIGURA 9

Përqindja e personave të paraburgosur sipas grupmoshës, 2016 dhe 2017




Të dhëna më të hollësishme për numrin e të paraburgosurve sipas veprave penale dhe grupmoshave paraqiten në tabelën 4.6 në shtojcë.

Në raport me popullsinë, grupmosha 21-29 vjeç kishte normën më të lartë të të paraburgosurve për 10 mijë banorë. Të paraburgosurit e moshës 30 vjeç e lart dhe të moshës 60 dhe më të vjetër për 10 mijë banorë janë pothuajse në vlera të njëjta për 2016 dhe 2017. Në krahasim me 2016, të paraburgosurit për 10 mijë banorë të moshës 30-59 vjeç kanë rënë. Në vitin 2016, të paraburgosurit të moshës 30-39 vjeç për 10 mijë banorë kishin normën më të lartë. Ndërsa në 2017, të paraburgosurit 21- 29 vjeç kishin normën më të lartë.

FIGURA 10

Numri i personave të paraburgosur në raport me popullsinë, 2016 dhe 2017



4.5 TË MITURIT

Ky seksion paraqet të dhëna për të miturit (14-17 vjeç) të burgosur që mbahen në institucionet korrektuese sipas veprave penale. Në fillim është paraqitur numri gjithsej i të miturve në burgje, pastaj të mitur të dënuar me burg dhe të mitur të paraburgosur sipas veprave penale.


Të miturit e burgosur

Në 2017, numri i të burgosurve të mitur ishte 39. Numri i të burgosurve të mitur ka rënë me 32,8 % krahasuar me 2016, ndërsa numri i të burgosurve të rritur është ulur me 8,6 %.

Në 2017, nga totali i personave të burgosur, të miturit përbëjnë 0,7 %. në vitin 2016, numri i të miturve përbënte 1,0 % të totalit.

FIGURA 11

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të burgosur për vepra penale, për 2016 dhe 2017




Të miturit e burgosur sipas veprës penale

Në vitin 2017, nga totali i të burgosurve të mitur, të miturit e burgosur për vjedhje përbëjnë grupin më të madh, 61,5 %, ndjekur nga të miturit e burgosur për vepra të tjera penale, 15,4 %.

FIGURA 12

Përqindja e personave të mitur të burgosur sipas veprave penale, për 2017




Të miturit të dënuar me burg

Në vitin 2017, numri i të personave të mitur të dënuar me burg ishte 7. Numri i të miturve ka rënë me 53,3 % nga 2016 në 2017 ndërsa numri i të rriturve ka pësuar një rënie të lehtë me 0,4 %.

Nga numri gjithsej i të dënuarve me burg në 2017, të miturit zënë 0,2 % dhe në vitin 2016 përqindja ishte 0,5 %.

FIGURA 13

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të dënuar me burg, për 2016 dhe 2017




Të miturit e dënuar me burg sipas veprave penale

Në figurën më poshtë është treguar se në vitin 2017, nga 7 të mitur të dënuar me burg gjithsej, numri i të miturve për vjedhje është grupi më i madh. Përqindja e të miturve për vjedhje ishte 57,1 % (4 të mitur) dhe 14,3 % për vrasje (1 i mitur) dhe 28,6 % për vepra penale të tjera.

FIGURA 14

Përqindja e personave të mitur të dënuar me burg sipas veprave penale, për 2017




Të miturit e paraburgosur

Në vitin 2017, numri i të paraburgosurve të mitur ishte 32. Numri i të paraburgosurve të mitur ka rënë nga 2016 në 2017 me 25,6 %, ndërsa numri i të rriturve është ulur me 17,7 %. Nga numri gjithsej i të paraburgosurve, në vitin 2017 të miturit përbëjnë 1,4 %, ndërsa në vitin 2016 kjo përqindje ishte 1,5 %.

FIGURA 15

Përqindja e personave të mitur dhe të rritur të paraburgosur, për 2016 dhe 2017




Të paraburgosur të mitur sipas veprave penale

Në figurën më poshtë është treguar se në vitin 2017, nga 32 të paraburgosur të mitur gjithsej, numri i të paraburgosurve të mitur për vjedhje është grupi më i madh. Përqindja e të paraburgosurve të mitur për vjedhje ishte 62,5 % dhe përqindja e dytë më e madhe i përket kategorisë vepra penale të tjera me 15,6 %.

FIGURA 16

Përqindja e personave të mitur të paraburgosur sipas veprave penale, për 2017



METODOLOGJIA

1. BURIMI I TË DHËNAVE

Qasja e përdorur për mbledhjen e të dhënave është burimi administrativ. Publikimi përmban statistika nga katër shkallët e sistemit të drejtësisë penale, Polici, Prokurori, Ministria e Drejtësisë dhe Burgje, të cilat janë ofruesit kryesorë të të dhënave. Për përpilimin e këtyre statistikave është zbatuar një metodologji adekuate që i referohet funksionimit të skemës së sistemit të informacionit që aplikohen nga strukturat e Policisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Burgjeve.

Të dhënat mbi numrin e veprave penale të evidentuara, viktimat/ personat e dëmtuar dhe personat e dyshuar janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Të dhënat mbi numrin e procedimeve penale të regjistruara, procedimet penale për gjykim dhe numrin e të pandehurve janë siguruar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Të dhënat për numrin e personave të dënuar për vepra penale janë siguruar nga Ministria e Drejtësisë.

Të dhënat mbi numrin e të dënuarve me burg, të paraburgosur janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të gjitha këto burime të të dhënave janë shumë të rëndësishme për ecurinë e punës, për përmblidhjen e afateve të përcaktuara dhe për të krijuar një pasqyrë të sistemit të drejtësisë.

2. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënat bazë janë siguruar nga disa autoritete të ndryshme, si policia, prokuroria, ministria e drejtësisë dhe burgjet. Meqenëse secili autoritet prodhon statistika kryesisht për qëllime vetjake, të dhënat dhe metodat e mbledhjes ndryshojnë ndërmjet tyre. Në këtë seksion jepen informacione të përgjithshme mbi ofruesit e të dhënave, mënyra se si mbledhen të dhënat nga secili institucion dhe çfarë të dhënash mbledh dhe publikon INSTAT-i nga secili prej tyre.

2.1 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË

Mbledhja e të dhënave

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë grumbullon çdo ditë të dhëna direkt nga 12 drejtoritë rajonale të policisë. Një komunikatë me statistika i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë nga drejtoritë rajonale dhe pastaj këto statistika hidhen në sistem. Sistemi i policisë u zbatua për herë të parë në vitin 2014 dhe mban të gjitha të dhënat që nga viti 2015 e në vijim. Përpara zbatimit të sistemit, të dhënat mbledheshin dhe ruheshin me dorë në dosjet fizike. Sistemi ka fusha të detyrueshme, përputhshmëria dhe saktësia e të cilave kontrollohet dhe vlerësohet në Drejtorinë e Përgjithshme.

Sistemi ka një numër të konsiderueshëm fushash sipas veprave penale (sipas nenit përkatës të kodit penal), autorët / të dyshuarit, modus operandi, ngjarja, viktimat, motivet, gjinia, shtetësia, sendet e konfiskuara, arrestimet, grupmosha dhe arsimi.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, INSTAT-i mbledh të dhëna për veprat penale; viktimat/personat

e dëmtuar të disagreguara sipas gjinisë, 2 grupeve kryesore moshore (të mitur, të rritur) dhe kombësisë; të dhënat për personat e dyshuar sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit arsimor dhe masave të sigurisë. Për vlerësimin e të dhënave kryhet kontrolli për plotësinë e të dhënave, përputhshmërinë me kalimin e kohës, kontroll përmbledhës, kontrolli i intervaleve kohore nëse ka shpëputje të konsiderueshme, etj.

Rregullat e metodologjisë:

- Faza e mbledhjes së të dhënave

Veprat penale regjistrohen në momentin që është kryer raportimi i veprës penale, ose është evidentuar nga policia, por përpara një hetimi të plotë.

- Njësia e numërimit

Veprat penale janë njësia kryesore e numërimit. Kur regjistrohen të dhënat e rastit, regjistrohen të gjitha veprat penale dhe jo vetëm vepra kryesore. Ndërsa rasti zhvillohet, zyrtarët që ndjekin këto raste sigurohen që sistemi të përditësohet me vazhdimësinë dhe rezultatet.

Individët, personat e dyshuar dhe viktimat janë një njësi tjetër e numërimit që përdoret.

- Rregullat e numërimit për veprat penale dhe personat

Vepra të shumfishta të të njëjtit lloj - veprat penale të të njëjtit lloj të kryera gjatë periudhave të ndryshme kohore numërohen si "dy ose më shumë vepra penale".

Vepra e kryer nga më shumë se një person - në polici vepra penale numërohet vetëm njëherë ndërsa personat e dyshuar numërohen të gjithë.

Numërimi i personave për vepra të shumfishta (seriale) të të njëjtit lloj - kur një autorë ka kryer disa vepra të të njëjtit lloj në raste të ndryshme numërohet veçmas për secilën nga dy veprat penale.

Numërimi i të njëjtit person disa herë në të njëjtin vit - një person që ka kryer vepra më shumë se një herë (në raste të veçanta) brenda një viti llogaritet si dy persona, për qëllime statistikore.

2.2 PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Mbledhja e të dhënave

Prokuroria e Përgjithshme mbledh të dhënat direkt nga 23 prokuroritë të shkallës së parë dhe nga prokuroria e krimeve të rënda. Procesi i mbledhjes së të dhënave është i njëjtë për të gjithë prokuroritë dhe ekzistojnë udhëzime të shkruara për këtë. Kur merret një rast, ai hidhet në një regjistër manual (manual registry book). Në këtë libër janë regjistruar të gjitha veprat penale e një rasti, por për qëllime statistikore vetëm vepra kryesore penale konsiderohet.

Regjistri manual përfshin veprat penale sipas neneve të kodit penal, kujt i është referuar rasti, kush e raportoi veprën penale, të dhënat e të pandehurve (emri, moshë, gjinia, recidivizmi, adresa, gjendja civile, shtetësia), detajet e viktimës/viktimave dhe vendimet e cështjeve.

Tabela e Excel-it për qëllime statistikore regjistron numrin e rasteve dhe rezultateve të grumbulluara për veprat penale sipas neneve të kodit penal, raste të reja të referuara nga policia, raste të reja nga të tjerët, numri i të dyshuarve, rastet e përjashtuara, rastet e mbyllura, rastet e pezulluara, rastet që shkojnë për gjykim dhe rastet e apeluara.

INSTAT-i mbledh të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme mbi numrin e procedimeve penale të regjistruara për veprat penale, numrin e procedimeve penale për gjykim dhe të dhënat për të pandehurit sipas gjinisë, grupmoshës dhe statusit të tyre ligjor, nëse kanë kryer ose jo vepra penale. Metodat e verifikimit të të dhënave kryhen si më poshtë: kontrolli për plotësinë e të dhënave, përputhshmëria me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrolle përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka shpëputje të konsiderueshme, etj.

RREGULLAT E METODOLOGJISË:

- Faza e mbledhjes së të dhënave

Procedimet penale, rastet regjistrohen në çastin kur u referohen prokurorëve.

- Njësia e numërimit

Procedimet penale dhe individët janë njësitë kryesore të numërimit. Kur detajet e një rasti regjistrohen në lidhje me më shumë se një vepër penale, në statistikën e prokurorisë llogaritet vetëm vepra penale më e rëndë (rregulli 'Vepra Kryesore Penale').

Individët janë një tjetër njësi numërimi – në rastin e prokurorisë numërohen personat e pandehur dhe viktimat.

- Rregullat e numërimit për veprat penale dhe personat

Veprat penale të shumfishta të të njëjtit lloj – disa vepra penale të të njëjtit lloj numërohen si "një rast".

Rregulli i numërimit kur një vepër penale kryhet nga më shumë se një person – numërohet një rast, procedim ndërkohë numërohen të gjithë të pandehurit.

2.3 MINISTRIA E DREJTËSISË Mbledhja e të dhënave

Ministria e Drejtësisë publikon në faqen zyrtare të saj Vjetarin Statistikor. Burimi kryesor në sigurimin e informacionit statistikor janë Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apeleve, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Materiali statistikor përcillet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet formularëve të plotësuar me të dhënat sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Drejtësisë. Në Vjetarin Statistikor ndeshim edhe analiza e konkluzione të dukurive të veçanta të shoqëruara me paraqitje grafike, tabelare, analiza krahasimore, ose me seri dinamike për rrethe gjyqësore, shkallë të ndryshme të gjyqësorit, gjendjen aktuale të të dënuarve në Instucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, dënimeve alternative, por disa herë jepet edhe material bruto nga i cili mundet të veçohet elementi statistikor për të cilin interesohet përdoruesi i këtij informacioni.

INSTAT-i bazohet në Vjetarin Statistikor për të siguruar të dhëna për personat e dënuar, llojin e veprës penale dhe masat e dënimit.

RREGULLAT E METODOLOGJISË:

- Faza e mbledhjes së të dhënave

Faza e mbledhjes së të dhënave është para apelit; të dhënat publikohen para se vendimi të apelohej (për të dënuarit në shkallë të parë).

- Njësia e numërimit

Njësia e numërimit për statistikën e gjykatave është personi, i dënuari. Të dhënat e publikuara ndjekin rregullin e veprës kryesore për numërimin e personave të dënuar. Vetëm vepra penale më e rëndë do numërohet për autorin e cili kryen më shumë se një vepër penale njëkohësisht.

Vepra kryesore penale është vepra me dënimit më të lartë.

- Rregullat e numërimit për veprat penale dhe personat

Veprat penale të shumfishta të të njëjtit lloj – disa vepra penale të të njëjtit lloj numërohen si "një rast".

Rregulli i numërimit kur një vepër penale kryhet nga më shumë se një person – numërohet

vetëm një rast ndërkohë që numërohen të gjithë autorët.

2.4 DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E BURGJEVE

Mbledhja e të dhënave

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve mbledh të dhënat drejtpërdrejt nga 22 burgje që funksionojnë aktualisht në Shqipëri. Procesi i mbledhjes është i njëjtë për të gjitha burgjet dhe ka udhëzime të shkruara në zbatim. Në regjistrin e burgjeve regjistrohen të gjitha veprat penale, por për qëllime statistikore vetëm vepra penale kryesore konsiderohet.

Në çdo burg ekziston një dokument i quajtur komunikatë ditore që plotësohet nga personeli i burgut. Ky dokument përmban informacione për çdo person që është në burg. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve mbledh këto të dhëna dhe publikon statistika për të burgosurit çdo tremujor.

Regjistri përfshin të dhëna për të burgosurit për veprat penale, gjininë, moshën, kombësinë, të dhënat për të paraburgosurit, kontaktet e të burgosurve me familjen, të burgosurit që ndjekin aktivitetet rehabilituese, kohëzgjatja në paraburgim, masat alternative, vdekjet në burgje, etj.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, INSTAT-i mbledh të dhëna në bazë të formateve të burgjeve dhe publikon të dhëna për personat e burgosur sipas veprës penale dhe gjinisë, të dhëna për të paraburgosurit dhe të dënuarit me burg, nivelin arsimor dhe aktivitetet rehabilituese. Kontrolli për plotësinë e të dhënave, përputhshmëria me kalimin e kohës, kontrolle përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka shpëputje të konsiderueshme etj., kryehen për vlefshmërinë e të dhënave nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve.

RREGULLAT E METODOLOGJISË:

- Faza e mbledhjes së të dhënave

Personi regjistrohet pasi është marrë nga stacioni i policisë në paraburgim.

- Njësia e numërimit

Njësia e numërimit është i/e burgosuri/a. Të dhënat e publikuara ndjekin parimin e veprës kryesore penale të numërimit të të burgosurve, që do të thotë se vetëm vepra më e rëndë penale llogaritet për të burgosurin, i cili kryen më shumë se një vepër njëkohësisht (kur kryen disa vepra penale). Vepra kryesore penale është ajo për të cilën është parashikuar me ligj dënimi maksimal.

3. KLASIFIKIMI I VEPRAVE PENALE

Klasifikimi i veprave penale bazohet dhe është në përputhje me nenet dhe kapitujt e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për raportimin e shifrave, për qëllime statistikore. Veprat penale të paraqitura në publikim ndahen në 3 kategori kryesore: vepra penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe kategoria e tretë përfshin vepra të tjera penale.

Kategoria e parë, vepra penale kundër personit u referohet veprave penale të kapitullit II të Kodit Penal, që përfshin dhjetë seksione gjithsej në këtë kapitull: krime kundër jetës të kryera me dashje, krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia, krime seksuale, vepra penale kundër lirisë së personit, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, vepra penale kundër lirisë së besimit. Në këtë kategori janë analizuar dhe interpretuar disa nënkategori të veprave penale si vrasje me dashje, vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, krime seksuale, dhuna në familje dhe vepra të tjera penale që nuk përfshihen në këto vepra, të quajtura "vepra të tjera penale kundër personit".

Vrasje me dashje: Nënkatëoria e vrasjeve me dashje përfshin nenin 76 të Kodit Penal Vrasje me dashje; neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër; neni 78 Vrasje me paramendim, neni 78/a Vrasje për gjakmarrje; neni 79 Vrasje në rrethana të tjera cilësuese, neni 79/a Vrasje e funksionarëve publikë; neni 79/b Vrasje e punonjësve të policisë së shtetit; neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare; neni 81 Vrasja e foshnjës.

Vepra penale të kyera me dashje kundër shëndetit: Nënkatëoria “vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit” përfshin nenin 86 Tortura, neni 87 Tortura me pasoja të rënda; neni 88 Plagosje e rëndë me dashje; neni 89 Plagosje e lehtë me dashje; neni 89/a Shitblerja e paligjshme e organeve; neni 90 Dëmtime të tjera me dashje.

Krime seksuale: Kjo nënkategori përfshihen nenet 100-108 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Marrëdhënie seksuale me dhunë: Përfshihet neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur; Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur të moshës 14-18 vjeç; neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura; neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur; neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur; neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës; neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën; neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari; neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike.

Krime të tjera seksuale: Përfshihen nenin 107/a Dhuna seksuale; neni 108 Vepra të turpshme; neni 108/a Ngacmim seksual.

Dhuna në familje: i referohet nenit 130/a të Kodit Penal; rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Vepra të tjera penale kundër personit: Në nënkategorinë vepra të tjera penale kundër personit janë përfshirë seksionet si vepra penale kundër jetës shkaktuar me pakujdesi; vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia; Vepra penale kundër lirisë së personit; Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.

